



**ME EMRIN E ALLAHUT
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

DRITA E KUR'ANIT

REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

THE LIGHT OF QUR'AN

SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC
RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2016

Drejtör: H. Vullnet MERJA

REDAKSIA:

Prof. dr. Hajri SHEHU (*kryeredaktor*)

Sabrie FEZA (*zëvendëskryeredaktore*)

Prof. dr. Ali Reza ARAFI (*anëtar*)

Dr. Ahadollah GHOLIZADEH (*anëtar*)

Prof. dr. Bedri BYLYKU (*anëtar*)

Prof. dr. Feti MEHDIU (*anëtar*)

H. Jetmir ÇELA (*anëtar*)

H. Sulejman efendi REXHEPI (*anëtar*)

H. Selim STAFJA (*anëtar*)

Redaktore: Liseda RAMAJ

Korrektura teknike: Vjollca KARAJ

Përkthyesit: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit.

Viti IX, 2016, Nr. 1 (36)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

ISSN 2309-3668

Adresa e redaksisë:

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com

E_mail: f_quran114@yahoo.com & quranfondation114@gmail.com

Director: Haji Vullnet MERJA

EDITORIAL BOARD:

Prof. Dr. Hajri Shehu
Sabrie FEZA

Editor-in-chief
Vice-Editor-in-chief

Prof. dr. Ali Reza ARAFI	Member
Dr. Ahadollah GHOLIZADEH	Member
Prof. Dr. Bedri BYLYKU	Member
Prof. Dr. Feti MEHDIU	Member
Haji Jetmir ÇELA	Member
Haji Sulejman ef. REXHEPI	Member
Haji Selim STAFA	Member

Editor: Liseda RAMAJ

Proofreader: Vjollca KARAJ

Translators: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Foundation of Qur'an – Albania

A Quarterly Journal

Vol 1, issue 36, 2016

Printed in Albania by “LILO” Printing House

ISSN 2309-3668

Address of the Editorial Board:

Fondacioni i Kur'anit
Rruga “Hoxha Tahsin”, Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com

E_mail: f_quran114@yahoo.com & quranfondation114@gmail.com

PASQYRA E LËNDËS

Vullnet Merja	
PROFETI I PAQES DHE I DASHURISË.....	9
Sejjid Muxhteba Musavi Lari	
EFEKTET E MREKULLUESHME TË BESIMIT NË ZOT....	17
Nasir Mekarim Shirazi	
KOMENTIMI I AJETIT 164 I SURES “EL BEKARE”.....	30
Muhsin Keraeti	
TA NJOHIM MË TEJ KUR’ANIN.....	35
Abdu Daim Kahiil	
ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR’ANI XI.....	46
Sabrie Feza	
BUBULLIMA DHE VETËTIMA, ARGUMENTE TË FUQISË SË PAKUFISHME TË ALLAHUT.....	56
Qani Banaj	
PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ.....	63
Hans Henrich Reckweg	
TË KËQIJAT E MISHIT TË DERRIT.....	70
Fatme Chehab	
TA RUAJMË GJUHËN TONË.....	74
HISTORIA E PROFETIT MUSA DHE HARUN.....	81
Hajri Shehu	
VENDE, POPUJ, NJERËZ E NGJARJE QË PËRMENDEN NË KUR’AN: MEDINIA.....	92
Vullnet Merja	
FJALOR KUR’ANOR: SELAM (PAQE).....	99
TRASHËGIMIA KUR’ANORE TE SHQIPTARËT.....	102
VEPRIMTARI KUR’ANORE.....	107
VEPRIMTARI KUR’ANORE NDËRKOMBËTARE.....	112
BOTIME.....	118
BIBLIOGRAFI E REVISTES “DRITA E KUR’ANIT”, 2015.....	121
PËRMBLEDHJET NË GJUHËN ANGLEZE.....	124
PËRMBLEDHJET NË GJUHËN ARABE.....	131

TABLE OF CONTENTS

Vullnet Merja	
THE PROPHET OF PEACE AND LOVE.....	9
Sayyid Mujtaba Musawi Lari	
WONDERFUL EFFECTS OF BELIEF IN GOD.....	17
Nasir Mekarim Shirazi	
COMMENTARY OF THE VERSE 164 OF SURAH “AL-BAQARAH”	30
Muhsin Keraeti	
LESSONS FROM THE SURAH “AL-BAQARAH”.....	35
Abdu Daem Kaheel	
THE SKIN SPEAKS.....	46
Sabrie Feza	
THUNDER AND LIGHTNING, SIGNS OF INFINITE POWER OF ALLAH.....	56
Qani Banaj	
THERE IS REMEDY FOR EACH DISEASE	63
Hans Henrich Reckweg	
THE HARM OF PORK (SWINE FLESH).....	70
Fatme Chehab	
WE SHOULD PRESERVE OUR TONGUE.....	74
HISTORY OF THE PROPHETS MOSES AND AARON.....	81
Hajri Shehu	
PLACES, PEOPLES, PEOPLE AND EVENTS MENTIONED IN THE QUR’AN: MEDINA.....	92
Vullnet Merja	
QUR’ANIC GLOSSARY - Salam.....	99
QUR’ANIC INHERITANCE AMONG ALBANIANS.....	102
QUR’ANIC ACTIVITIES.....	107
INTERNATIONAL QUR’ANIC ACTIVITIES.....	112
PUBLISHING.....	118
Liseda Ramaj	
BIBLIOGRAPHY OF “THE LIGHT OF QUR’AN”	
Journal, 2015.....	121
SUMMARIES IN ENGLISH.....	124
SUMMARIES IN ARABIC.....	131

المحتويات

الحاج ولنت مريا	
نبي السلام و الرحمة.....	٩
السيد مجتبى موسوي اللاري	
الآثار الجميلة للايمان بالله.....	١٧
ناصر مكارم الشيرازى	
مظاهر عظمة الله في الكون تفسير الآية ٢٤١ من سورة البقرة.....	٣٠
محسن قرائتي	
دروس من سورة البقرة.....	٣٥
عبد الدائم الكحيل	
الجلد يتكلم.....	٤٦
صبريه فزا	
الرعد و البرق آياتان على قدرة الله اللامتناهية.....	٥٦
تشاني باناي	
لكل داء دواء.....	٦٣
هانس هنريك رسويغ	
اضرار لحم الخنزير.....	٧٠
فاطمة شهاب	
نحافظ على الستتنا.....	٧٤
قصص الانبياء - النبي موسى و النبي هارون (عليهما السلام).....	٨١
الاستاذ خيرى شيهو	
الاماكن و الاقوام و الاحداث المذكورة فى القرآن - المدينة.....	٩٢
القاموس القرآنى - السلام.....	٩٩
التراث القرآنى عند ألبان.....	١٠٢
نشاطات قرآنية.....	١٠٧
نشاطات قرآنية العالمية.....	١١٢
المنشورات.....	١١٨
بيبلوغرافيا للقرآن (بحث فهرسى) فى مجلة «نور القرآن» ٢٠١٥.....	١٢١
ملخص باللغة الانجليزية.....	١٢٤
ملخص باللغة العربية.....	١٣١

PROFETI I PAQES DHE I DASHURISË

Abstrakt

*Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahu qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) solli mesazhin e paqes dhe të sigurisë. Ai ka qenë i vërteti, besniku. Njerëzit e njohnin, e njohin dhe do ta njohin deri në fund të kësaj jete si të tillë. Për të, Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, ti je në skajet e larta të moralit.”** Ai e mbarti Mesazhin e Allahut në zemrën e tij, në gjubën e tij e në çdo hap të jetës së tij dhe ua përcollti të gjithë njerëzve. Kur flitet për Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahu qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), flitet për Islamin, flitet për mrekullinë e përjetshme të Fjalës së Allahut, Kur’anin e Shenjtë, të cilin Allahu e zbriti për t’i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë vetë Kur’ani, sepse i gjithë Kur’ani ishte kristalizuar në vetë qenien e tij. Kur ecte, e kur fliste, e ndriçonte çdo gjë me dritën e Kur’anit. Ai është drita e pashuar, edukuesi i përkryer dhe udhëheqësi më i drejtë. Prandaj, ai ka qenë, është dhe do të mbetet shembull për të gjithë njerëzit e çdo kohe dhe të çdo vendi pa dallim kombi, race, gjuhe e ngjyre.*

Mesazhi që solli Profeti është mesazhi i paqes dhe i sigurisë. Ai ka qenë i vërteti, besniku. Njerëzit e njohnin, e njohin dhe do ta njohin deri në fund të kësaj jete si të tillë. Për atë, Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, ti je në skajet e larta të moralit.”** Ai e mbarti Mesazhin e Allahut në zemrën



e tij, në gjuhën e tij e në çdo hap të jetës së tij dhe ua përcolli të gjithë njerëzve. Ai është përkthyer dhe botuar në shumë gjuhë të ndryshme të botës. Për përhapjen e këtij mesazhi, ai duroi tortura, mundime e persekutime e dhembje nga më të ndryshmet. Vetë Profeti ka thënë: *“Asnjë profeti nuk i është bërë keq, siç më është bërë mua.”*

Fjalët e smirakëve nuk e penguan atë në veprën e tij. Talljet dhe mendjemadhësitë e njerëzve të asaj kohe nuk e ndaluan të shpallte e të përhapte mesazhin e Allahut. Prandaj sot, më shumë se një miliardë e gjysmë myslimanë vazhdojnë ta pasojnë atë me dëshirë e dashuri.

Gabon rëndë ai që thotë se ky mesazh është përhapur me shpatë. Sepse vetë Allahu e cilëson Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mëshirë për mbarë botët, kur thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”**¹ Dhe: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”**² Dhe: **“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”**³

Në Kur'an lexojmë se Allahu ia ka qartësuar Profetit të Tij se si ta përhapte fenë e Tij, kur thotë: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe me këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë,**

1 Sure “Enbija”, ajeti 107.

2 Sure “Ali Imran”, ajeti 159.

3 Sure “Teube”, ajeti 128.



Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, i di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë.”⁴ Dhe: “Thuaj: ‘O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij askënd e asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin në vend të Allahut!’ Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtuar Allahut!’”⁵

Këto ajete të Allahut të Madhëruar e të tjera si këto në Kur’an, qartësojnë se Islami nuk është përhapur me gjuhën e shpatës, siç mëtojnë (pretendojnë) disa mendje dashakeqëse e djallëzore. Vallë, a shkon dhuna më mëshirën?! A shkon ashpërsia me butësinë?! A shkon zënka me dialogun?! Asnjëherë. Ata që thonë se Islami është përhapur me dhunë e me shpatë, duan që ta shuajnë dritën e Allahut me gjuhët e tyre. Por më kot mundohen, sepse Allahu na thotë në Kur’an: **“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e Allahut me gojën e tyre, por Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë.”**⁶

Kur flitet për Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahu qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), flitet për Islamin, flitet për mrekullinë e përjetshme të Fjalës së Allahut, Kur’anin e Shenjtë, të cilin Allahu e zbriti për t’i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë, siç thuhet në fillim të sures “Ibrahim”: **“Elif. Lâm. Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”**⁷

Allahu i Madhëruar, Zotëruesi i fuqisë, i dijes dhe i urtësisë absolute, i ka krijuar njerëzit dhe i ka mirësuar ata me mirësitë dhe dhuntitë e Tij. Njeriu, krijesa e përkryer dhe më

4 Sure “Nahl”, ajeti 125.

5 Sure “Ali Imran”, ajeti 64.

6 Sure “Teube”, ajeti 32.

7 Sure “Ibrahim”, ajetet 1-2.



e larta e gjithësisë, që nga lindja e deri në çastin e ndarjes nga kjo jetë, jeton nën kujdesin e Allahut. Kjo vërtetohet nëse përqendrohemi në jetën tonë të përditshme - nga foshnjëria në rini e deri në pleqëri.

Allahu nuk dëshiron që njerëzit të shkojnë drejt humbjes dhe shkatërrimit. Sigurisht, njeriu me anë të mendjes së tij bën dallimin mes së mirës dhe së keqes, mes asaj që i sjell dobi dhe asaj që i sjell dëm, mes rrugës së drejtë dhe rrugës së shtrembër. Por pa udhëzues, mendja nuk mund ta drejtojë njeriun në rrugën e drejtë e të vërtetë. Prandaj, Allahu e ka mirësuar njeriun me dërgimin e profetëve, të cilët janë: **“përpërgëzues dhe qortues”** siç thuhet në suren “Enbija”, ajeti 25.

Historia e jetës së Profetit tonë të dashur, Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është më e qartë se historitë e profetëve paraardhës. Nga profetët e mëparshëm kanë mbetur ato gjurmë të vërteta që ka ruajtur Islami nëpërmjet Librit të tij, Kur’anit të Shenjtë.

Mesazhi i Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është shumë i lehtë dhe përmban kuptime të ndritura, që e pasurojnë dhe e ndriçojnë mendjen dhe zemrën e shëndoshë të çdo njeriu.

Mesazhi që solli Profeti Muhamed është i pastër nga legjendat dhe paganizmat.

Mesazhi që shpalli Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sjell qetësi, ngrohtësi dhe paqe në shpirtin, sepse përmendet Allahu. Në Kur’an thuhet: **“Sigurisht, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat.”**⁸

Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë vetë Kur’ani, sepse i gjithë Kur’ani ishte kristalizuar në vetë qenien e tij. Kur ecte, e kur fliste, e ndriçonte çdo gjë

⁸ Sure “Rra’ad”, ajeti 28.



me dritën e Kur'anit.

Ai është drita e pashuar, edukuesi i përkryer dhe udhëheqësi më i drejtë. Prandaj, ai ka qenë, është dhe do të mbetet shembull për të gjithë njerëzit e çdo kohe dhe të çdo vendi pa dallim kombi, race, gjuhe e ngjyre. Në Kur'an thuhet: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”**⁹

Prania e Profetit tonë të dashur ka qenë, është dhe do të mbetet themeli më i fortë i unitetit të myslimanëve. Ashtu si s'ka kuptim jeta pa dritë, pa qetësi e pa paqe, po ashtu, ajo nuk ka kuptim pa praninë e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Sepse besimi i myslimanëve në Profetin shoqërohet e bashkohet me dashurinë dhe përmallimin për të. Ai është strumbullari i dashurisë dhe i bashkimit të mbarë myslimanëve. Prania e tij i zbut zemrat e myslimanëve, e i bashkon ata me njëri-tjetrin.

Dashuria për Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është rruga drejt Xhenetit dhe porta e dashurisë së Allahut të Madhëruar. Dashuria për Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është dashuri dhe sinqeritet për Allahun Fuqiplotë.

Ta duash Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), do të thotë të zbatosh porositë, këshillat, urdhëresat dhe ndalesat që ai ka urdhëruar. Zbatimi i Synetit të Profetit Muhamed është argumenti më i madh dhe më i fuqishëm i dashurisë për të. Prandaj, është detyrë e të gjithë myslimanëve që të njihen dhe ta zbatojnë Synetin (fjala, vepra, çfarë ka bërë e çfarë nuk ka bërë Profeti) e Profetit. Syneti i Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është shpallje e shpallur, siç thotë Kur'ani:

9 Sure “Ahzab”, ajeti 21.



“Ai nuk flet sipas dëshirës së vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje e shpallur, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhebraili).”¹⁰

Në një ajet tjetër, Kur’ani thotë: **“...Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...!”¹¹**

Dhe: **“Nuk i takon asnjë besimtari a besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështjen e tyre...”¹²**

Dhe: **“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’”¹³**

Ajetet e mësipërme na thonë se dashuria për Profetin dhe zbatimi i Syneetit të tij është detyrë për çdo mysliman dhe myslimane. Dashuria dhe ndjekja e tij nxjerrin në pah besimin dhe dashurinë tonë për Allahun e Madhëruar.

Kundërshtimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është humbje. Këtë e përforcon ajeti i Kur’anit, që thotë: **“...Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”¹⁴** Kurse vetë Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Askush nuk ka besuar, derisa unë të jem më i dashur tek ai sesa fëmijët e tij, prindërit e tij dhe të gjithë njerëzit.”¹⁵* Dhe: **“Thuaj: ‘Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe**



10 Sure “Nexhm”, ajetet 3-5.

11 Sure “Hashr”, ajeti 7.

12 Sure “Ahzab”, ajeti 36.

13 Sure “Ali Imran”, ajeti 31.

14 Sure “Ahzab”, ajeti 36.

15 Sahihu Muslim, kitabul iman.

lufta në rrugën e Tij, atëherë prisni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” Dhe: “I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin...”¹⁶ E kanë pyetur imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Si ka qenë dashuria juaj për Profetin?” Ai ka thënë: “*Ai ka qenë më i dashur te ne sesa pasuritë tona, fëmijët tanë, baballarët tanë, nënat tona dhe uji i ftohtë për të eturin.*”

Pas Allahut të Plotfuqishëm, Profeti Muhamed e meriton, vërtet dashurinë më të madhe, sepse ai është njeriu i përkryer që ka parë e do të shohë gjithësia. Allahu na e përshkruan në mënyrë madhështore qëllimin e dërgimit të Profetit Muhamed në Kur'anin e Shenjtë, kur thotë: “**O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëherësh, (të kemi dërguar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut, me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues. Jepu lajmin e mirë besimtarëve se Allahu ka (përgatitur) për ata dhunti të madhe! Mos i dëgjo mohuesit dhe dyfytarakët! Mos i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek Allahu! Allahu mjafton për mbrojtës.**”¹⁷

Allahu i Madhëruar na e ka bërë detyrë dërgimin e salavateve për Profetin Muhamed dhe për familjen e tij të pastër. Dërgimi i salavateve është shenjë e dashurisë për Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në Kur'an thuhet: “**Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për atë. O ju që keni besuar, lutuni për atë dhe përshëndeteni me ‘selam!’**”¹⁸ Dërgimi i salavateve ka mirësi të mëdha. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Kush më dërgon mua një salavat, Allahu do t'i dërgojë atij dhjetë*

16 Sure “Ahzab”, ajeti 6.

17 Sure “Ahzab”, ajetet 45-48.

18 Sure “Ahzab”, ajeti 56.



salavate.”

Është mirë që salavatet të thuhën në çdo kohë. Po ashtu, është mirë që salavatet të thuhën para dhe pas ezanit, para dhe pas ikametit, në ruku e në sexhde, në teshehud, para dhe pas një duaje, para dhe pas leximit a këndimit të Kur'anit, para hyrjes në xhami dhe pas daljes prej saj, sa herë të përmendet emri i tij, ditën e xhuma dhe natën e xhuma, në festat e bajrameve etj.

Allahu na mbarësoftë që ta ndjekim rrugën e tij në këtë jetë dhe na bashkoftë me të dhe me familjen e tij të pastër Ditën e Gjykimit!



EFEKTET E MREKULLUESHME TË BESIMIT NË ZOT

Abstrakt

Përulja përpara Zotit, në të gjitha kohët, në vështirësi dhe në qetësi dhe bindja se fuqia e pashtershme e Zotit është mbi të gjitha fuqitë e tjera të zakonshme, shkaqet dhe faktorët, drejton dhe udhëbeq gjithçka dhe i jep një forcë të jashtëzakonshme shpirtit. Dëshmia më e mirë e besimit të qëndrueshëm ndaj Zotit është karakteri moral dhe shpirtëror i qëllimeve të një personi dhe motiveve të tij. Në atë rast veprimet e tij marrin një vlerë të veçantë dhe ai vjen që të marrë pjesë në mbështetjen e Zotit dhe të mirësisë së tij të pakufishme. Mbështetja në Zotin, kurrë nuk të çon në ndonjë lloj dobësie dhe indiference. Për më tepër, ai të jep vetëbesim, të forcon vullnetin, heq të gjitha gjurmët e dyshimit dhe të pavendosmërisë në shpirtin e njeriut.

Vetëbesimi nuk është kundër besimit në Zot. Besimi që një njeri vendos në Zotin e Universit dhe besimi që ka te fuqia e Tij e përjetshme forcon dhe zhvillon personalitetin e njeriut.

Qenia njerëzore duke pasur besim, teksa zotëron pasurinë e vetëbesimit dhe të personalitetit të pavarur, përdor me kujdes të gjitha mundësitë dhe mjetet tërësisht të vlefshme. Ai nuk keqpërdor ndonjë nga mundësitë, por, në të njëjtën



kohë, ai nuk kufizon shpirtin e tij brenda mureve të faktorëve dhe të shkaqeve materiale. Humanizmi i tij nuk kufizohet prej tyre.

Prandaj, horizontet e tij janë gjithmonë të hapura, për t'u ngjitur në lartësi të reja dhe fushëveprimi i aktivitetit të tij është i gjerë. Kjo ndodh sepse një pjesë e energjisë, e vrullit dhe e aktivitetit të tij i përkushtohet qëllimeve më të larta të jetës.

Qenia njerëzore me shpirtin plot me besim mbështetet mbi Zotin, i Cili drejton të gjitha punët me fuqinë e Tij të pafundme dhe nuk ka ndonjë partner apo bashkëpunëtor në ndonjërin prej punëve të tij: **“Bëgatitë që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t'i pengojë askush, ndërsa atë që ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**(35:2)

Ku mund të gjejë strehë dhe ngushëllim njeriu, që është përtej mbretërisë së fuqisë së Zotit? Të gesh strehë diku tjetër, përveçse te Zoti, nuk do të ketë rezultat tjetër veç zhgënjimit dhe poshtërimit. Si mund të jetë një krijesë padron dhe arbitër i të tjerëve kur ai vetë ka nevojën e Zotit për gjithçka dhe nuk ka asnjë forcë të veten dhe as nuk është i aftë për t'i ofruar ngushëllim dikujt tjetër?

Në përputhje me rrethanat, nuk ka asgjë më të përshtatshme për qeniet njerëzore sesa të kërkosh të jetojnë nën hijen e mbështetjes dhe të mirësisë së Zotit, i Cili i rregullon të gjitha çështjet me urtësinë dhe fuqinë e Tij.

Përulja përpara Zotit, në të gjitha kohët, në vështirësi dhe në qetësi dhe bindja se fuqia e pashtershme e Zotit është mbi të gjitha fuqitë e tjera të zakonshme, shkaqet dhe faktorët, drejton dhe udhëheq gjithçka dhe i jep një forcë të jashtëzakonshme shpirtit.

Kjo krijon një besim dhe një paqe të tillë në brendësi të zemrës dhe shpirtit të njeriut, sa që një njeri nuk mund të



shkundet dhe të rrëmbëhet nga ngjarje të ndryshme dhe të humbasë ekuilibrin dhe vlerën e vet ose të shtypet nga diçka, goftë e madhe apo e vogël.

Kur një njeri i nënshtron shpirtin dhe mendjen e tij Zotit, deri në masën sa kjo është e mundur, njeriu mbushet me frymën e bindjes dhe nënshtrimit ndaj Zotit dhe ndaj urdhrave e vendimeve të tij.

Pastaj ai as nuk ankohet për ngjarje të pakëndshme, as entuziazmohet dhe bëhet krenar nga suksesi i tij. Ai nuk ndikohet nga gjëra që trullosin të tjerët dhe që ndikojnë me një efekt të padëshiruar mbi to.

Si rezultat i vendosmërisë së tyre të qëndrueshme dhe të shpirtit të mbushur me besim, ata nuk do të gjunjëzoheshin para dëshpërimit dhe paarsyeshmërisë, të cilat shpeshherë bëhen burimi i dështimit.

Mbështetja në Zotin, kurrë nuk të çon në ndonjë lloj dobësie dhe indiference. Për më tepër, ai të jep vetëbesim, të forcon vullnetin, heq të gjitha gjurmët e dyshimit dhe të pavendosmërisë në shpirtin e njeriut.

Përpjekjet e paepura të njerëzve të Zotit përballë rrethanave të pafavorshme dhe kundër elementeve të dëmshme dhe ideve degjeneruese në komunitetet e tyre, përftojnë forcën e tyre nga e vërteta e pafundme. Ata kërkuar ndihmesën e këtij mjeti të padukshëm për të ndjekur planet e tyre të reformave dhe të udhëheqjes së njerëzve.

Kjo ndodh për arsye se shpirti i tyre kishte një lidhje të pathyeshme me fuqinë e pashkatërrueshme të Zotit dhe pastaj ndjekin qëllimet e tyre vendosmërisht deri në arritjen përfundimtare të tyre.

Vetëbesimit, të cilit i mungon mbështetja në Zot nuk mund ta shpëtojë shpirtin njerëzor nga shqetësimi dhe ankthi nën kushtet e rrepta dhe molisëse. Mjerimi dhe faktorët e pafavorshëm të jetës shkatërrojnë shpirtin e atyre që u mungon



besimi në Zot dhe largpamësia e të cilëve nuk shkon përtej materies dhe së vërtetës fizike.

Një ndjenjë trishtimi dhe errësire krijohet në brendësinë e tyre dhe në një atmosferë të tillë shtypëse, ata nuk mund ta bëjnë ngritjen e tyre drejt krenarisë dhe shkëlqimit. Një ndjenjë dërrmuese ankthi dhe dhimbjeje zë vend te ta sapo hasin në ngjarje të padëshiruara të një rëndësie shumë të vogël ose ata shkatërrohen nga vuajtjet katastrofike të jetës.

Kjo pikë bëhet e qartë kur ne vërejmë shpirtin dhe gjendjen e myslimanëve gjatë periudhave të hershme të Islamit, pasi ata ishin simboli më i mirë dhe shembulli i besimit në mbështetjen te Zoti.

Njeriu nuk vë re ndonjë dobësi, letargji apo indiferencë negative tek ata që bëjnë sakrifica për ta çuar përpara besimin e tyre dhe për të punuar për arritjen e qëllimeve vetjake. Përpjekjet e papërkulshme, në kushte të vështira, për ndërtimin e një shoqërie të re dhe të lulëzuar ishte metoda e qartë e tyre.

Ata që u rritën dhe u edukuan në atë shkollë mendimi dinamike, nuk dorëzohen kurrë nga mungesa e besimit. Ishte vendosmëria, fryma, shpirti i përmbajtur dhe i besueshëm, të cilët shtruan rrugën e përparimit të tyre dhe çuan drejt shfaqjes së shoqërisë unike dhe të pakrahasueshme në historinë botërore.

Çdokush duhet ta vlerësojë situatën e tij në jetë dhe të identifikojë rrugën që ka zgjedhur nëpërmjet terrenit të ekzistencës. Ai duhet të mësojë, nëse po shkon drejt lumturisë dhe mirësisë e virtytit apo drejt mjerimit dhe humbjes.

Duke identifikuar nevojat shpirtërore të njeriut, ai do t'u rezistojë me efektivitet gjendjeve dhe faktorëve që trazojnë ekuilibrin shpirtëror të njeriut, duke mos lejuar elementet e dëmshme të grumbullohen dhe të konsolidojnë forcat e tyre.

Sidoqoftë, kur duket se qenia e një njeriu është errësuar nga ndonjë paaftësi dhe mangësi apo defekt, nuk është e mundur të sajosh një zgjidhje themelore, derisa të gjendet shkaku i kësaj



papërshtatshmërie në thellësitë e shpirtit të viktimës.

Ata që janë viktima të mungesës së besimit kanë frikë nga nisja e një sipërmarrjeje si rezultat i frikës nga dështimi i tyre. Zgjidhja dhe kurimi më i mirë do të ishte zbulimi i shkaqeve të këtij defekti shpirtëror, pasi identifikimi i shkaqeve të ndonjë sëmundjeje është i rëndësishëm për trajtimin e tij.

Në këtë mënyrë, njeriu mund të eksplorojë thellësitë e qenies së njeriut dhe të zbulojë çelësin për kurimin e tij. Padyshim, përpjekjet që janë bërë për të kapërcyer papërshtatshmëritë e njeriut dhe paaftësitë e tij prodhojnë rezultatet e veta të rëndësishme, pasi njeriu ka aftësi të zhvillojë një luftë të vazhdueshme kundër faktorëve të pashëndetshëm shpirtërorë.

Çdo zakon i keq është shenja e dobësisë dhe vjen si rezultat i sjelljes së përsëritur dhe merr formën e një sëmundje kronike të dëmshme. Megjithëse, në fillim duket e vështirë të ndryshosh një zakon, por është mundësia për të ndryshuar zakonet e njeriut nëpërmjet ushtrimit dhe përpjekjeve.

Çdo zakon i dëmshëm që kapërcehet duhet numëruar si një fitore e madhe në rrugën për arritjen e vlerave njerëzore dhe cilësive shpirtërore madhështore.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Vetëm nëpërmjet kapërcimit të zakonëve të këqija, njeriu mund të arrijë në pozicione të larta.*”¹

Islami dhe pavarësia individuale

Kërkesa për pavarësi individuale lind nga thellësia e qenies së njeriut. Kjo dëshirë e natyrshme mund të realizohet vetëm, kur mënyra e të sjellit të njeriut dhe qasja e tij është e bazuar në këtë prirje.

¹ *Ghurar al-hikam*, f. 335.



Burimin e të gjitha sjelljeve njerëzore, Islami e shikon nga pikëpamja e të qenët i shëndetshëm. Ai, jo vetëm që nuk kërkon të shtyp dëshirat e vërteta të brendshme të njeriut, por as nuk beson në frenimin e shfaqjen e tyre në ndërgjegjen e vet.

Prandaj, ai i përdor për hir të ngritjes morale të njeriut dhe lartësimit të tij drejt majave e qëltimeve njerëzore. Ai tregon vëmendje të njëhershme ndaj dëshirave dinamike, si ndaj parimit që mund të kontrollojë dhe të disiplinojë këto dëshira të forta.

Me një vështtrim të tillë të gjerë është e mundur të realizojë një gjendje të shëndoshë në psikikën, e cila është e ekuilibruar në të gjitha aspektet, kështu që secili, nga nxitjet dhe aftësitë e tij vë në punë si duhet, duke i krijuar mundësinë njeriut të lartësohet drejt perfeksionit me hapa të qëndrueshëm.

Ai mund të harxhojë energji të akumuluar në vetvete për të siguruar qëllimet bazë në jetë dhe për të arritur në stacionin më të shquar e më sublim, që është i vlefshëm për një qenie njerëzore të vërtetë.

Dëshira për të pasur përparim është një aspiratë njerëzore. Sidoqoftë, duke qenë se ai ka fuqi të kufizuara e ka të pamundur të harxhojë të gjitha energjitë e tij në arritjen e qëllimeve bazë, ndërsa është duke zotëruar ende kapacitetet për të kryer udhëtimin drejt lartësive për përsosjen morale të tij dhe të vendosë një marrëdhënie me botën më të lartë.

Përkëdhelja e vazhdueshme e motiveve të pandershme dhe degjeneruese, dhe plotësimi i nevojave të tyre është faktori kryesor për shkatërrimin njerëzor. Në një gjendje të tillë do të ishte më e vështirë për një person për të pasur aftësinë për të vepruar në një mënyrë të dobishme dhe në vetëngritjen morale.

Në mënyrë që të kapërcejë të gjitha pengesat që gjenden në rrugë, Islami përgatit dëshirën e njeriut për t'u bërë një qenie pozitive, kështu që ai mund të mbetet i fortë dhe i qëndrueshëm në ballë të situatave dhe ngjarjeve shkatërrimtare



dhe të kapërcejë çdo problem nëpërmjet një lufte e përpjekjeje të pandërprerë kundër pengesave dhe të qëndrojë i patundur në përballjen me individë të ndryshëm.

Kështu zhvillohet guximi dhe vendosmëria dhe njeriu arrin të zotërojë një fuqi të mrekullueshme dhe të paçmueshme. Pavarësia dhe dinjiteti i njeriut qëndron në përballimin e luftës dhe përpjekjeve të jetës me guxim dhe qëndresë në zgjidhjen e problemeve të saj, duke qenë i sigurt në vetvete.

Ky qëllim mund të realizohet vetëm, kur njeriu mund të qëndrojë në këmbët e veta me të gjithë fuqinë e tij, duke siguruar lumturinë materiale dhe shpirtërore.

Imam Aliu, udhëheqës i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Një njeri që lartëson vullnetin e tij dhe arrin në shkallën më të lartë të tij, konsiderohet si dikush që ia vlen të lavdërohet dhe të nderohet nga të gjitha kombet.”²

Një individ që i mungon vetëbesimi dhe pavarësia personale është i prirur për të gjetur ngushëllim që ta mbrojë atë nga vështirësitë e jetës, ashtu si një bimë kacavjerrëse që me degëzat e saj të buta dhe delikate kacavirret duke u rrotulluar në pemën e lartë të lisit, për t’u siguruar dhe mbrojtur nga erërat dhe peripecitë e motit nën hijen e fuqisë së tij.

Një frymë negative, mund të kthehet gjithashtu në një skllavërim poshtërues për një individ të fuqishëm dhe po të ishte se dikush do të poshtëronte veten në atë masë, ai do të shkatërronte tërësisht personalitetin e vet dhe do të humbiste forcën për të drejtuar problemet.

Ai do të ndëshkohej duke qenë përherë një ndjekës dhe jo një drejtues apo zot i vetvetes, pavarësisë dhe lirisë së tij. Dhe përderisa një gjendje shpirtërore e tillë errëson qenien e tij, do të jetë e pamundur për të fituar dinjitetin njerëzor.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ju do të ndiheni i

² *Ghurar al-Hikam*, f. 661.



poshtëruar në lidhje me atë me të cilin ju bëheni i varur.”³

Përgjegjësia individuale

Në sistemin e mësimave islame, kuptimi i lumturisë shpirtërore të përjetshme varet nga sjellja vetjake e njeriut. Në parim, përgjegjësia vetjake përbën themelet e mësimave islame.

Kjo do të thotë, njeriu pritet të kryejë të gjitha detyrat që i janë caktuar në sferat e fesë dhe të ekzistencës së kësaj bote, në të gjitha fazat e jetës duke u mbështetur mbi përpjekjet dhe veprimet e tij.

Koncepti i gjykimit të Zotit dhe i shpërblimit, i cili është një nga nocionet e vetëkuptueshme të Islamit, gjithashtu është mbështetur mbi këtë bazë.

Kur’ani i Shenjtë na mëson se njeriu nuk do të marrë ndonjë shpërblim, përveç shpërblimit për përpjekjet dhe mundimet e tij.

Ai thotë:

“Çdo njeri është peng i veprave të veta.” (74:37)

Dhe: **“Cilido mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (16:97)**

Përveç shpërblimit dhe ndëshkimit në Jetën e Përtejme, njeriu mund të shikojë pasojën e sjelljes së tij në këtë botë.

Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*) ka thënë: “Çdokush që kryen një vepër të keqe do të marrë ndëshkimin në këtë botë.”⁴

Emerson-i, një filozof amerikan, shkruan:

“Bota duket si një tabelë shumëzimi apo një ekuacion

³ Po aty, f. 668.

⁴ *Nahj al-fasābah*, f. 592.



matematikor, të cilin, kthejeni si të dëshironi, ai do të përfundojë njësoj. Merrni çdo numër që dëshironi, vlera e vet ekzakte, as më shumë e as më pak, përsëritet te ju. Çdo e fshehtë tregohet, çdo krim ndëshkohet, çdo virtyt shpërblehet, çdo e keqe korrigjohet, me qetësi dhe siguri.

Atë që ne e quajmë gjykim të Zotit, nevoja universale me anë të së cilës, e tëra shfaqet kudo përmes shfaqjes së një pjese. P.sh., atje ku ju shikoni tym, duhet të ketë zjarr. Në qoftë se shikoni një dorë apo një gjymtyrë, ju e dini se trupi, të cilit, dora apo gjymtyra i përkasin është diku aty mbrapa.

Çdo vepër e shpërblen veten ose, me fjalë të tjera, e harmonizon veten në një mënyrë të dyfishtë; së pari, te gjëja ose në natyrë reale; dhe, së dyti, në rrethana apo në natyrën e dukshme. Njerëzit i quajnë rrethanat gjykim të Zotit.

Gjykimi rastësor është në vetë njeriun dhe vërehet nga shpirti. Gjykimi i Zotit në rrethana duket te të kuptuarit; ai është i pandarë nga sendet, por shpeshherë shpërndahet mbi të në një periudhë kohore të gjatë dhe kështu nuk bëhet i dallueshëm për disa vite me radhë.

Krimi dhe ndëshkimi rriten e zhvillohen nga i njëjti trung. Ndëshkimi është një frutë që piqet në mënyrë të padyshimtë në lulen e kënaqësisë që e ka bërë të padukshme atë.”⁵

Kriteri i vlerës morale në veprim

Veç kësaj, Islami hedh një vështrim origjinal të motiveve të brendshme të vërteta të veprimeve njerëzore dhe ka si qëllim kriterin për gjykime me vlerë. Çdo veprim ka dy aspekte dhe secili nga këto dy aspekte duhet të trajtohet në mënyrë të ndarë

5 Emerson, *Compensation*, shih Commins & Linscot, *The Social Philosophers* (Nju-Jork, Modern Pocket Library 1954), f. 442-443.



nga pikëpamja e së mirës dhe së keqes.

Një veprim mund të jetë shumë më me vlerë nga njëri aspekt dhe i pavlefshëm nga ana tjetër. Ajo që është e rëndësishme është lloji i motivit moral të brendshëm që e ka nxitur njeriun që të kryejë atë veprim dhe llojin e qëllimit që ishte paraparë në perspektivën e tij mendore.

Në qoftë se në raste të tilla, gjykimi ynë mbështetet në vlera të veçanta objektive dhe sociale, qëllimet e bërësit të një veprimi nuk janë të përshtatshme.

Nuk ka rëndësi, nëse veprimi humanitar i një njeriu kryhet me një motiv për t'u dukur dhe për të ndjekur interesa materiale apo, nëse ai është shtyrë nga një motiv sublim dhe vepra e tij është frymëzuar nga një qëllim i shenjtë. Prandaj nga këndvështrimi social, njeri i virtytshëm është një njeri që është i dobishëm për shoqërinë. Morali i individit dhe pjekuria shpirtërore e tij nuk janë të përshtatshme, as motivi që e shtyn atë të kryejë veprimin e tij.

Megjithatë, në një perspektivë të Zotit, dimensionet sasiore të veprimeve nuk janë të rëndësishme. Ajo që e bën një veprim të vlefshëm për t'u pranuar nga Zoti është cilësia e një veprimi dhe gjendja e brendshme shpirtërore e personit që kryen veprimin.

Këtu, ajo që është me rëndësi është lloji i marrëdhënies që ekziston mes bërësit të veprimit dhe vetë veprimit, po ashtu dhe të qëllimit që e ka çuar atë drejt kryerjes së veprimit. Në qoftë se ai kryen një veprim të virtytshëm për t'u dukur, një veprim i tillë jo vetëm që nuk e lartëson atë drejt planeve më të larta të qenies, por e rrëzon atë në tokë.

Në mënyrë që të konsideroheni i drejtë, nuk është e mjaftueshme që veprimi të jetë i dobishëm për shoqërinë.

Një veprim i dobishëm për shoqërinë është i nevojshëm nga pikëpamja e rritjes dhe zhvillimit shpirtëror, kur ai merr një formë shpirtërore dhe engjëjllore dhe shpirti kapërcen kufijtë e



motiveve egoiste dhe të vetëkarrierizmit, për të arritur kufijtë e pastërtisë së brendshme dhe të sinqeritetit.

Kur'ani deklaron:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë.”(98:5)

I Dërguari fisnik (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*) ka thënë: “Vlera e veprave varet nga qëllimet e saj.”⁶

Kjo është një bazë e qartë mbi bazën e së cilës mund të vendosen vlerat e pranueshmërisë së bëmave dhe veprimeve.

Faktori bazë që rezulton në ngritjen morale të njeriut dhe të madhështisë së veprave të tij qëndron në fitimin e kënaqësisë së Allahut.

Dëshmia më e mirë e besimit të qëndrueshëm ndaj Zotit është karakteri moral dhe shpirtëror i qëllimeve të një personi dhe motiveve të tij. Në atë rast veprimet e tij marrin një vlerë të veçantë dhe ai vjen që të marrë pjesë në mbështetjen e Zotit dhe të mirësisë së tij të pakufishme.

Ky kriter i qëndrueshëm dhe i vlefshëm nuk qëndron përtej sferës së sjelljes, aftësive njohëse, njohurive dhe ndjenjave njerëzore. Njeriu, shpirti i të cilit nuk është ndriçuar nga rrezet e madhështisë së Zotit dhe shpirti e zemra e të cilit është e zhveshur nga sinqeriteti dhe besimi, motivet që e drejojnë atë, janë ato që dalin nga dëshirat egoiste dhe nga dashuria për një emër të mirë që po zbehet.

Detyrat që një person i tillë fillon dhe që i çon deri në fund, duke qenë se i mungon vërtetësia dhe natyra shpirtërore, realizohen, kështu që të tjerët mund ta respektojnë atë dhe ta konsiderojnë një njeri me vlera njerëzore.

Një objektiv i tillë i pavlerë dhe i padobishëm do të ketë një efekt shkatërrues në karakterin e tij dhe e rrëzon atë si një

⁶ *Nahj al-fasāhah*, f. 190.



qenie njerëzore. Arritjet e çuditshme të një njeriu të tillë nuk do të kenë ndonjë vlerë përpara Zotit dhe ai nuk do të marrë ndonjë shpërblim për arritjet e tij, përveç arritjes së qëllimit të kufizuar dhe të parëndësishëm që ai kishte parasysh.

Njerëzit me vetëbesim dhe të vetëdijshëm për veprimet e tyre nuk kanë ndonjë nevojë për salltanete dhe demonstrime. Salltaneti është sjellje e atyre që u mungon veprimi dhe besimi dhe vuajnë nga një dobësi shpirtërore.

Imam Aliu, udhëheqësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), bën këtë vërejtje për një person të tillë: *“Fjalët e një njeriu mburravec janë të këndshme, por ekziston një sëmundje e thellë në shpirtin e tij.”*⁷

Dhe: *“Egoizmi buron nga zemërngushtësia e vlerave të njeriut.”*⁸ Schachter-i, një psikolog njohur i thotë:

“Një mjet tjetër që ne përdorim për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, pavarësisht nga dështimi personal është mburrja dhe vetëreklamimi. Ne imagjinojmë se tashmë kemi arritur atë që dëshironim të bënim dhe të gjitha këto ia atribuojmë vetes sonë.

Në vend të suksesit që ne nuk mund të arrinim dhe të detyrave të rëndësishme që nuk mund të përmbushnim, ne kënaqeshim dhe mjaftobeshim duke biseduar për atë që ne kishim bërë dhe zmadhohim bëmat, pavarësisht sa të parëndësishme mund të kenë qenë ato.

Njerëz të tillë janë kaq shumë të çorientuar nga mburrjet e tyre dhe nga favorizimi i vetvetes, sa që ata humbasin mundësinë për të bërë ndonjë arritje. Në qoftë se reklamimi i vetes i pajis ata me një lehtësim të përkohshëm nga mungesa e dhimbshme e suksesit dhe e mosvëmendjes së të tjerëve, përkohësisht këta mashtrojnë dëgjuesit e tyre, por, gjë që nuk e zgjidh problemin e vërtetë.

Një njeri i cili mund të kryejë punën në mënyrë korrekte dhe fiton zemrat e të tjerëve me sjelljen dhe fjalën e tij, nuk ka nevojë të mburret.

⁷ Ghurar al-hikam, f.610.

⁸ Po aty, f. 106.



Duke in përkushtuar veprimet dhe jo kotësisë dhe mburrjeve, çdo ditë ai fiton më shumë shokë dhe arrin suksese më të mëdha.”⁹

Shopenhauer thotë:

“Mburrrjet dhe fryrjet prodhojnë përbuzje dhe fyerje, pasi nga njëra anë është shenja e pandershmërisë, e shtirjes dhe e injorimit dhe nga ana tjetër, një produkt i marrëzisë dhe i injorancës. Një njeri, i cili vazhdimisht pretendon të zotërojë një meritë sigurisht, që ai do të privohet prej saj. Ata që flasin për arritjet e tyre në mënyrë të pakujdesshme, duhet ta dinë me siguri se atyre u mungon madhështia e mendjes, forca dhe zotësia e tyre, të gjitha këto vlera dhe merita.

Përveç kësaj, nuk duhet harruar se mashtrimi dhe mburrjet nuk mund të zgjasin gjatë dhe e vërteta do të zbulohet në fund, duke çuar në humbje të dinjitetit dhe të emrit të mirë.”¹⁰

9 *Rusbd-e shakhsyyat*, f. 92.

10 *Afkar-e Schopenhauer*, përkthim pers nga Mushfiq Hamadānī, 1326 H.Sh. f. 92.



DUKJA E MADHËSHTISË SË ALLAHUT NË GJITHËSI

Komentimi i ajetit 164 i sures “El Bekare”

Abstrakt

Ky ajet i bekuar paraqet argumente për ekzistencën e Allahut. Ai tregon për gjashtë shenja prej shenjave të sistemit galaktik në gjithësi dhe secila nga këto shenja tregon për Njëshmërinë e Krijuesit. Gjashtë shenjat janë: krijimi i qiejve dhe i Tokës, këmbimi i natës me ditën, lundrimi në det në dobi të njeriut, shiu, erërat, retë që qëndrojnë mes qiellit dhe Tokës.

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”



Komentimi

Ky ajet paraqet argumente për ekzistencën e Allahut dhe për Njeshmërinë e Tij.

Para se të hyjmë në komentimin e ajetit, duhet bërë patjetër një hyrje përmbledhëse. Përderisa ekziston një sistem preciz dhe harmonik, atëherë këto janë argumente për praninë e dijes dhe të njohjes. Aty ku ka rregull, ka unifikim.

Nga këtu, kur nga njëra anë shohim dukjen e galaktikave dhe të bashkëngjitjes në gjithësi dhe nga ana tjetër shohim punën e unifikuar në të, arrijmë të kuptojmë ekzistencën e një Krijuesi të vetëm të Gjithëditur dhe të Plotfuqishëm, nga i Cili burojnë të gjitha dukuritë.

Nëse thellohem në gjashtë shtresat e syrit dhe shohim rrjetin e tij të mrekullueshëm, do të kuptojmë se natyra e verbër dhe e shurdhët nuk është kurrë në gjendje që të jetë zanafilla e këtij krijimi të mrekullueshëm.

Pastaj, nëse vështrojmë me hollësi bashkëpunimin dhe lidhshmërinë e këtyre shtresave, si dhe lidhshmërinë e syrit me të gjitha pjesët e tij dhe me trupin, harmoninë e natyrshmërisë krijuese mes njeriut dhe njerëzve të tjerë, harmoninë mes njerëzve dhe sistemit të përgjithshëm të gjithësisë, do të mësojmë se e gjitha kjo ka një zanafillë të vetme dhe e gjitha kjo ndodh nga një qenie e shenjtë dhe e vetme.

A nuk tregon poezia e bukur për inteligjencën e poetit?!

A nuk tregon prania e bashkërendimit në poezinë e një divani të vetëm se të gjitha vargjet e tij e kanë burimin te një poet i vetëm, i ditur dhe i aftë?!

Pas kësaj hyrjeje, të kthehemi te komentimi i ajetit. Ky ajet i bekuar tregon për gjashtë shenja prej shenjave të sistemit galaktik në gjithësi dhe secila nga këto shenja tregon për Njeshmërinë e Krijuesit më të madh.



1- “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës...”

Prej shenjave treguese të madhësisë së Allahut dhe të fuqisë së Tij, dijes së Tij dhe Njehsimit, është qielli dhe planetet që ndodhen në të.

2- “...në këmbimin e natës me ditën...”

Prej argumenteve të tjerë që tregojnë për madhësinë e Vetës së Shenjtë dhe atributet e Tij të larta është shkëmbimi i natës me ditën, i errësirës me dritën bazuar në një sistem të posaçëm. Njëra pakësohet gradualisht dhe shtohet tjetra. Nëpërmjet këtij shndërrimi lindin edhe katër stinët e vitit si dhe bimët dhe gjallesat e tjera rriten dhe zhvillohen.

Sikur të mos ishte ky shndërrim, gradualisht do të zhdukej jeta mbi sipërfaqen e tokës.

3- “...në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve...”

Njeriu lundron nëpër dete dhe oqeanë me anije të mëdha dhe të vogla, duke i përdorur këto anije si për udhëtime, ashtu edhe për mbartjen e materialeve. Lëvizjet e këtyre anijeve, veçanërisht të atyre me vela, kryhen nëpërmjet disa faktorëve:

Fryrja e erërave mbi sipërfaqen e ujit.

Ka disa lloj erërash. Prej tyre, era kontinentale, e cila fryn nga dy polet - veri dhe jug - drejt Ekuatorit, Tropikut dhe në të kundërt. Po ashtu, ka edhe erëra rajonale që fryjnë sipas një sistemi të caktuar dhe konsiderohen si fuqi natyrore për lëvizjen e anijeve.

Karakteristikat e dërrasës apo karakteristikat e fuqisë shtytëse që dominon uji mbi trupat e zhytur në të.

Kjo fuqi i bën anijet që të qëndrojnë mbi ujë. Në shtesë të këtyre janë edhe dy polet magnetike të rruzullit tokësor, që ndihmojnë marinarët në përdorimin e busullës, që të njohin drejtimin e tyre në mesin e detit. Për njohjen e drejtimit ata përdorin edhe sistemin e lëvizjes së yjeve.



Anijet përfitojnë nga të gjithë këta faktorë dhe i ndihmojnë ato përgjatë lundrimit. Po ashtu, këta tregojnë edhe për fuqinë dhe madhështinë e Allahut dhe konsiderohen shenja prej shenjave të pranisë së Tij.

Përdorimi i motorëve me karburant në këto ditë, në vend të velave, nuk e pakëson rëndësinë e dukjes së këtyre dukurive, përkundrazi ato e shtojnë edhe më shumë habinë dhe mahnitjen. Kjo, sepse sot ne shohim anije gjigante, të cilat i ngjajnë një qyteti që lundron mbi ujë, i pajisur me hotele, markete, vende dëfrimi etj. Jo vetëm kaq, por ka edhe anije që përmbajnë vend uljeje për avionë dhe lundrojnë nëpër dete dhe oqeanë.

4- “...në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash...”

Nga dukuritë e madhështisë së Allahut është edhe shiu, i cili e ringjall tokën dhe me mirësinë e të cilit mbijnë bimët. Me këto bimë ushqehen njerëzit dhe kafshët. E gjithë kjo gjallëri është prej pikave të ujit dhe, po të mos ishte uji në tokë, nuk do të kishte jetë.

5- “...në lëvizjen e erërave...”

Era nuk lëviz vetëm mbi sipërfaqen e ujërave të deteve e të oqeanëve për të lëvizur anijet, por edhe mbi majat e maleve e të kodrave, nëpër lugina e nëpër fusha për të kryer pllenimin e bimëve e të pemëve, nga të cilat hamë fruta të ndryshme.

Herë-herë, erërat kryejnë lëvizjen e dallgëve të ujërave në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e krijesave që gjenden në det. Herë tjetër ato bëjnë ndryshimin e temperaturës së ajrit dhe e bëjnë klimën sa më të këndshme, duke dërguar nxehtësinë



nga zonat ekuatoriale në zonat e ftohta dhe në të kundërt.

Nganjëherë kryejnë transportin e ajrit të ndotur nëpër qytete, duke e dërguar në shkretëtira e në pyje për të ndaluar grumbullimin e helmeve në hapësirë.

Po, fryrja e erërave, me të gjitha ato mirësi dhe përfitime, është një tjetër shenjë që tregon Urtësinë e Krijuesit dhe Bujarinë e Tij të vazhdueshme.

6- “...retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës...”

Edhe retë e grumbulluara lart në qiell, që mbartin me miliarda ton ujë, që nuk ndikohen nga graviteti i tokës dhe lëvizin nga një vend te tjetri, pa sjellë asnjë rrezik, shfaqin madhështinë e Allahut të Plotfuqishëm.

Në shtesë të shiut që vjen nga retë për të ringjallur tokën dhe me rigjallërimin e tokës, vazhdon jeta e bimëve, e kafshëve dhe e njerëzve. Po të mos jenë ato, toka do të ishte e pajetë. Kjo është një tjetër shenjë që qartëson dijen e pakufishme të Allahut dhe Fuqinë e Tij.

7- “...pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.” Dhe nuk janë shenja për të pavëmendshmit memecë, të shurdhër e të verbër.



TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN

Mësime nga surja “Bekare”

Abstrakt

Në ajetet kur'anore ka shumë mësimë. Në këtë artikull ka disa mësimë nga surja “Bekare”, si: Feja islame është fe globale dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha nevojave të njeriut, madje edhe lindjes së fëmijës dhe mënyrës së krijimit të familjes; Nëse mendojmë në rregullat dhe ligjet e Allahut, atëherë do të kuptojmë se të gjitha këto ligje janë vendosur në interes dhe në dobi të individit dhe të shoqërisë; Në zgjedhjen e bashkëshortit/ es dubet t’u kushtojmë rëndësi vlerave shpirtërore e jo bukurive të jashtme apo çështjeve materiale dhe të përkohshme; Familje e lumtur është ajo që është ndërtuar sipas ligjeve të Allahut. Nëse bashkëshortët duan ta vazhdojnë jetën me gjinabe dhe punë të paligjshme, atëherë shkuroreëzimi është më i mirë për ata të dy etj.

(Ajetet 215 – 221)

“Të pyesin ty çfarë të japin si lëmoshë. Thuaju: ‘Çfarëdo bamirësie që bëni, ajo le t’u takojë prindërve, farefisit, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di atë.’”

“Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por



mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”

“Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: ‘Luftimi në atë kohë është gjynah i madh, por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu. Kurse adhurimi i idhujve është gjynah më i madh se vrasja.’ Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t’ju kthejnë nga besimi juaj. Ata që e mohojnë fenë dhe vdesin si mohues, - veprat e tyre (të mira) do të humbasin në këtë botë dhe në Tjetrën. Ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

“Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”

“Të pyesin ty për verën dhe kumarin. Thuaju: ‘Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia.’ Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: ‘Tepicën!’ Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni.”

“Për këtë jetë dhe për Jetën Tjetër. Të pyesin ty për jetimët, thuaju: ‘T’u bëni mirë atyre është vepër e bukur. Nëse jetoni bashkë me ata, dijeni se janë vëllezërit tuaj. Allahu di ta dallojë keqbërësin prej mirëbërësit. Sikur të donte Allahu, do t’ju detyronte me punë të vështira. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare! Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse



kjo e fundit mund t'ju pëlqejë. Mos i martoni mysli-manet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t'ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet e falje (të gjynaheve). Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e Veta, që të mendojnë ata.”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Prindërit dhe të afërmit nevojtarë kanë prioritet kur flitet për t'i ndihmuar.

2- Veprat e mira nuk humbin, qofshin të hapura ose të fshehura.

3- Vlerë matëse për të mirën dhe të keqen nuk janë dëshirat e njeriut, por urdhrat e Zotit, të cilat janë përcaktuar në interes të lumturisë së njerëzimit.

4- Dija e njeriut është e kufizuar, kurse dija e Zotit është e pafund. Pra, pa dyshim që duhet të dorëzohemi përballë urdhrave të Zotit, edhe sikur në rrugën e kryerjes së disa urdhrave ne të përballemi me vështirësi dhe probleme.

5- Duhet të kemi kujdes në sjelljet dhe veprat tona, sepse armiku gabimet tona i shfrytëzon kundër nesh.

6- Në gjykime duhet të jemi realistë e jo sipërfaqësorë, duhet të vështrojmë rrënjët e ngjarjes e jo degët dhe gjethet e saj. Një person hipokrit dhe përçarës në pamje të jashtme, nuk vret askënd, mirëpo veprat e tij mund të bëhen shkak për trazira dhe pasiguri dhe ndoshta edhe vrasjen e një grupi të tërë njerëzish.

7- Gjatë zgjedhjes së punës, nuk duhet të zgjedhim atë



punë, e cila dëmton shpirtin dhe psikikën tonë, edhe sikur ajo punë të ketë të ardhura të mëdha. Ndoshta prodhimi dhe shitja e verës, apo bixhozi, mund të kenë të ardhura të shumta, por Kur'ani i ka ndaluar ato.

8- Duhet të mbrojmë lirinë dhe sigurinë e shoqërisë. Zoti e ka ndaluar verën, e cila dobëson mendjen dhe logjikën e njeriut, si dhe, ka ndaluar bixhozin, i cili shkakton pasiguri ekonomike dhe krime të ndryshme në shoqëri.

9- Me tepricën e pasurisë tonë duhet të ndihmojmë të varfrit dhe nevojtarët. Në këto kushte, ne kemi shpëtuar jetën e të tjerëve dhe kemi mbrojtur veten nga shpenzimet e tepruara.

10- Nëse mendojmë në rregullat dhe ligjet e Allahut, atëherë do të kuptojmë se të gjitha këto ligje janë vendosur në interes dhe në dobi të individit dhe të shoqërisë. Pra, të mos neglizhojmë në zbatimin e tyre.

11- Fëmijët pa mbikëqyrës apo bonjakët nuk duhet t'i lëmë të vetëm. Shoqëria islame duhet të kujdeset për ta dhe për pasurinë e tyre.

12- Akti i shenjtë i martesës duhet të mbyllet mbi bazën e besimit, në mënyrë që shoqërisë t'i dhurohet një gjeneratë e pastër dhe e mirë.

13- Në zgjedhjen e bashkëshortit/es duhet t'u kushtojmë rëndësi vlerave shpirtërore e jo bukurive të jashtme apo çështjeve materiale dhe të përkohshme. Të mendojmë për fundin e punëve: kjo martesë a na çon drejt Xhenetit apo drejt Xhehenemit?



(Ajetet 222 – 232)

“Të pyesin ty (Muhamed) për të përmuajshmet e femrave.

Thuaju: 'Ajo është gjendje e dëmshme.' Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu siç ju ka urdhëruar Allahu. Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen."

"Gratë tuaja janë 'ara' për ju, prandaj iu afroni 'arave' tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj (duke përmendur emrin e Allahut para kontaktit). Kijeni frikë Allahun dhe dijeni se do të takoheni me Të. Jepu lajm të mirë besimtarëve (se do fitojnë Xhenetin)!"

"Mos e bëni pengesë betimin në Allahun për kryerjen e veprave të mira, largimin prej të ligave dhe për pajtimin e njerëzve! Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha."

"Allahu nuk ju dënon nëse betoheni pa qëllim, por ju dënon për atë që vendosni në zemrat tuaja. Allahu është Falës i madh e i Butë."

"Ata që betohen se nuk do t'u afrohen grave të veta, duhet të presin katër muaj; nëse pendohen nga betimi, ta dinë se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë."

"E, nëse vendosin të ndahen, vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë."

"Gratë e ndara duhet të presin tri cikle mujore dhe nuk është e lejueshme ta fshehin atë që ka krijuar Allahu në mitrën e tyre, nëse besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit. Burrat e tyre, nëse dëshirojnë mirësi dhe qetësi, kanë të drejtë t'i kthejnë gjatë këtij afati. Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra, sipas arsyes së shëndoshë, ndonëse burrat kanë një shkallë (më shumë përgjegjësie) mbi ato. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

"Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaja ose



të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë. Burrave nuk u lejohet të marrin gjë nga ajo që iu kanë dhënë atyre, vetëm nëse të dyja palët frikësohen se nuk do t'i zbatojnë kufijtë e Allahut. Pra, nëse të dy frikësohen se nuk do të mund t'u përmbahen kufijve të Allahut, atëherë nuk është gjynah për asnjërin, nëse gruaja i jep diçka burrit (për t'u ndarë nga ai). Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë keqbërësit.”

“Më pas, nëse burri e ndan sërish gruan (për të tretën herë), nuk mund të martohet më me të, pa u martuar ajo me një burrë tjetër. Por, në qoftë se gruaja ndahet rregullisht nga burri i dytë, atëherë nuk kanë gjynah as ajo e as burri i parë që të martohen sërish me njëri-tjetrin, nëse mendojnë se do t'i respektojnë kufijtë e Allahut; këto janë urdhrat e Allahut, që Ai ua shpjegon njerëzve që kuptojnë.”

“Kur t'i ndani gratë dhe atyre t'u afrohet fundi i periudhës së pritjes, ose mbajini me të mirë, ose lërin i të ikin me të mirë. Dhe mos i mbani ato me qëllim lëndimi, se në këtë mënyrë i bëni padrejtësi vetes. Mos luani me shpalljet e Allahut! Kujtoni begatitë që ju ka dhënë Ai, si dhe Librin (Kur'anin) dhe diturinë e hollësishme, që jua ka zbritur për t'ju këshilluar. Kini frikë Allahun dhe ta dini se Allahu është i Ditur për çdo gjë!”

“Kur t'i lini gratë të lira dhe ato të kenë plotësuar kohën e pritjes, mos i pengoni ato që të martohen përsëri me burrat e tyre, nëse merren vesh me të mirë! Kështu këshillohet çdokush prej jush që beson Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e ndershme dhe më e virtytshme. Allahu di, kurse ju nuk dini.”



Nga këto ajete mësojmë:

1- Feja islame është fe globale dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha nevojave të njeriut, madje edhe lindjes së fëmijës dhe mënyrës së krijimit të familjes.

2- Rregullat fetare janë në përputhje me sistemin e krijimit dhe çdo gjë që dëmton individin dhe të tjerët, është e ndaluar. Në këtë mënyrë garantohet shëndeti i anëtarëve të shoqërisë.

3- Ndjenjat e njeriut duhet të kontrollohen.

4- Femra në Islam është krahasuar me një lulishte e cila është qetësim për burrin dhe mjet për edukimin e fëmijëve të pastër dhe luleve me aromë të këndshme.

5- Betimin të mos e bëjmë pengesë për kryerjen e punëve të mira dhe Emrin e Shenjtë të Zotit të mos e shfrytëzojmë për gjëra të kota dhe të pavlefshme.

6- Allahu është Falës i madh e i Butë. Edhe ne duhet t'i falim personat, të cilët flasin ndonjë fjalë pa e menduar apo me nervozizëm e jo të biem në nivelin e tyre dhe të hakmerremi.

7- Çrrënjësja e traditave, trillimeve të kota dhe injorante nga mesi i shoqërisë është ndër detyrat e profetëve për të përmirësuar gjendjen e shoqërisë.

8- Është e natyrshme që menaxhimi i shtëpisë financiarisht është detyrë e burrit, mirëpo ai nuk ka të drejtë që ta mendojë dhe ta torturojë gruan e tij.

9- Feja islame e ka pranuar shkurorëzimin me të gjitha vetitë e tij të hidhura, por nuk e pranon në asnjë mënyrë që gruaja të vendoset në pozitë të vështirë dhe të lëndohet. Natyrisht, shkurorëzimi pranohet në kohën kur ai të jetë në dobi të familjes e jo në bazë të epsheve dhe të dëshirave të kota



të burrit ose të gruas.

10- Përveç të drejtave njerëzore të gruas, edhe të drejtat financiare të saj duhen përmbushur dhe burri nuk ka të drejtë që ta konfiskojë diçka nga paga e kurorës apo nga pasuria e gruas.

11- Shkurorëzimi, nëse është i nevojshëm, duhet të bëhet me mirësi dhe me mirëkuptim e jo me hidhërim e inat.

12- Familje e lumtur është ajo që është ndërtuar sipas ligjeve të Allahut. Nëse bashkëshortët duan ta vazhdojnë jetën me gjynahe dhe punë të paligjshme, atëherë shkurorëzimi është më i mirë për ata të dy.

13 - Mendimi dhe vendimi i femrës në zgjedhjen e burrit është i vlefshëm dhe i nevojshëm. Esenca e martesës është rënia dakort e femrës dhe e mashkullit në kuadrin e lejuar me fe.

(Ajetet 233 – 244)

“Nënat le t’u japin gji fëmijëve të tyre dy vjet, për ata që duan t’ia plotësojnë dhënien e gjirit. Babai i fëmijës ka për detyrë, sipas mundësisë së tij, që t’i sigurojë si duhet ushqim dhe veshmbathje. Nuk ngarkohet askush përtej mundësisë që ka: nëna le të mos dëmtohet për shkak të fëmijës së saj e as babai të mos dëmtohet për shkak të tij. Edhe trashëgimtari ka të njëjtat detyrime për të gjitha këto. Por, nëse pas këshillimit, ata vendosin me pëlqim të ndërsjellë që ta ndajnë fëmijën nga gjiri, kjo nuk është gjynah për ata. Po ashtu, nuk është gjynah për ju nëse doni t’i gjeni fëmijës suaj ndonjë mëndeshë, me kusht që t’ia jepni atë që e keni menduar, sipas rregullave. Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Allahu i sheh mirë të gjitha



punët që bëni ju.”

“Gratë të cilave iu vdes burri, duhet të presin katër muaj e dhjetë ditë (pas vdekjes së tij). Pas kalimit të këtij afati, ju nuk jeni përgjegjës për çfarë bëjnë ato me jetën e tyre sipas rregullave. Allahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”

“Nuk është gjynah për ju nëse grave të tilla u jepni shenjë se do t’i kërkon apo nëse këtë qëllim e fshihni në shpirtin tuaj. Allahu e di se do të mendoni për ato, por mos u premtoni atyre fshehurazi, vetëm nëse bisedoni me to ndershmërisht. Dhe mos vendosni për martesë para se të kalojë afati i paraparë i pritjes. Ta dini se Allahu e di ç’ka në zemrat tuaja, andaj ruajuni prej Tij. Dhe ta dini se Allahu është Falës i madh dhe i Butë.”

“Nuk është gjynah për ju nëse i ndani gratë para se të keni marrëdhënie me to ose para se të caktoni shumë e dhuratës martesore (që do t’u jepni). Por u jepni dhuratë të pëlqyeshme: i pasuri sipas gjendjes së tij dhe i vobekti sipas gjendjes së vet. Kjo është detyrë e atyre që dëshirojnë të bëjnë vepra të mira.”

“Në qoftë se i ndani gratë para se të keni marrëdhënie me to, por ia keni caktuar shumë e dhuratës martesore, atëherë atyre u përket gjysma e dhuratës, veç nëse ua falin ato ose ua falin ata që kanë në dorë lidhjen e martesës. Por që të falni është më pranë devotshmërisë. Mos harroni që të bëheni bamirës midis jush! Vërtet, Allahu e sheh mirë se çfarë bëni.”

“Faleni rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij.”

“Nëse keni frikë, faluni duke qenë në këmbë ose hipur



(mbi kalë)! Kur të jeni të sigurtë, atëherë t'i kryeni faljet për Allahun, ashtu si ju ka mësuar Ai atë që nuk e keni ditur!”

“Ata prej jush, të cilëve iu është afruar vdekja dhe kanë gra për të lënë pas, duhet t'u lënë atyre në testament mjetet për të jetuar një vit, pa i bërë që të dalin nga shtëpia. Por, nëse ato vetë e braktisin shtëpinë, ju nuk jeni përgjegjës për çfarë bëjnë me jetën e tyre sipas rregullave. Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë.”

“Grave të ndara u takon sigurimi i caktuar i shpenzimeve të jetesës. Kjo është detyrë e besimtarëve.”

“Kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Veta, në mënyrë që të kuptoni.”

“Mendo (o Muhamed) për ata që me mijëra ikën nga qytetet e tyre nga frika e vdekjes. Allahu u tha atyre ‘Vdisni!’ e pastaj, i ringjalli ata. Vërtet, Allahu zotëron mirësi të mëdha për njerëzit, por shumica e tyre nuk e falënderojnë.”

“Luftoni në rrugën e Allahut dhe ta dini se Allahu i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Prindërit janë të detyruar që t'i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Edhe në rast të shkurorëzimit, fëmijët nuk duhet të bëhen viktimë e mosmarrëveshjeve të prindërve.

2- Në fenë islame, burri është i detyruar që t'i sigurojë nevojat themelore familjes, ndërsa gruaja nuk ka asnjë detyrim për sigurimin e të ardhurave të familjes.

3- Islami është fe natyrore dhe çdo njeri ka nevojë



natyrore për martesë. Si rrjedhim, Islami, jo vetëm që nuk e ka kundërshtuar këtë nevojë natyrore, por ka shpjeguar edhe rrugët e lejuara për femrën dhe mashkullin në këtë drejtim.

4- Duhet të ruhem nga sjelljet e pahijshme përpara martesës.

5 - Familje kur'anore është ajo që edhe në rast të shkurorëzimit, i respekton rregullat morale dhe bujarinë. Në rast të shkurorëzimit, palët duke zbatuar detyrimet e tyre, duhet të ndahen me qetësi dhe bujari e jo me mëri dhe agresivitet.

6- Nevoja e njeriut për namaz është e vazhdueshme dhe e përrjetshme, madje edhe në kushte lufte. Namazi, jo vetëm që nuk pengon mbrojtjen dhe luftimin, por bëhet shkak për forcimin e shpirtit dhe forcimin e moralit të luftëtarit.

7- Feja islame i ka kushtuar vëmendje të veçantë të drejtave të gruas në familje dhe sigurimit të jetës së saj, edhe pas vdekjes së burrit. Gjithashtu, edhe shkurorëzimin e ka cilësuar të nevojshëm.

8- Femra është e lirë që të zgjedhë burrë të përshtatshëm për vete. Personaliteti i saj duhet të respektohet në familje.

9- Ringjallja e të vdekurve në Ditën e Gjykimit nuk është diçka e pamundur, sepse Zoti Fuqiplotë, në disa raste edhe në këtë botë i ka ngjallur të vdekurit.

10- Xhiahadi islam (lufta në rrugën e Zotit) është për të mbrojtur fenë e Zotit e jo për zgjerimin e shtetit, demonstrimin e fuqisë, pushtimin dhe dhunën ndaj të tjerëve.



ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI

XI

Lëkura flet¹

Abstrakt

Kur'ani thotë se Ditën e Ringjalljes dyshuesit në Fjalën e Allahut do të dalin para zjarrit dhe prej dëshmitarëve të tyre do të jenë edhe lëkurët e veta. Lëkura përbëhet nga shtresa. Këto shtresa përbëhen nga qelizat. Qelizat kanë aftësinë e depozitimit të të dhënave për një kohë të gjatë. Prandaj dijetarët thonë se lëkura ka kujtesë afatgjatë. Dijetarët vërtetësojnë praninë e zërit në qelizat e lëkurës, me të cilin ajo flet, por ne nuk e kuptojmë se çfarë thotë. Ky zbulim i ri nuk njëbej në kohën e zbrijes së Kur'anit, mirëpo Kur'ani na ka thënë se çdo gjë e lartëson Allahun. Ne, si besimtarë na ka mësuar Kur'ani se si t'i bëjmë qelizat e lëkurës sonë më aktive nëpërmjet reagimit të saj ndaj fjalës së Allahut. Allahu i Madhëruar thotë: “Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura



¹ E përktheu nga gjuha arabe h. Vullnet Merja.

atyre, që i frikësohen Zotit të tyre e pastaj qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu...” (Sure “Zumer”, ajeti 23). Pra, leximi a këndimi i Kur'anit dhe dëgjimi i tij janë mjeti më i mirë për mbrojtjen e qelizave të lëkurës dhe të qelizave të trupit, në përgjithësi. Nga ky ajet kuptohet se qelizat e lëkurës ndikohen nga tingujt zanorë, madje ato reagojnë ndaj tyre.

Këto ditë studime të ndryshme shkencore na zbulojnë një të vërtetë të re të cilën askush nuk e dinte. Pas një vështrimi të hollësishëm kuptojmë se këtë të vërtetë e thotë Kur'ani i Shenjtë. Vërtet, kjo është një prej shenjave të madhësisë së Fjalës së Allahut të Madhëruar, Kur'anit të Shenjtë, i cili thotë: **“...E kush është më i vërtetë se Allahu në fjalë?”** (Sure “Nisa”, ajeti 122).

Kur'ani thotë se Ditën e Ringjalljes dyshuesit në Fjalën e Allahut do të dalin para zjarrit dhe prej dëshmitarëve të tyre do të jenë edhe lëkurët e veta. Ato lëkura do të dëshmojnë çdo përgënjeshtim dhe trillim që dyshuesit dhe mohuesit thoshin për Allahun në këtë jetë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Paralajmëroji ata për Ditën, kur do të tubohen armiqtë e Allahut për në zjarr e do të shtyhen me radhë.”**

“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.”

“Ata do t'u thonë lëkurëve të veta: ‘Pse dëshmuat kundër nesh?’ e ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.’” (Sure “Fussilet”, ajetet 19-21).

Këtu shtrohen disa pyetje: Si është e mundur që sytë,



veshët dhe lëkura të flasin? Si është e mundur që gjithçka mund të flasë? Përse e përmend Allahu këtë tekst në Librin e Tij? Këtë do ta shpjegojmë me qëllim që të na shtohet besimi dhe të jemi prej atyre për të cilët Allahu thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.”** (Sure “Enfal”, ajeti 2)

Mrekullia e lëkurës

Lëkura është organi më i madh i trupit. Sipërfaqja e shtresës së jashtme të lëkurës që mbulon trupin e njeriut arrin në 2 metra katrorë, pra, sa madhësia e një batanije apo të një çarçafi. Pesha e lëkurës së një njeriu mesatar arrin në rreth 2.7 kilogram. Ajo ndihmon në rregullimin e temperaturës së trupit.

Ajo funksionon si mbështjellëse mbrojtëse. Ajo na mbron ne nga dëmet dhe të këqijat e mjedisit ku jetojmë, si të nxehtë, të ftohtë, papastërtitë, bakteret dhe ndotjet. Ajo e mbron trupin nga mikrobet.

Lëkura sekreton yndyrna dhe vajra dhe i reziston tharjes. Ajo ka gjëndra të veçanta për sekretimin e djersës. Ato janë mjet për largimin e helmeve dhe të lëndëve kimike. Lëkura përbëhet nga shtresa të holla që përmbajnë enë gjaku, qeliza nervore, qime etj. Lëkura është gjithmonë në lëvizje të përhershme. Qelizat rriten dhe lëvizin nga shtresat e brendshme për në sipërfaqe të jashtme, pastaj vdesin dhe ndërrohen. Për çdo minutë lëkura ndërron 40 mijë qeliza! Gjatë një muaji ndërrohen të gjitha qelizat e lëkurës. Pra, çdo muaj çdonjëri prej nesh e ndërron lëkurën e tij pa e ndier!

Vërtet, 95 % prej qelizave të lëkurës kanë një mision



të përbashkët: ndërrimin e qelizave. 5 % e tyre punojnë për ngjyrimin e lëkurës me ngjyrën e përshtatshme, pra, për prodhimin e lëndës melanin. Studiuesit kanë zbuluar se ekspozimi i lëkurës në diell për një kohë të gjatë çon në kancerin e lëkurës - më shumë te femrat. Këtu duket qartë edhe urdhri i Allahut për mbulimin e femrës.

Kujtesa e lëkurës

Për disa vjet me radhë dijetarët janë përpjekur të zbulojnë sekretet e kujtesës dhe të informacioneve të njeriu. Cilat ishin rezultatet e hulumtimeve të fundit për kujtesën? Ata e dinë se ka një kujtesë të trashëguar që ndodhet në ADN. Në një studim të fundit, në mesin e vitit 2007, të cilin e ka botuar revista shkencore e neurologjisë, shkencëtarët kanë zbuluar se qelizat përmbajnë pjesë që quhen CaMKII. Këto janë përgjegjëse për mbajtjen e kujtimeve. Ky rezultat është i pari që zbulohet. Me këtë rezultat shkencëtarët kanë vërtetësuar se kur këto pjesë u goditën te miu, kujtesa u fshi plotësisht, por pas kësaj iu rikthye aftësia për ruajtje. Kjo është një lloj si hardhisku i kompjuterit, ku ruhen të dhëna, të cilat mund të fshihen dhe pastaj të depozitohen të dhëna të reja. Mendohet që kjo kujtesë të jetë tek të gjitha qelizat e gjallesave. Dijetarët flasin për kujtesën e zemrës, të qelizave, të lëkurës etj.

Lëkura përbëhet nga shtresa. Këto shtresa përbëhen nga qeliza. Qelizat kanë aftësinë e depozitimit të të dhënave për një kohë të gjatë. Prandaj dijetarët thonë se lëkura ka kujtesë afatgjatë. Në një studim të ri është sqaruar se qelizat e lëkurës e mbrojnë veten gjithmonë nga sulmet e baktereve. Përdorimi i shumtë i telefonave celularë çon në rritjen e disa lloj bakteresh në lëkurë. Shkaku është se lëkura ka një mision delikat në ruajtjen e të dhënave dhe ndodhive dhe përdorimi i shpeshtë i celularit çon në çoroditjen e veprimtarisë së qelizave



për shkak të valëve elektromagnetike që ai pret e përcjell.

Sot dijetarët përpiqen të përfitojnë nga qelizat e lëkurës të nxjerra nga qelizat staminale. Ata thonë se këto qeliza ndikojnë shumë në shërimin e djegieve. Këto qeliza nuk depozitojnë asnjë të dhënë dhe prandaj ato janë të pastra dhe mund t'i vendosen çdo njeriu, të cilit i janë djegur pjesë të trupit të tij.

Gjuha e lëkurës

Dijetarët vërtetësojnë praninë e zërit në qelizat e lëkurës, me të cilin ajo flet, por ne nuk e kuptojmë se çfarë thotë. Ky zbulim i ri nuk njihet në kohën e zbriës së Kur'anit, mirëpo Kur'ani na ka thënë se çdo gjë e lartëson Allahun.

Dijetarët thonë se shiriti i ADN-së, që është shumë delikat, nxjerr tinguj zanorë vazhdimisht. Pra ai ka një gjuhë që flet. Ky shirit ndodhet në të gjitha qelizat e trupit, në qelizat e syrit, të veshit, të lëkurës. Prandaj, është e mundur që ky shirit të depozitojë të dhëna, të cilat mund të nxirren në një kohë tjetër.

Në thellësi të qelizave të lëkurës ka regjistruar, të ngjashëm me regjistruarët e kompjuterit, që ruajnë të dhënat dhe ndodhitë përreth lëkurës. Po ashtu, ruajnë zërat e bisedave dhe veprimet që bëjmë. Doktor Klark Utl, i cili ka mbikëqyrur me qindra operacione të mbjelljes së lëkurës te persona të tjerë, thotë: Vërtet, lëkura ka kujtesë shumë të gjatë dhe nuk harron. Dijetari arriti në këtë përfundim pasi gjeti se 70 % e personave, që iu mboll lëkurë e marrë prej personave të tjerë, pas një periudhe të shkurtër kohore, u goditën me sëmundjen e kancerit të lëkurës. Këtij problemi të madh mjekët nuk kanë



arritur t'i gjejnë shërim. Dermatologët thonë se lëkura e çdo njeriu ka veçori të mëdha dhe është depozitë e të dhënave. Prandaj, kur ndodh mbjellja e një pjese të lëkurës te një njeri tjetër, të cilit i është djegur lëkura, qelizat përcjellin të gjitha ndodhitë dhe të dhënat e posaçme të tij. Këtë, pra lëkurën e një personi tjetër e refuzon trupi i të sëmurit.

Ne, si myslimanë mund të propozojmë shërim për këtë. Shërimi është këndimi a leximi i Kur'anit për lëkurën para mbjelljes së saj, me qëllim që ajo të pastrohet dhe të jetë e përshtatshme për të sëmurin. Sigurisht, ne e dimë ndikimin e madh të shërimit me Kur'an: Melodia e Kur'anit ndikon shumë në rikthimin e aktivitetit e veprimtarisë së qelizave dhe të programit të saj, me natyrën krijuese (*el fîtratu*), me të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit.

Gjithçka flet

Pas modernizimit të aparaturave matëse të tingujve zanorë, dijetarët kanë zbuluar se gjithësia nxjerr tinguj zanorë. Janë qelizat ato që i nxjerrin këta tinguj, qoftë te njeriu, te kafshët dhe te bimët. Në fillim të krijimit të tij, universi ka nxjerrë tinguj zanorë për shkak të zgjerimit të tij të papritur. Dijetarët e agjencisë NASA kanë zbuluar se vrimat e zeza nxjerrin tinguj zanorë. Edhe yjet Neutronije nxjerrin tinguj zanorë, të ngjashëm me tingullin e çekiçit. Dijetarët e botanikës kanë zbuluar se bimët nxjerrin tinguj të fshehte dhe ndikohen nga zërat (tingujt). Të gjitha kandrrat kanë tingujt e tyre të posaçëm zanorë. Madje, edhe qelizat e zemrës nxjerrin tinguj të posaçëm zanorë. Kështu, çdo gjë në këtë gjithësi flet. Prandaj, të gjitha krijesat - njeriu, kafshët dhe sendet ndikohen nga zëri. Prandaj, kur trupi përballlet me valët e zërit, fillon të reagojë.



Mrekullia

1- Ne, si besimtarë na ka mësuar Kur'ani se si t'i bëjmë qelizat e lëkurës sonë më aktive nëpërmjet reagimit të saj ndaj fjalës së Allahut. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre, që i frikësohen Zotit të tyre e pastaj qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu...”** (Sure “Zumer”, ajeti 23). Pra, leximi a këndimi i Kur'anit dhe dëgjimi i tij janë mjeti më i mirë për mbrojtjen e qelizave të lëkurës dhe të qelizave të trupit, në përgjithësi. Nga ky ajet kuptohet se qelizat e lëkurës ndikohen nga tingujt zanorë, madje ato reagojnë ndaj tyre, kur njeriu dëgjon një lajm të gëzueshëm apo të dhembshëm. Ajeti vërtetëson se lëkura e besimtarit ndikohet nga dëgjimi i Kur'anit, kurse jobesimtari nuk reagon aspak. E përse kjo? Sepse qelizat e lëkurës së jobesimtarit kanë depozituar hipokrizinë, mosbesimin, të këqijat, veprat e këqija; prandaj lëkura e tij nuk reagon aspak ndaj tingujve zanorë të besimit.

2- U tha se qelizat e lëkurës ndërrohen vazhdimisht. Këtë e tregon edhe Kur'ani kur përmend dënimin e atyre që i mohojnë argumentet e Allahut me ndërtimin e vazhdueshëm të lëkurës së tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata që s'besojnë në shenjat Tona, Ne pa dyshim, do t'i djegim në zjarr. Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”** (Sure “Nisa”, ajeti 56). Sa herë që digjen qelizat nervore dhe sapo ndihet se dhembja po largohet, ato të ripërtërihen dhe dënimi të bëhet edhe më i ashpër.

3- Pas të vërtetave të lartpërmendura, mund të thuhet se



të gjitha qelizat kanë një kujtesë të posaçme, veçanërisht qelizat e të dëgjuarit dhe ato të të parit. Të dëgjuarit dhe të parët do të dëshmojnë Ditën e Gjykimit për njeriun për ato punë të këqija që ka bërë në këtë jetë. Atë ditë, njeriu nuk do të habitet nga dëshmia e të dëgjuarit sepse veshi ka dëgjuar ato që janë thënë para tij. Ai nuk do të habitet as nga dëshmia e të parit sepse syri ka parë dhe ka depozituar gjynahet ndaj Allahut. Njeriu do të habitet më shumë me dëshminë e lëkurës së tij: ajo do të dëshmojë kundër. E njeriu nuk arrin ta kuptojë se sa rol ka lëkura në ruajtjen e të dhënave dhe të ngjarjeve. Prandaj njerëzit punëkëqij do të pyesin lëkurat e tyre Ditën e Gjykimit: **“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: ‘Pse dëshmuat kundër nesh?’ e ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.’”** (Sure “Fusilet”, ajeti 21).

4- Meqenëse çdo gjë ka tingujt e vet zanorë, siç u pa edhe më lart, Allahu i Madhëruar thotë: **“...Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ato. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.”** (Sure “Isra”, ajeti 44). Ditën e Gjykimit njeriu do t’i dëgjojë zërat e këtyre krijesave që nuk i ka pasë dëgjuar në këtë jetë. Do të dëgjojë zërin e lëkurës së tij, që do të dëshmojë kundër tij dhe do t’i thotë: A e kujton atë ditë, kur bëje punë të këqija, duke menduar se nuk të shikonte askush? Të dëgjuarit e tij i thotë: A e kujton, kur dëgjoje nga ajo muzikë që e kishte ndaluar Allahu dhe fjalët e këqija e të ndaluara? Të parët do të thotë: A e kujton, kur shikoje ato që i kishte ndaluar Allahu - femrat dhe gjërat e pashmëtyrueshme?

Vëlla besimtar dhe motër besimtare! Duhet që në çdo çast të jetës sonë ta kujtojmë atë Ditë, kur do të dëshmojnë lëkurët tona. Të mendojmë së bashku se kjo lëkurë që Allahu na e ka bërë mbrojtje për trupin tonë dhe që na shoqëron që nga



koha kur kemi qenë në mitrat e nënave tona, do të jetë armikja jonë Ditën e Gjykimit - përveçse nëse do të bëjmë vepra të mira. Nëse do të bëjmë vepra të mira, lëkura do të dëshmojë për ty dhe jo kundër teje. E lusim Allahun e Madhëruar që çdo çast të jetës sonë ta bëjë bindje ndaj Allahut dhe në çdo çast të jetës tonë të bëjmë punë të mira, me të cilat të fitojmë kënaqësinë e Allahut. Ta rrënjosim këtë tekst kur'anor në zemrën tonë dhe ta kujtojmë vazhdimisht sa herë që Uni na urdhëron për të këqija. Ky tekst është: **“Paralajmëroji ata për Ditën, kur do të tubohen armiqtë e Allahut për në zjarr e do të shtyhen me radhë.”**

“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.”

“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: ‘Pse dëshmuat kundër nesh?’ e ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.’”

“Ju nuk u fshehët, që kundër jush të mos dëshmonin veshët tuaj, sytë tuaj e lëkura juaj, por ngaqë besonit se Allahu nuk i dinte shumë nga ato që bënit.” (Sure “Fusilet”, ajetet 19-22.)

Burimet:

- 1- *New Research Sheds Light On Memory by Erasing It*, Science Daily.com, May 10, 2007.
- 2- Dr. Guarneri, *The Heart Speaks*.
- 3- *Cell Phones Causing Skin Infections*, www.switched.com, Jul 16th, 2007.
- 4- *Fetal Skin Cells Heal Burns*, Nature, 2004.
- 5- *Researchers Make Stem Cells from Skin*, The Financial Times, June 6, 2007.



- 6- *Genetically Modified Skin Cells Fight Infection*, www.livescience.com, 09 January, 2007.
- 8- *Skin Cells 'Fight Child Cancer'*, www.bbc.co.uk, 7 July, 2007.
- 9- *Listen to your DNA*, www.bbc.co.uk, November 26, 1998.
- 10- *Specifically Activated Memory T Cell Subsets from Cancer Patients Recognize and Reject Xenotransplanted Autologous Tumors*, American Society for Clinical Investigation, 2004.
- 11- Jill Neimark, *Sound healing*, www.findarticles.com, March, 2004.



BUBULLIMA DHE VETËTIMA ARGUMENTE TË FUQISË SË PAKUFISHME TË ALLAHUT

Abstrakt

Duke treguar krijimet e Tij dhe dobitë e krijimeve të Tij, Allahu i Madhëruar hedh dritën e besimit në zemrat e besimtarëve. Prej këtyre dukurive janë edhe bubullima e vetëtima. Allahu i Lartësuar thotë: “Ai (Allahu) jua tregon juve vetëtimën, duke ju bërë të frikësoheni e të shpresoni”. Është e vërtetë. Vetëtima e bubullima shkaktojnë frikë te njerëzit. Por vetëtima e bubullima janë shkak që shiu të zbresë, të gjallërohet toka, të ujitën bimët dhe të kënaqen njerëzit. Ndërmjet frikës e shpresës njeriu kalon momente të ndjeshme, siç thotë Allahu i Lartësuar: “Është Ai që krijon re të rënda (me shi)”, për t’u ujitur tokat bujqësore.

“Bubullima e madhëron Atë (Allahun) me falënderim...”
(Surja “Ra`d”, ajeti 13).

Dukuritë e mahnitshme natyrore janë të zakonshme për njeriun. Por ato dëshmojnë madhërinë e Allahut dhe misteret e krijimeve të Tij. Duke treguar krijimet e tij dhe dobitë e krijimeve të tij (krijimit), Allahu i Madhëruar hedh dritën e



besimit në zemrat e besimtarëve. Kështu, lidhja e besimtarëve bëhet me e afërt me Allahun.

Prej këtyre dukurive janë edhe bubullima e vetëtima. Njeriu, gjatë gjithë jetës së tij, me qindra herë ka parë dhe do ta shohë këtë fenomen, sidomos, në stinën e pranverës, kur shirat janë më të shumtë. Por Zoti i botëve, me bubullimën dhe vetëtimën na tregon Fuqinë e Tij Absolute. **“Prej shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”**¹

Shkëndija e rrufesë që del nga retë e dendura, herëherë e shoqëruar me krismën e veçantë të bubullimës, edhe pse e shkëlqyeshme dhe e ndritshme, në shumë raste e tmerron njeriun. Nëse frika dhe tmerri nga ajo janë të atillë saqë shumica e njerëzve të frikësohen e të tmerrohen, atëherë duhet që të falet *namaži ajat* (namazi i ndodhive natyrore si, tërmeti, eklipsi etj.) Shkëndia e saj është aq e fuqishme e aq edhe e rrezikshme. Zhurma e vetëtimës është aq e lartë, saqë mund ta dëmtojë dëgjimin përgjithmonë. Drita e saj është aq e forte, saqë mund edhe të marrë shikimin e njerëzve. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Ose, kur gjatë rënies së shiut nga qielli, të shoqëruar me errësirë, bubullimë dhe shkretimë, i mbyllin veshët me gishtat e tyre për të mos dëgjuar shkretimën nga frika e vdekjes. Dhe Allahu i ka nën kontroll mohuesit. (Drita ndiqese e) shkretimës, pothuaj, ua merr shikimin. Sa herë që ajo ua ndriçon rrugën, ata ecin disa hapa (nën ndriçimin e saj) dhe kur ajo fiket, ndalojnë. E, sikur të dojë Allahu, do t'ua merrte dëgjimin dhe shikimin e tyre. Pa dyshim, Allahu është i**

¹ Sureja “Rrum”, ajeti 24.



Fuqishëm për çdo gjë.”²

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai (Allahu) jua tregon juve vetëtimën, duke ju bërë të frikësoheni e të shpresoni”**. Është e vërtetë. Vetëtimja e bubullima shkaktojnë frikë te njerëzit. Por vetëtimja e bubullima janë shkak që shiu të zbresë, të gjallërohet toka, të ujiten bimët dhe të kënaqen njerëzit. Ndërmjet frikës e shpresës njeriu kalon momente të ndjeshme, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Është Ai që krijon re të rënda (me shi)”**³, për t’u ujitur tokat bujqësore.

Nga pikëpamja shkencore, vetëtimja është rezultat i bashkimit të dy reve me ngarkesa të ndryshme elektrike. Kështu ndodh edhe kur bashkohen dy telat që kanë rrymë pozitive e negative.

Vetëtimja është vetëm disa centimetra në diametër, por intensiteti i dritës së saj është sa 1 milion llamba 100 vatëshe.⁴ Allahu thotë: **“Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra, breshër dhe me të godit këdo, e ia largon atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati se s’të merr të parët..”**⁵

Kurse një shkarkim rrufeje mund të arrijë shpejtësinë prej 60.000 m/s dhe temperaturën rreth 30.000 °C.

Kur analizohet formimi i rrufesë, mund të shihet se një e vërtetë e rëndësishme meteorologjike po tregohet në këtë ajet. Për formimin e rrufesë, libri *Meteorologjia Sof*⁶ thotë se reja

2 Surja “Bekare”, ajetet 19, 20.

3 Surja “Ra’d”, ajeti 12.

4 Shkencëtarët ende nuk e dinë saktësisht se çfarë e shkakton rrufenë. Ata besojnë se trazirat në vetë retë krijojnë energji elektrike në pikat e ujit. Ngarkesa negative formohet në mes të reve, kurse ajo pozitive, në krye dhe në fund të tyre. Një ngarkesë pozitive krijohet edhe në tokë. Pra, një rrufe, ndodh kur elektriciteti grumbullohet në retë e stuhishme. Pikat ujore mbushen me ngarkesa pozitive dhe negative. Në fillim, shkëndijat hidhen nga ngarkesa negative në ato pozitive. Por, kur ngarkesa negative refuzohet, mund ta përshkojë atmosferën, e cila vepron si një izolues dhe të arrijë në tokë me ngarkesë pozitive.

5 Surja “Nur”, ajeti 43.

6 C. Donald Ahrens, *Meteorology Today: An Introduction to Weather, Climate and Environment*, 3rd ed. (St. Paul: West Publishing Company: 1988), f.437.



bëhet e elektrizuar.

Në ajetin 19 të sures “Bekare” na tregohet lidhja në mes reve të shiut dhe rrufesë. **“(Shembulli i tyre është) si ndonjë shi i rreptë prej së larti me errësirë, me bubullimë e me vetëtimë e prej frikës së vdekjes nga rrufeja, ata vënë gishtat në veshët.”** Ky informacion, që jepet aty, shkon një me një me zbulimet e sotme shkencore: Retë e shiut janë masa të mëdha që mbulojnë 20 deri 260 kilometra katrorë (10 deri 100 milje katrorë) dhe që arrijnë lartësi vertikale prej 9,000 deri 12,000 metra (30,000 deri 40,000 ft.) Për shkak të këtyre dimensioneve të jashtëzakonshme, pjesa e ulët e këtyre reve është e errët. Është e pamundur për rrezet e diellit të kalojnë tejprtej tyre për shkak të sasive të mëdha të ujit dhe të grimcave të akullit që ato përmbajnë. Toka merr shumë pak energji diellore nëpërmjet reve. Kjo është arsyeja pse retë duken të errëta, kur shikon lart. Fazat e formimit të rrufesë dhe të bubullimës pas errësirës që përmendet në ajet, janë: Formohet një ngarkesë elektrike brenda resë së shiut si rezultat i proceseve të tilla, si ngrirja, ndarja e pikave të shiut dhe formimi i ngarkesës elektrike gjatë kontaktit. Akumulimi i ngarkesave të tilla elektrike, kur ajri në mes bëhet i paaftë që t’i izolojë ato, çon në një shkëndi të madhe, në një shkarkim ndërmjet fushave pozitive dhe negative. Sasia e voltëve ndërmjet dy zonave me ngarkesë të kundërt mund të arrijë 1 miliardë. Shkëndija mund të formohet brenda resë, mund të kalojë midis dy reve, nga një zonë me ngarkesë pozitive gjithashtu, në një tjetër zonë po me ngarkesë pozitive.⁷ Këto shkëndija formojnë goditjen verbuese të rrufeve. Kjo rritje e papritur në ngarkesën elektrike shkakton nxehtësi të madhe (10,000 gradë Celcius). Si rezultat, ka një zgjerim të

⁷ www.scibd.com



papritur të ajrit, që shkakton zhurmë të madhe, shoqëruar me bubullimë.

Edhe bubullima e madhëron Allahu, Zotin Një e të Vetëm, me falënderimin që i takon vetëm Atij. **“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në qiej dhe në Tokë. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë. Ai është, vërtet, i Butë dhe Falës.”**⁸
“Bubullima e madhëron Atë me falënderim; por edhe melekët (e falënderojnë), nga frika prej Tij. E Ai dërgon rrufetë dhe me ato godet kë të dojë. Ndërsa idhujtarët polemizojnë rreth Allahut. E Ai është Ndëshkues i rreptë.”⁹

Në këto ajete thuhet se Allahun e madhëron çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë. Po. Çdo gjë i bën falënderim e tesbih Allahut të Lartësuar.

Në ajetin 13 të sures “Ra’d” për rrufenë thuhet: **“Ai i dërgon rrufetë dhe godet me to kë të dojë”**. Të gjitha këto dëshmojnë Argumentet e Madhërisë së Allahut në botën e krijimit të qiejve dhe të Tokës. Por idhujtarët polemizojnë e diskutojnë për ekzistencën e Allahut të Lartësuar. **“Dhe ata përsëri diskutojnë për Allahun, ndërkohë që Ai është Ndëshkues i rreptë”**.¹⁰

Në Kur’an ka edhe ajete të tjera që flasin për ndëshkimin e Allahut me rrufenë:

“Nëse ata shmangen, ti thuaju: ‘Ju paralajmëroj me rrufenë që goditi fiset Ad dhe Themud.’”¹¹

“Ne ia treguam Rrugën e Drejtë fisit Themud, por ai parapëlqeu verbërimin e jo Rrugën e Drejtë; prandaj e

8 Surja “Isra”, ajeti 44.

9 Surja “Ra’d”, ajeti 13.

10 Surja “Ra’d”, ajeti 13.

11 Surja “Fussilet”, ajeti 13.



goditi rrufeja e dënimit poshtërues për atë që kishte bërë.”¹²

“Ata u treguan mendjemëdhenj ndaj urdhrave të Allahut; pastaj i goditi rrufeja, ndërsa e shihnin, por nuk mundën as të ngriheshin, as të mbroheshin prej dënimit.”¹³

“Kujtoni, kur i thatë Musait: ‘O Musa! Ne nuk do të të besojmë ty, derisa ta shohim Allahun haptazi!’. Atëherë, një rrufe ju goditi, ndërsa ishit duke parë.”¹⁴

“Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje (o Muhamed) që t’u zbresësh një libër prej qiellit. Në fakt, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe (duke i thënë): ‘Na e trego Allahun haptazi!’ Atëherë, i shkatërroi rrufeja, për shkak të poshtërsisë që bënë.”¹⁵

“Prandaj fisi Themud u shkatërrua nga një ulërimë e tmerrshme.”¹⁶

Vetëtima dhe bubullima janë të frikshme, por të dobishme.

Për këto dobi flet Kur’ani, siç u pa, me shiun etj. Këto dobi janë zbuluar edhe nga shkenca bashkëkohore. Ja tri prej tyre:

1– Ujitja. Gjatë vetëtimës, siç u tha, shpërthen temperaturë e lartë, që ndonjëherë arrin deri në pesëmbëdhjetë mijë gradë celsius. Ajo është e mjaftueshme që të djegë ajrin e mjedisit që e rrethon atë. Si rezultat, bie trysnia e ajrit dhe shkaktohet rënia e pikave të shiut. Për këtë arsye, pas vetëtimës bie shi i rrëmbyeshëm e i furishëm.

Në të vërtetë, kjo (rënia e shiut) është një nga të mirat e

¹² Po aty, 17.

¹³ Surja “Dharijat”, ajetet 44,45.

¹⁴ Surja “Bekare”, ajeti 55.

¹⁵ Surja “Nisa”, ajeti 153.

¹⁶ Surja “Hakka”, ajeti 5.



vetëtimës.

2– Pastrimi nga mikrobet e helmet. Si rezultat i temperaturës së lartë që shkakton vetëtimë, në pikat e shiut shtohet përqindja e oksigjenit. Ky është ujë i rëndësës ose ujë i oksiduar (H_2O_2) dhe vret mikrobet e prandaj përdoret për të pastruar plagët. Kur nuk ka vetëtimë, shfaqen mikrobe, kandrra të dëmshme e edhe gjarpërinj nëpër toka bujqësore. Prandaj edhe thuhet se kur ka shumë gjarpërinj, është viti që ka shumë pak vetëtimë, bubullima e rrufe.

3– Ushqimi dhe plehërimi. Pikat e ujit bashkëveprojnë me temperaturat e larta që shkarkon vetëtimë si rezultat i acidit karbonik. Kur bien në tokë, bëjnë njëfarë plehërimi për bimësinë.

Shkencëtarët thonë se sasia e plehut që e prodhon vetëtimë në një vit arrin në dhjetëra milionë tonë.¹⁷

Në Kur'an ka një sure që quhet "Err-Rra'd" dhe që ka kuptimin "gjënim i qiellit dhe i reve (bubullimë)". Në ajetin e 13-të të kësaj sureje flitet për bubullimën, rrufetë dhe dukuritë e tjera natyrore dhe shkencore, si vërtetuese të fuqisë të Zotit.

Dobitë e bubullimës dhe të vetëtimës janë argumente të qarta për ta njohur Allahun e Lartësuar.



¹⁷ Naser Mekarim Shirazi, *El Emtel*, vëll.6, f.409.

PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ

Abstrakt

Xhabir ibn Abdullahu ka transmetuar se Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Për çdo sëmundje ka ilaç. Kur ilaçi e godet sëmundjen, shërohet me lejen e Allahut.” (Muslimi)

Në artikull jepen vetitë shëruese të: sanëzës, krisjes, dërnokut, llepatikës, urthit, hernies, hipofeas, ashjes, butinës, hisopit, shpatores, hithbutës, lirit, gojasllanit, kokërrujes, borgjergjit, manxuranës, sqerbullit shumëvjeçar, zorrëzës zvarranike, llopoit etj.

Sanëza (*Gentiana lutea* L. Gentianaceae)

Kjo bimë përmban sheqer, lëndë regjëse, alkaloid, gencioninë. Bima përdoret kundër anemisë, pasi ajo ka veti nxitëse në shtimin e rruazave të kuqe dhe të bardha të gjakut, duke ndihmuar kështu vetëmbrojtjen e organizmit. Kështu, bima rekomandohet në sëmundje të anemisë. Ajo është edhe një mjekim i mirë për uljen e temperaturës së lartë, kundër dobësisë së përgjithshme të trupit, kundër sëmundjes së



mëlçisë së zezë, kundër turbekulozit, kundër diarresë, kundër nevrastenisë etj.

Krisja (*Agropyron repens*. Familja Graminoceae)

Kjo bimë përmban proteinë, yndyrë, celulozë, glucide, esencë, poliecetilon, korvone, soponinë, vaniloside, acid silicik. Bima përdoret kundër sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes, në veprimtarinë e sëmundjeve të veshkave. Ajo përdoret për pastrimin e organizmit, për pastrimin e rrugëve urinare etj.

Dërnoku (*Gretiola officinalis*. L. Snophulare)

Kjo bimë përmban graciolinë, graciolininë dhe graciozolinë, vaj esencial, lëndë të hidhura e alkaloidë, vitamina, vaj volotil, acid tonik, saponinë. Bima përdoret për të shtuar oreksin, si dhe kundër parazitëve, për t'i dhënë fuqi organizmit. Ajo përdoret edhe kundër dhimbjeve të stomakut, si diuretik.

Llepatika (*Hepatico nobilis*. *Anemone nemuroso* L. Familja Ramunculoceae)

Kjo bimë përmban protoaneminë, saponinë, antocioninë, flavonide. Bima përdoret kundër tuberkulozit, në bronkitin kronik. Ajo përdoret për nxjerrjen e gjakut nga mushkëritë me anë të pështymës (haemoptizi) dhe për derdhjen e gjakut brenda një organi (apoplexia pulmonarum).

Urthi (*Hedera helix*. L. Familja Analioceae)

Kjo bimë përmban proteina, yndyrë, celulozë, lëndë ekstraktive joazotike. Frutat e saj përmbajnë kolesterolin, sheqer dhe pektinë, kurse farat përmbajnë hederinë dhe vaj



me ngjyrë të gjelbër. Bima përdoret si diuretik dhe për ndalimin e rrjedhjes së gjakut. Ajo shërben për të zgjeruar damarët e gjakut, kurse në sasi të mëdha, ajo i tkurr ato dhe shkakton ngadalësimin e rrahjeve të zemrës. Përvëlesa e gjetheve dhe e degëve shërben për pastrimin e gjakut, për forcimin e mishrave të dhëmbëve, për shërimin e plagëve të djegura, si dhe kundër verdhëzës, kundër rënies së flokëve. Gjethet e urthit përdoren gjithashtu, në spazmat bronkiale.

Hernia (Hernaria globo. Familja Cargophylloceae)

Kjo bimë ka veti dezinfektuese dhe këshillohet si spazmolitik dhe antiseptik në pezmatimet e fshikëzës së urinës, në rastet e gurëve dhe të rërës në rrugët urinare, në krizat e veshkave, në sëmundjet kronike të veshkave dhe në rastet e pakësimit dhe të nxjerrjes së ujit nga organizmi.

Hipofea (Hipophoe shonneides L. Eleagnaceae)

Kjo bimë përmban vitaminë C, B1, dhe E, acid malik, acid kerinik, flavavido, vaj fiksed, ksantofil, pigmente të karotenoidit. Bima përdoret në formë shurupi në gastritin dhe në ulçerën e stomakut.

Ashja (gjemb i ariut) (Llex acufolium. L. Familja aquifoliaceae)

Gjethet e bimës përmbajnë dekstrozë. Ato janë helmuese. Lëvorja përmban pektinë. E gjithë bima përmban toninë, acid kafeil-tonik, acid ursolik, acid ilicik, glukozë. Bima përdoret kundër bronkriteve, kundër gripit, kundër reumatizmit, kundër gurëve në veshka.



Butina (*Viburnum opulus* L. Familja Dorzonjore)

Frutat e kësaj bime përmbajnë lëndë të hidhura. Farat përmbajnë vaj, kurse gjethet përmbajnë virbuninë, lëndë regjëse, rrëshirë e fitosterol. Lëngu i përftuar nga zierja e rrënjëve përdoret kundër hemoragjive dhe kundër menstruacioneve të shumta, kurse lëngu i përftuar nga zierja e luleve përdoret kundër diarese dhe spazmave në zorrë. Lëngu i përftuar nga zierja e kërcellit përdoret kundër majasëllit dhe ai i gjetheve, kundër tenjës parazitare. Zierja e të gjithë bimës përdoret kundër tumoreve në gjinekologji.

Hisopi (*Hyssopus officinalis* L. Labietae)

Kjo bimë përmban vaj volatile X dhe B. Bima përdoret si lëndë kundër djersitjes. Ajo pakëson ngacmueshmërinë e sistemit nervor, ngushton arteriet dhe pakëson sekrecionet.

Shpatorja (*Iris germanica* L. familja Irdaceae)

Kjo bimë përmban vaj esencial, sheqer, amidon, lëndë mucilagjinore (zbutëse), rrëshirë, iridinë, acide organike, naftaline etj. Bima pakëson ngacmueshmërinë lokale të lëkurës, zbut gëlbasën, lehtëson kollitjen, shton rrjedhjen e tëmthit. Ajo përdoret edhe kundër heqjes së barkut (diarese). Në përdorim të jashtëm këshillohet në formë pluhuri të imët për pudrosje, si dhe në kozmetikë.

Hithbuta (*Lamium album* L. familja Labioteae)

Hithbuta përmban saponinë, vaj esencial, taninë, triterpenoid, flavonide e glukozite, kuercetinë, kamferol,



histaminë, metilaminë, toraminë, acid klorogonik dhe acid kafeik. Bima përdoret kundër hemorroideve dhe kundër diarresë.

Liri (*Linum usitatissimum*. L. familja Linaceae)

Frutat e lirit përmbajnë pektinë, vaj hektonezidin, limonarinë, enzima, acid manuranik, ksinozë, zhamnosi, arobinozë dhe goloktozë. Çaji i farave të lirit përdoret kundër acarimit të kanalit tretës dhe rrugëve urinare. Kurse farat, duke i bërë pluhur të imët, përdoren në rrugët e frymëmarrjes.

Gojasllani (*Linaria vulgaris* mill. Familja Scrophulariaceae)

Kjo bimë përmban alkaloidë, vitaminë C dhe karotinë. Bima përdoret në formë përvëlese për pastrimin e gjakut dhe kundër majasëllit.

Kokërruja (*Lithospermum afficinalis*. L. familja Boraginaceae)

Kjo bimë në rrënjë dhe në gjethe përmban alkaloidë, acid oleik dhe linoneik, vitaminë C, acid silicilik, acid litospermik dhe aminoacide. Farat e kësaj bime përmbajnë vaj të përshtatshëm për prodhimin e bojërave. Në mjekësi, farat përdoren kundër ftohjes, kundër gurëve në veshka, kundër urinimit të pavullnetshëm, kundër diarese e dizenterisë.

Borgjërgji (*Lysimachia mummuloria* L. Premuloceae)

Bima, në fazën e lulëzimit, përmban proteinë, yndyrë, celulozë, lëndë atraktive joazotike, saponinë, lëndë regjëse,



taninë, acid silicik, vitaminë C. Në mjekësinë popullore përdoret e zier ose e freskët për të pastruar plagët dhe për të ndaluar rrjedhjen e gjakut. Ajo përdoret edhe kundër diareisë, kundër mikroorganizmave, kundër salmonelës, stafilokokut, streptokokut dhe kundër reumatizms.

Manxurana (*Origanum majorana*. L. *Majorana hortensis*. Labiotel)

Kjo bimë përmban esencë, taninë, fenol, acid ursolik dhe acid oleonoik. Bima ka veti të ndihmojë në tretje dhe të nxisë formimin e lëngut të stomakut, për largimin e ngërçeve spazmatike, për largimin e gazrave nga zorrët, për shtimin e sekretimit të urinës etj. Ajo përdoret kundër fryrjeve të barkut, kundër diareisë, kundër pezmatimeve të zorrës së trashë (colika), kundër reumatizmit dhe kundër artritit.

Sqerbulli shumëvjeçar (*Merkurelis perennis*)

Bima përmban alkaloidin merkuralinë, saponinë, flavonide, glikozide, rutinë, vaj esencial, lëndë të hidhur, hermidinë, metilaminë, trimetilaminë. Në mjekësi përdoret kundër çrregullimit të menstruacioneve, kundër humbjes së oreksit, kundër bronkitit laksativ, kundër pakësimit të sekretimit të qumështit të gjirit.

Zorrëza zvarranike (*Patentilla reptans* L. Rosaceae)

Kjo bimë përdoret kundër etheve, kundër temperaturës së lartë, kundër diareisë, kundër rrjedhjes së gjakut nga hundët dhe kundër formimit të gurëve në rrugët urinare.



Llopoi (*Petosites hybridus*. L. Goert. Familja Compositae)

Kjo bimë përdoret kundër kollës së bardhë. Gjithashtu, ajo përdoret edhe kundër çrregullimeve menstruale, kundër ngërçeve të venave, kundër majasëllit dhe në plagë që shërohen me vështirësi.



Hans Henrich Reckweg

TË KËQIJAT E MISHIT TË DERRIT¹

Abstrakt

Mishi i derrit është i rrezikshëm. Popullsia që jeton sipas ligjeve të Islamit është e shëndoshë, kurse popullsia që jeton sipas stilit perëndimor, vuan nga sëmundjet që shkaktohen prej konsumimit të mishit të derrit. Që mishi i derrit është i dëmshëm dhe që në njëfarë mase, shkakton helmime, është e njohur që para Luftës së Dytë Botërore. Është vërtetuar se shumë sëmundje, si artriti dhe sëmundje të tjera te gratë, kanë lidhje me konsumin e mishit të derrit.

Prej shumë vitesh më janë lutur shokët e dashamirët e mi që të bëj një punim shkencor për dëmin e mishit të derrit, për sitoksinet, domethënë për helmimet dhe lëndët e dëmshme që përmban mishi i derrit. Disa herë jam përgatitur, por për shkak të kohës së pamjaftueshme, kam qenë i detyruar ta ndërpres punën, sepse lënda ishte e shumtë dhe kërkonte përkushtim. Më mungonte edhe guximi ta parashtroja këtë problem të panjohur në Evropë, sepse isha në kundërshtim me propagandën ekonomike. Kështu, nuk munda t'i përmend disa pikëpamje të mia. Megjithatë dëshiroj që t'u lë në dispozicion këtë punim të shkurtër që tregon mundësinë, që secili njeri të ruajë shëndetin e tij, duke iu përmbajtur rregullës që ndalon

¹ E përktheu Reshat Abazi.



përdorimin e mishit të derrit.

Me rëndësi është që të përmenden themeluesit e kulturave të mëdha. Profeti Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) dhe Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), prej të cilëve është frymëzuar edhe kultura evropiane. Ata i pranuan urdhëresat e Zotit dhe në bazë të tyre, themeluan ligjet e veta.

Rrezik të veçantë paraqet ngrënia e mishit të derrit në vendet tropikale, ku në kushte klimatike të njëjta jetojnë si myslimanët, ashtu edhe të krishterët. Popullsia që jeton sipas të ligjeve të Islamit është e shëndoshë, kurse popullsia që jeton sipas stilit perëndimor vuan nga sëmundjet që shkaktohen prej konsumimit të mishit të derrit.

Kjo vlen edhe për disa fise të ndryshme në viset e Himalajeve. Hunda-fiset islame që nuk e përdornin mishin e derrit, janë të shëndoshë deri në pleqërinë e thellë dhe punojnë si hamallë në disa ekspedita, që ngjiten në majat më të larta të Himalajeve. Hundat që jetojnë në anën tjetër të luginës dhe që nuk zbatojnë rregullat e ushqimit, vuajnë prej sëmundjeve të shumta.

Është e pamundur që punimin tim ta paraqes në Arabinë Saudite, Pakistan, Algjeri, Tunizi, Egjipt, Libi ose në ndonjë shtet ku Islami është fe zotëruese. Atë që do t'ua thosha e dinë dhe e praktikojnë para shumë mijëra vjetësh.

Veprimi i mishit të derrit

Ky tregim është rezultat i një eksperimenti të padëshiruar. Për këtë më kanë informuar kolegët e mi, që kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë. Gjatë Luftës së II Botërore, në frontin veri-afrikan që e drejtonte gjeneral marshall Romel, u sëmurën shumë ushtarë gjermanë nga e ashtuquajtura “ulçera tropikale”, domethënë prej të thatit në kofshën e poshtme të



këmbës, si pasojë e të cilës bëheshin të paaftë për luftë. Ata shtroheshin disa javë nëpër spitale dhe së fundi i largonin edhe prej frontit.

Mjekët i provuan të gjitha metodat e shërimit, si hemoterapinë etj, por të gjitha qenë të pasuksesshme. Më pas mjekëve u lindi ideja se i thati në këmbë kishte lidhje me ushqimin, sepse popullata vendase nuk kishte qenë prekur nga sëmundje më parë. Menjëherë u mor vendimi që ushtarët të ushqeheshin pa mish derri. Nuk kaloi shumë kohë dhe kjo sëmundje u zhduk. Që mishi i derrit ishte i dëmshëm dhe në njëfarë mase shkakton helmime, më ishte e njohur që para Luftës. Atëherë, pranoja se mishi i freskët i derrit është i dëmshëm, por jo edhe mishi i thatë, suxhuku dhe prodhimet e tymosura të mishit të derrit. Kjo lajthitje më ndodhi sepse mishi i freskët i tij shkaktonte sëmundje akute; ndezjen e zorrës së verbër, ndezjen e fshikzës së urinës, ulçerën si dhe shumë sëmundje të tjera në organet gjinore.

Disa vjet më vonë m'u dha rasti të mësoj nga eksperimenti i ndërrimit të ushqimit së popullësisë së përgjithshme gjermane. Ky eksperiment i padëshiruar u bë në vitet e para gjatë dhe pas Luftës së II Botërore.

Gjatë viteve të varfërisë, gjatë Luftës dhe veçanërisht pas saj, populli gjerman ishte i shëndetshëm. Të paktë ishin ata që kishin mundësi të hanin derisa të ngopeshin. Kur nuk kishte mish derri, nuk kishte asnjë rast të ndezjes së zorrës së verbër, asnjë rast të fshikzës së urinës. Po ashtu, u zhdukën sëmundje si infarkti, tensioni i lartë i gjakut, sëmundjet ngjitëse etj. Menjëherë pas reformës monetare, kur mishi dhe dhjami i derrit u gjendën në treg në sasi të konsiderueshme, ndërroi tërësisht pasqyra shëndetësore e mbarë popullësisë gjermane. Të gjitha llojet e sëmundjeve të lartpërmendura, filluan të bëjnë kërdrinë në popull. Veçanërisht, tmerruese qe shtimi i madh i të sëmurëve nga kanceri. Shumë të sëmurë të moshës 60-70



vjeçare, të cilët deri atëherë kishin jetuar pa problem. U sëmuren papritmas në organet e tretjes, më vonë u shfaq edhe kanceri. Zhvillimi i këtyre ngjarjeve ishte aq biologjikisht i kuptueshëm, se prejardhja e këtyre sëmundjeve kishte lidhje me helmimin. Për këtë ishte raportuar edhe në revistën mjekësore të Mynihut nr.12, në 1952, punimi im i parë për homotoksinet. Pas shumë vjetësh u vërtetua se shumë sëmundje si artriti, artroza dhe sëmundje të tjera tek gratë, kanë lidhje me konsumin e mishit të derrit.

Eksperimentimi me ushqimin

Vendosa të bëj eksperimente më bindëse me kafshë eksperimentale. Për këtë bleva një fis minjsh të bardhë dhe i futa në tridhjetë enë prej qelqi dhe bëra eksperimente të ndryshme ushqyerjeje në grupe të ndryshme. Rezultatet i përshkrova në librin tim “Homotoksinet dhe homotoksitet- themel i një sinteze të medicinës”, 1995.

Minjtë e ushqyer me mish derri kishin prirje për kanibalizëm. Gjatë rritjes, u paraqit kanceri në pjesë të ndryshme të trupit të tyre. Kurse minjtë e ushqyer me ushqim të rëndomtë, kishin shenja sëmundje, por jo me kancer e me kanibalizëm. Kisha përfutur kështu, njohuri të shumta për veprimin helmues të mishit të derrit. Me thanë se qentë e racës “bokser” nuk guxojnë në asnjë mënyrë t’i ushqejnë me mish derri, sepse sëmuren shpejt me sëmundje të lëkurës dhe të organeve të brendshme. Eksperiment i ngjashëm ushqyerjeje është bërë edhe me kafshët e cirkut, sidomos me luanin dhe me tigrin. Kur këta kafshë ushqeheshin me mish derri bëheshin pertacë e të majmë, vuanin nga tensioni i lartë i gjakut. Kishin gjakderdhje nga hundët, derisa më pas bëhej shkak i ngordhjes së tyre.



TA RUAJMË GJUHËN TONË

Abstrakt

*S'ka dyshim se gjuha, që është një copë e vogël mishi, është shkaku i hyrjes së njerëzve në Zjarr (Xhehenem) ose në Xhenet. Edhe pse e vogël si organ, gjuha mund të kryejë të keqen më të madhe. Në Kur'anin e shenjtë thuhet: **“A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë.”** (Sure “Beled”, ajetet 8-9). Në këtë jetë, shumë herë njeriu është i pavëmendshëm dhe i nxituar me fjalët që thotë dhe veprat që bën. Ai fsheh shumë veprime e thënie në këtë jetë. Shan e fyen vend e pa vend. Por Allahu është i Gjithëditur dhe i Mirinformuar për gjithçka. Ai është i Drejtë. Ai nuk i bën padrejtësi askujt. Në Kur'an lexojmë: **“Ju nuk u fshehët, që kundër jush të mos dëshmonin veshët, sytë e lëkura juaj, por ngaqë besonit se Allahu nuk i dinte shumë nga ato që bënit.”** (Sure “Fusilet”, ajeti 22). Dhe: **“Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Sure “Kaf”, ajeti 18).*

“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.” (Sure “Nur”, ajeti 24).

Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”** (Sure “Nahl”, ajeti 78). Ky ajet përmend një prej mirësive të mëdha të Allahut për njeriun: Ai i ka dhënë njeriut organe, fuqi e gjymtyrë, për ta vazhduar jetën e tij - materiale dhe shpirtërore.



Në fund, ajeti thotë që njeriu duhet të jetë falënderues për këto mirësi të Krijuesit Fuqiplotë. Falënderimi më i mirë është që njeriu t'i shfrytëzojë këto mirësi aty ku urdhëron Krijuesi dhe të bëjë me to vepra që e kënaqin Allahun e të mos i shfrytëzojë ato për vepra që e zemërojnë Krijuesin, t'i shfrytëzojë ato duke u bërë mirë krijesave të tjera dhe jo t'u bëjë keq atyre.

Në librin e tij “Mesazhi i të drejtave”, imam Ali ibn Husejn, Zejnul Abidin (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “*E drejta e vetes sate ndaj teje është që ta bindësh atë t'i bindet dhe t'i përulet Allahut. Zbato të drejtën ndaj gjuhës sate, veshit tënd, syrit tënd, dorës sate, barkut tënd, organeve gjinore, duke i kërkuar mbështetje Allahut për këtë zbatim.*” Pra, organet kanë të drejta: Ato duhet të adhurojnë Allahun dhe të shfrytëzohen aty ku urdhëron Allahu.

Sigurisht, njeriu mund t'i përdorë gjuhën, syrin, veshin, dorën, këmbën, barkun dhe organet e tjera, për ta kënaqur Allahun dhe (Larg qoftë!) për ta zemëruar Allahun: për të mirë dhe për gjynahe. Këto organe e këto gjymtyrë janë portat e Xhenetit dhe të Xhehenemit. Është në dorën e njeriut që t'i bëjë ato adhuresë ose t'i bëjë mëkatore. Në organet dhe në gjymtyrët tona duket besimi ynë. Nëpërmjet veprave të tyre zbulohet se sa i fortë apo sa i dobët është besimi ynë.

S'ka dyshim se gjuha, që është një copë e vogël mishi, është shkaku i hyrjes së njerëzve në Zjarr (Xhehenem) ose në Xhenet. Edhe pse e vogël si organ, gjuha mund të kryejë të keqen më të madhe. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **“A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë.”** (Sure “Beled”, ajetet 8-9). Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Vërtet, gjuha është çelësi i të gjitha të mirave dhe i të gjitha të këqijave. Besimtari duhet ta ruajë gjuhën e tij, ashtu siç ruan floririn dhe argjendin e tij.*” (*Mijzanul Hikmeh, vëll. 4 f. 2777.*)

E kanë pyetur imam Zejnul Abidin, birin e imam



Hyseinit se kush është më e mirë - të folurit apo heshtja dhe ai ka thënë: “*Secila prej tyre ka të këqijat e veta. Nëse janë të ruajtura nga të këqijat, atëherë të folurit është më i mirë se heshtja.*” I thanë: “*Na e sqaro o nipi i Profetit!*” Ai u tha: “*Të folurit është më i mirë se heshtja, sepse: Allahu i ka dërguar profetët që të flasin dhe jo të heshtin; Xheneti nuk fitohet me heshtje; as dashuria e Allahut nuk arrihet me heshtje; as mbrojtja nga Zjarri nuk fitohet me heshtje; as zemërimi i Allahut nuk largohet me heshtje; të gjitha ato arrihen me fjalë. Kurrë nuk do ta ndërroja bënën me diellin...*” (El Ibtixhaxh, vëll.2, f. 350)

Në një porosi të prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) për Muhamed ibn Hanefije thuhet: “*Allahu nuk ka krijuar gjë më të mirë e më të shëmtuar sesa fjala. Me fjalën zbardhen fytyrat dhe me fjalë nxihen fytyrat. Dije se fjala është e prangosur tek ti, nëse nuk e nxjerr atë. Po e nxore, je ti i prangosur te fjala. Prandaj, ruaje gjuhën tënde, ashtu siç ruan florin tënd dhe paranë tënde, sepse fjala është si qeni, të cilin po e lëshore, të shqyen. Sa e sa fjalë e zhdëkin mirësinë.*” (Men la jehdheruhul fakijh, vëll. 4, f. 387.)

Të shumta janë hadithet që paralajmërojnë për rreziqet që gjuha i sjell njeriut, nëse nuk e ka atë nën sundimin e logjikës së tij. Në një hadith tjetër nga Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet: “*Mëkatet më të shumta të birit të Ademit janë në gjuhën e tij.*” (Mijzanul Hikmeh, vëll.8.) Dhe: “*Mbaje gjuhën tënde, sepse është një sadeka që e jep për veten tënde.*” (El Kafij, lënda sadeka) Dhe: “*Robi nuk e njeh të vërtetën e besimit derisa të ruajë gjuhën e tij.*” (El Kafij, vëll. 2, f. 114) Kurse imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “*Shkarjet e gjuhës janë shkatërrimi më i madh.*” (Mijzanul Hikmeh, vëll. 4 f. 2779.) Dhe: “*Burgosë gjuhën tënde para se të të burgosë ajo ty për një kohë të gjatë dhe të të shkatërrojë. S’ka dyshim se më i pari për burgosje është ai që nuk flet mirë dhe që nxitohet në përgjigje.*” (Mijzanul Hikmeh, vëll. 4 f. 2780.)

Sigurisht, të gjitha gjymtyrët e organet e njeriut janë përgjegjëse në këtë jetë. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë:



“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni! Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha do të merren në përgjegjësi.” (Sure “Isra”, ajeti 36). Ditën e Gjykimit të gjitha gjymtyrët dhe organet tona do të dëshmojnë për gjithçka që kemi bërë në këtë jetë. Këtë e thotë Allahu i Madhëruar në Kur’anin e Shenjtë: **“Kur të vijnë afër Zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.”** (Sure “Fusilet”, ajeti 20). Dhe: **“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.”** (Sure “Nur”, ajeti 24). Dhe: **“Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.”** (Sure “Ja Sin”, ajeti 65).

Në këtë jetë, shumë herë njeriu është i pavëmendshëm dhe i nxituar me fjalët që thotë dhe veprat që bën. Ai fsheh shumë veprime e thënie në këtë jetë. Shan e fyen vend e pa vend. Por Allahu është i Gjithëditur dhe i Mirinformuar për gjithçka. Ai është i Drejtë. Ai nuk i bën padrejtësi askujt. Në Kur’an lexojmë: **“Ju nuk u fshehët, që kundër jush të mos dëshmonin veshët, sytë e lëkura juaj, por ngaqë besonit se Allahu nuk i dinte shumë nga ato që bënit.”** (Sure “Fusilet”, ajeti 22). Dhe: **“Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Sure “Kaf”, ajeti 8). Dhe: **“Ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.”** (Sure “Infitar”, ajetet 10-12). Pra, ne jemi të mbikëqyrur plotësisht. Gjithçka shënohet dhe regjistrohet në çdo kohë dhe në çdo vend. Atëherë, flit çfarë të duash, por dije se ka regjistruer për ty! A mendohemi kur i lexojmë këto ajete? Ato janë një paralajmërim i frikshëm. Ato janë më së pari, këshillë e përkryer për të gjithë. **“Vërtet, këtu ka këshillë, - thuhet në Kur’an, - për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon.”** (Sure “Kaf”, ajeti 37).



Ditën e Gjykimit, çdo gjë do të shihet, kur të na jepet libri i veprave tona. Në Kur'an lexojmë: **“Dhe Libri (i veprave të tyre) do t’u vihet përpara e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: ‘Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë!’.** Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë bërë. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.” (Sure “Kehf”, ajeti 49). Ajeti dëshmon qartë se gjithçka regjistrohet dhe njeriu do ta shohë Ditën e Llogaridhënies. Sikur të rrënjosej thellë në mendjet e myslimanëve ky ajet, besojmë se nuk do të dëgjonim sharje, fyerje e mallkime nga gjuhët tona.

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”** (Sure “Ahzab”, ajeti 58). Dhe: **“Vërtet, ata që përgojnë gratë e ndershme, zemërdëlira e besimtare, janë të mallkuar si në këtë botë, ashtu dhe në Botën Tjetër. Për ata ka dënim të madh.”** (Sure “Nur”, ajeti 23).

Këto dy ajete janë paralajmërim dhe këshillë për të gjithë ata që shajnë dhe fyejnë, përgojnë e akuzojnë pa të drejtë. Të mendohemi mirë para se të flasim, sepse pasojat janë të rënda si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Atëherë? Atëherë, Ditën e Gjykimit, njeriu do të habitet kur të shohë memecin të flasë dhe të verbrin të dëshmojë. Këtë na e sqaron Kur'ani i Shenjtë kur thotë: **“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: ‘Pse dëshmuat kundër nesh?’ E ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.’”** (Sure “Fusilet”, ajeti 22). Dhe Allahu është Mbikëqyrësi i njeriut dhe Allahut nuk i shpëton asgjë. Ja se ç’thuhet në Kur'an: **“Mos mendo**



kurrresi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdulohen (nga tmerret që do të shohin) dhe duke vrapuar me kokë lart, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri)." (Sure "Ibrahim", ajetet 42-43).

Cilido që bën një të keqe, me fjalë a me vepra, e bën për veten e vet. Në Kur'anin e Shenjtë, për këtë thuhet: **"Kush bën gjynah, ia ka bërë shpirtit të vet. Allahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."** (Sure "Nisa", ajeti 111). Atëherë? Atëherë, të kthehemi tek Allahu i Gjithmëshirshëm! Të kthehemi te Fjala e Tij, te Kur'ani i Shenjtë! Ta lexojmë, ta studiojmë dhe ta zbatojmë atë në jetën tonë! Sepse kur zbatojmë urdhrat e porositë e Allahut, arrijmë kënaqësinë e Tij. Sepse është Allahu, Ai që fal gjynahe: **"Kush bën vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë."** (Sure "Nisa", ajeti 110). Kjo do të thotë që asnjëherë të mos e humbasim shpresën për Mëshirën e Allahut! Kur'ani i Shenjtë na këshillon për këtë: **"Thuaj: 'O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe! Mos e humbni shpresën në Mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i Madh dhe Mëshirëploti.' Kthehuni te Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju ndihmojë askush!"** (Sure "Zumer", ajetet 53-54).

Kurrë të mos e lejojmë veten tonë që të na mashtrojë djalli i mallkuar! Misioni i tij është nxitja për urrejtje, për armiqësi dhe për largimin e njeriut nga rruga e Allahut. Allahu thotë: **"Vërtet, me pije alkoolike dhe me bixhoz, djalli kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?"** (Sure "Maide", ajeti 91).



Allahu na mundësoftë që të jemi në rrugën e Tij me gjithë qenien tonë! Allahu na bëftë prej atyre që i shfrytëzojnë mirësitë e Tij aty ku fitohet kënaqësia e Tij si në këtë jetë ashtu edhe në Jetën Tjetër! Të përpiqemi që të jemi prej atyre, për të cilët Allahu na thotë në Kur'an: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota.”** (Sure “Mu'minun”, ajetet 1-3). Dhe: **“Robtë e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’”** (Sure “Furkan”, ajeti 63). T'i përmbahemi këshillës së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*): *“Tu frikëso Allahut kudo që të jesh! Pasoje të keqen me të mirë, sepse (e mira) largon të keqen dhe sillu me njerëzit me moral të mirë!”* (Termidhij)



HISTORI E PROFETËVE

Historia e profetit Musa dhe Harun (Paqja qoftë mbi ta!)¹

Abstrakt

Një ndër historitë më të shquara dhe madhbështore që tregon Kur'anit, është ajo e profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!). Historia e këtij Profeti tregohet në shtatëdhjetë e tri vende në Kur'an. Profeti Musa është nderuar nga Zoti, pasi i ka folur drejtpërdrejt, pa ndërmjetës. Zoti i Madhbëruar thotë: **“Trego në Libër edhe për Musanë! Njëmend, Ai ishte i përzgjedhur, ishte i dërguar dhe profet.”** (“Merjem”, 51) Musai (Paqja qoftë mbi të!) ishte i përzgjedhur prej Zotit dhe në shërbim të Tij, larg cytjeve dhe tundimeve të shejtanit. Lidhur me fuqinë dhe forcën e tij fizike, thuhet se ishte e barabartë me atë të dhjetë burrave. Musai (Paqja qoftë mbi të!) kishte vështirësi në të folur. Këtë fakt e përmend dhe Faraoni, i cili u drejtohet këshilltarëve duke e tallur Musanë: **“Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?”** (“Zuhruf”, 52). Por kjo e metë nuk e pengoi të zgjidhej i dërguar i Zotit dhe profet. Edhe vetë Musai e pranon këtë të metë në të folur në një ajet: **“Vëllai im, Haruni, është**

1 Pjesa e dytë e historisë. Vijnë nga numri i kaluar. Marrë nga www.islami.al. Ju bëjmë me dije se edhe pjesa e parë është marrë nga e njëjta adresë, dhe jo nga autori i cilësuar te koka e artikullit.



më gojëtar se unë në të folur.” (*“Kasas”, 34*) Profeti Musa dhe vëllai i tij, profeti Harun kishin si synim udhëzimin e beni israilëve.

Gjithë Egjipti fliste për Musanë dhe të vëllanë, Harunin. Faraoni ishte shqetësuar, reputacioni po i cënohej.

“Musai është magjistar! Thërrasim magjistarët më të aftë dhe u tregojmë të gjithëve se Musai nuk është veçse një magjistar mashtrues. Kështu populli do e njohë Musanë dhe ai nuk do jetë më një shqetësim për ne.” - thanë këshilltarët.

Faraoni thirri sërish Musain dhe i tha se do ta sfidonte magjinë e tij. Musai pranoi, dhe i kërkoi që sfida të bëhej në një ditë të shënuar, pas mëngjesit dhe në praninë e të gjithëve. Edhe Faraoni, këtë donte, që ta turpëronte Musanë.

Faraoni urdhëroi t’i mblidhnin të gjithë magjistarët dhe pasi u tregoi se Musai hidhte shkopin përtokë e ai sakaq shndërrohej në gjarpër, u kërkoi që ta sfidonin e ta mundnin.

Magjistarët qeshën me ironi. I thanë se ishte numër i lashtë magjie. Faraoni u lehtësua kur pa se magjistarët e morën me të lehtë dhe se kishin shumë besim në vete.

Erdhi dhe dita e shënuar. Njerëzit ishin mbledhur dhe prisnin me padurim. Erdhën magjistarët nën duartrokitjet e turmës. Kur erdhi Faraoni, brohoritjet mbuluan sheshin. Ndërsa kur erdhi Musai me të vëllain, Harunin, ra një heshtje e thellë. Musai ndenji në cep të sheshit dhe lutej në heshtje.

Ra heshtja. Magjistarët iu afruan Musait dhe e pyetën:

-“Kush do nisë i pari, ne apo ti?”

-“Ju!” - u tha ai.

Magjistarët lëshuan të gjithë së bashku shkopinjtë e



litarët që mbanin në dorë dhe sheshi u mbush me gjarpërinj, të mëdhenj e të vegjël. Që të gjithë lëviznin, të gjithë përdridheshin... Në fakt, ishte veç një iluzion, asnjëri nuk ishte i vërtetë. Ishte veç një numër i bukur. Fillimisht njerëzit i zuri frika, por pastaj shpërthyen duartrokitjet. Faraoni i kënaqur, qeshte me vete. Kur pa sheshin e mbushur me gjarpërinj, Musai u trondit disi. Ai nuk ishte një magjistar, nuk ishte kjo puna e tij, por sot i duhej të matej me ta. Ai kishte forcën dhe mrekullinë e besimit. “Mos u tremb! Ti je më lart nga ata! Sapo ta hedhësh në tokë shkopin tënd, do e shohësh si do i gëlltisë gjarpërinjtë e tyre! Puna e tyre është magji, nuk është reale. E vërteta je ti. Asnjëherë magjia nuk mund të triumfojë mbi të vërtetën.” - dëgjoi një zë.

Musai tashmë ishte i qetë. Lëshoi shkopin që mbante në dorë mu në mes të sheshit. Me të cekur në tokë, shkopin u shndërrua në një gjarpër të tmerrshëm, të vërtetë. Magjistarët shtangën, Faraoni u tremb. Gjarpri iu drejtua shkopinjve e litarëve që kishin hedhur magjistarët e që dukeshin si gjarpërinj dhe i gëlltiti një nga një. Pastaj iu afrua Musasë, i cili e preku me dorë dhe gjarpri u kthye menjëherë në shkopin e mëparshëm.

Magjistarët e kuptuan menjëherë se ai burrë nuk bënte magji sikur ata. Ata ishin më të zotët e magjisë dhe e dinin më së miri se çfarë mund të bëhej me magji e çfarë jo. Ishte thjesht mrekulli e Zotit. Menjëherë u përkulën dhe thirrën: “Ne e besojmë me gjithë shpirt Zotin e Musait e të Harunit, Zotin e vërtetë të gjithësisë!”

Faraoni po tërbohej. Menjëherë urdhëroi të vareshin magjistarët. Musai dhe Haruni u kthyen mes besimtarëve, Faraoni iku në pallatin e vet.

Musai i kërkoi Faraonit t’i lejonte bashkë me Izraelët



të largoheshin nga Egjipti, por Faraoni refuzoi. Allahu e sprovtoi pastaj Faraonin dhe koptët me përmbetje, pastaj me pushtim nga karkalecët të gjitha hapësirave, më tej insekte të shumëllojshme, me bretkosa, e së fundi me gjak; i gjithë uji që përdornin koptët kthehej menjëherë në gjak.

Gjatë çdo mrekullie, koptët i kërkonin Musait t'i lutej Zotit të tij t'i shpëtonte. I lodhur dhe i pashpresë përballë mrekullive që tregoi Musai, Faraoni i lejoi të largoheshin nga Egjipti. Por kur pa se Muasi dhe Haruni (*Paqja qoftë mbi ta!*) kishin mbledhur izraelitët dhe po largoheshin, iu vu nga pas që t'i vriste.

Ndërkohë Musai kishte arritur në breg të Detit të Kuq. Nga larg, dukeshin flamurët e ushtrisë së Faraonit. Izraelitët që ishin me Musanë, i pushtoi frika. “Mos u trembni, Zoti i botëve është me ne, Ai do të ma tregojë rrugën.” - i qetësoi Musai.

Ishin momente shumë të rënda. Para kishin detin. Prapa ushtria armike. Nuk kishin as forca, as armë për të luftuar. Pikërisht, atë çast, Zoti e urdhëroi Musain: “Preke detin me shkop!”.

Sapo shkopi i Musait preku detin, ujërat e tij u ndanë më dysh dhe u hap një rrugë mu në mes të detit. Një rrugë që rrethohej majtas e djathtas me dallgë vigane. Musai nga para dhe Izraelët nga pas, nisën të ecnin nëpër rrugën e hapur në det. Ishte një mrekulli e jashtëzakonshme. Dallgët shkrumbnin e hidheshin, por vetëm anë rrugës. Përgjatë kalimit, sikur i mbante një dorë e padukshme dhe ata as që i lagnin udhëtarët. Më në fund, Musai bashkë me njerëzit e vet kishin arritur në bregun tjetër të Detit të Kuq.

Faraoni u ngri nga habia kur arriti në breg të detit. I



urdhëroi të ndiqnin rrugën. Faraoni para dhe ushtria me kuaj nga pas, nisën të ecnin nëpër rrugën ku pak më parë kishte kaluar Musai me njerëzit e vet. Ushtria e Faraonit kishte arritur mu në mes të detit, kur Zoti urdhëroi detin të kthehej në gjendjen e mëparshme. Faraoni dhe ushtria e tij gjigante, gjendeshin në fund të detit. Deti i kishte përpirë. As edhe një gjurmë, as nga Faraoni, as nga ushtria e tij. E liga nuk kishte arritur të triumfonte më tepër. Mizoria e Faraonit kishte marrë fund.

Musai vazhdoi rrugën nëpër shkretëtirën Sina bashkë me njerëzit e tij. Atje iu zbrit nga Zoti, Teurati. Përveç kësaj, Zoti i shpalli Musait “*Dhjetë urdhra*” që janë dispozita që komandojnë njerëzit për besimin, nderin dhe drejtësinë. Por, në fakt, Izraelët nuk ishin më ata të parët. Megjithë premtimin që i kishin bërë Musait, me gjithë mrekullitë që i kishin parë me sytë e tyre, me t’u larguar Musai për pak kohë, në periudhën që iu shpall Teurati, ata iu kthyen besimit të vjetër dhe nisën të adhuronin një viç prej floriri. Vërtet që profeti Musa vuajti shumë nga populli i vet.

Megjithatë Musai qëndroi me ta gjer në frymën e fundit, duke i këshilluar të besonin vetëm Zotin dhe të mos i ndaheshin rrugës së Tij.

Vitet e errëta të Egjiptit kishin mbetur në anën tjetër të Detit të Kuq. Në jetën e profetit Musa, vëllait të tij Harun dhe të gjithë bijve të Izraelit, po niste një periudhë e re. Mijëra bij të Izraelit, me në krye profetin Musa dhe vëllanë e tij, Harunin, udhëtonin në shkretëtirën Sina. Synimi i tyre ishte Toka e Shenjtë. Pra, Palestina, Siria dhe Jordania e sotme. Kjo tokë ishte e shenjtë sepse ishin vendet ku kishin lindur e ishin rritur profetë dhe ku ata u kishin përcjellë njerëzve mesazhin e Zotit. Profeti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) po i udhëhiqte ata drejt Tokës së Shenjtë.



Rëra që u ishte ngjitur në këmbë ndërsa kalonin Detin e Kuq, ishte ende e lagët. Duke udhëtuar takuan një fis që adhuronin idhujt. Menjëherë vrapuan te Musai dhe i thanë:

– “O Musa, na bëj edhe ne një idhull siç e kanë këta!”

Musai u zemërua. Jo më larg se dje, ai kishte ndarë detin më dysh para syve të tyre.”

Profeti i lartë iu përgjigj: “Vërtet që ju nuk hiqni dorë nga injoranca. Po si arrini të kërkonin një perëndi tjetër veç Zotit? Sa shpejt harruat që Ai ju bëri më të nderuarit e njerëzve?”

Fjalët e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) i kishin goditur rëndë. Egjiptianët ishin idhujtarë dhe bijtë e Izraelit ishin ndikuar shumë prej tyre dhe ende nuk e kishin formuar besimin e tyre në Zot. Shkretëtirës Sina nuk po i vinte fundi. Asnjë shenjë jete nuk dallohej atje. As ujë, as bimë, as gjallëri... Izraelitët e etur vrapuan sërish te shpëtimtari i tyre. Atëherë Zoti e mësoi Musanë që të shkonte pranë një shkëmbi e ta godiste atë me shkopin e tij.

Profeti Musa në krye dhe mijëra vetë nga pas. Ata po shkonin të dëshmonin edhe një mrekulli tjetër. Shkopi ishte aty, para syve të të gjithëve. Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) e ngriti atë dhe i ra shkëmbit. Menjëherë nga shkëmbi shpërthyen dymbëdhjetë burime uji ngjyrë argjendi që rridhnin e gurgullonin gjithë freski. Izraelitët ishin dymbëdhjetë familje të mëdha, ku secilës iu dha nga një burim.

Pas pak kohe mbi shkretëtirë nisën të dukeshin tufa me thëllëza. Izraelitët i gjuanin ato dhe i përdornin për ushqim. Këto ushqime të mrekullueshme, që u dërgoheshin atyre nga bota e mistershme, ishin vërtet të bollshme dhe të shijshme.

Kaluan muaj të tërë. Më në fund, i ishin afruar Tokës së Shenjtë.



Që larg, dukej qyteti i Jeruzalemit, që asokohe sundohej nga amelikët. Ata ishin një popull idhujtar, që nuk do ta dorëzonin qytetin pa luftë. Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) doli para popullit të vet dhe u mbajti një fjalim: “O populli im! Kujtojeni mirësitë e pafund që ju ka dhënë Zoti. Ishit skllëvër të robëruar dhe Ai ju shpëtoi nga mizoria. Ju bëri më të lartët e njerëzve. Zgjodhi profetë prej jush e iu tregoi rrugën e drejtë. Ju dha pasuri që nuk ia ka dhënë askujt para jush. Ja, tani, ku e keni dhe qytetin e shenjtë, hyni...”

Asnjë zë nuk doli prej gjithë atij populli. Nuk donin të luftonin. Kishin frikë të vdisnin. Pak rëndësi kishte për ta si jetonin, si skllëvër apo si zotërinj, e rëndësishme ishte të jetonin. Edhe pse ishin të shumtë në numër, nuk e kishin kundërshtuar aspak faraonin. Më mirë pranonin të jetonin në mjerim e robëri sesa të luftonin.

-“O Musa! Në atë qytet ka njerëz të fortë e të bëshëm. Pa dalë ata vetë nga qyteti, ne nuk hymë atje. Ne nuk do luftojmë.”

Haruni dhe disa besimtarë të tjerë dolën para me guxim: “Jemi më të shumtë në numër. Mjafton të hyjmë nga dera e qytetit dhe fitorja është e jona. Mjafton që të keni besim!”

-“Ne nuk do shkojmë asgjëkund, Musa.” - u përgjigjën me inat.

Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*) e pushtoi një mërzi e thellë. Ndihej i turpëruar para Zotit. Ishte i zemëruar keq me popullin e vet.

“O Zoti im,- nisi të lutej, -jam i vetëm me vëllanë tim, Harunin. O Zot im! Më shpëto prej popullit keqbërës.

Pas kësaj, Zoti, për dyzet vjet ia ndaloi Izraelitëve të



hynin në Jeruzalem. Për dyzet vjet do bënin një jetë nëpër shkretëtirë. Ky ishte ndëshkimi i Zotit për ta.

Rruga i kishte sjellë pranë malit Tur. Zoti e urdhëroi Musanë të ngjitej në mal. Atij do t'i shpallte Teuratin. Thirri të vëllanë, Harunin dhe i tha: “Ti do marrësh vendin tim. Duhet të jesh i durueshëm dhe paqësor me ta, por në asnjë mënyrë mos iu bind të pabesëve!”

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u nis për në mal. Iu kujtua nata që kishte marrë shpalljen e parë. Ishte pikërisht i njëjti vend. Musai ndenji në mal për dyzet ditë. Aty iu zbrit Teurati me dhjetë urdhrat e tij. Në këto urdhra Zoti u thoshte që të adhuronin vetëm Atë, të mos betoheshin mbi gënjeshtër, të respektonin prindërit, të mos vritnin njerëzit e pafajshëm, të mos bënin imoralitete, të mos vidhnin, të mos bënin dëshmi të rreme dhe të mos u vinin syrin grave e mallrave të tjetrit.

Musai kishte agjëruar për dyzet ditë me radhë, ishte falur e kishte folur me Zotin. Gjithçka kishte qenë e mrekullueshme. Por kur u kthye, ajo që dëgjoi, ia prishi qejfin. Zoti e kishte lajmëruar se populli i tij kishte nisur të adhuronte një idhull që e kishin bërë vetë.

Izraelitët ishin shumë të dhënë pas arit. Kur kishin ikur nga Egjipti, të pasurit e tyre nuk kishin lënë pa marrë edhe arin me vete. Haruni ua kishte ndaluar ta preknin, duke u thënë se nuk ishte i tyre dhe e kishte propozuar atë në një vend të fshehtë. Mes Izraelitëve ndodhej edhe një burrë hipokrit, që hiqej si besimtar, me emrin Samir. Njëkohësisht ky ishte një arpunues shumë i zoti, që mund t'i jepte arit formën që donte. Këtë art e kishte mësuar që në Egjipt. Samiri krijoi një idhull floriri në formë viçi mbi një majë të lartë dhe thirri gjithë izraelitët për ta parë.



Haruni ndodhej aty. Kur pa se populli i tij nisi të adhuronte statujën e vëçit, u hodh menjëherë: “Prisni! Kjo është një hile. Samiri po ju mashtron. Zoti juaj është Allahu, më besoni. Nuk është kjo statujë.”

Po as që e dëgjuan. Shumë prej tyre nisën të adhuronin statujën, ta nderonin e ta respektonin me përulje. Madje disa prej tyre e sulmuan Harunin dhe deshën ta vrisnin. Për të mos i ndezur gjakrat më keq, Haruni vendosi të priste kthimin e Musait.

Dyzet ditët kaluan. Kur doli Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) para njerëzve me tabelat e Teuratit në dorë, asnjëri nuk mori guximin të fliste. Profeti i madh ishte nxehur. Kurse ata rrinin të gjithë kokulur. Fjalët e Musait prishën heshtjen: “Kjo që keni bërë pas largimit tim është diçka shumë e shëmtuar.”

Asnjë nuk foli. Të gjithë dridheshin para zemërimit dhe rëndesës së Musait. Ai shkoi pranë Harunit. E kapi fort nga jaka dhe e shkundi:

“Pse nuk i pengove kur i pe se po shkonin në rrugë të gabuar? Pse nuk iu binde urdhrit tim?”

“O bir i sime mëjel! Mos më tërhiq, as nga jaka, as nga mjekra. Nuk kam faj unë. Gjithë sa munda, e bëra.”

Musai iu kthye Samirit: “Zhduku njëherë e mirë që këtej! Pas kësaj, dënimi yt do jetë që çdo njeriu që sheh, do i thuash: ‘Ruaju, mos më prek!’. Shiko idhullin që ke bërë për t’u adhuruar! Do e djeg, do e bëj hi dhe hirin do e hedh në det.”

Pas pak kohësh gjithë trupi i Samirit u mbush me plagë të tmerrshme. Të gjithë largoheshin prej tij të tmerruar. Edhe ai vetë nuk dilte dot mes njerëzve, sepse pak ta preknin, plagët



i dhembnin e i digjnin tmerrësisht. Musai e dogji statujën para syve të të gjithëve, derisa mbeti veç hiri. Edhe atë e hodhi në det. Pastaj doli para popullit të vet dhe përsëriti ato fjalë, që secili profet i ka thënë:

“Zoti juaj është Allahu. Nuk ka zot tjetër veç Tij. Dituria e Tij ka përfshirë gjithçka...” Mori tabelat e Teuratit dhe nisi t’ua lexonte Izraelitëve. Po ata vërtet që nuk dinin të zinin mend. I thanë Musait se urdhrat e Zotit ishin shumë të rëndë për ta. Pas kësaj zbriti meleku Xhebrail. Me krahët e tij e ngriti gjithë malin Tur dhe e solli mbi Izraelitët. Mali gjigant do binte mbi kokën e tyre e do i shkatërronte. Të tmerruar, as ata vetë nuk e kuptuan ç’po i gjente. Të gjithë dridheshin prej frike. Kur fundi i malit u preku kokën, të gjithë u përkulën. Me një sy shihnin të tmerruar malin që po u vinte mbi kokë, nga ana tjetër pendoheshin e kërkonin falje e mëshirë. Atëherë Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ndërhyri dhe iu lut Zotit që t’i mëshironte. Zoti e pranoi lutjen e tij dhe Xhebraili e ktheu malin sërish në vend.

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) mblodhi Izraelitët dhe u tha të zgjidhnin një grup prej shtatëdhjetë vetash prej tyre. Bashkë me ta do shkonte në malin Tur dhe do i lutej Zotit për falje e mëshirë. Më në fund, arritën në mal. Musain e mbështolli një re dhe në majë të malit nisi të fliste me Zotin. Shtatëdhjetë vetë e kishin parë mrekullinë me sy. Po ja që nuk zinin mend.

– “O Musa!” – i thanë. – “Ne nuk do të të besojmë ty pa e parë Zotin me sytë tanë.”

Pas pak, mali nisi të dridhej. Një tërmet i tmerrshëm shkundi gjithçka. Një zhurmë e paimagjinueshme drodhi botën. Shtatëdhjetë vetë dhanë shpirt aty, menjëherë. Musai, që kishte parë gjithçka, u përkul menjëherë.



“O Zoti im! Fuqia Jote është e mjaftueshme të na shkatërrojë të gjithëve menjëherë. O Zot! Mos na shkatërro për faj të disa injorantëve të pabesë që kemi mes nesh! Na fal, na mëshiro! Oqeani Yt i faljes është pafund.”

Zoti e pranoi sërish lutjen e Musasë dhe i ngjalli sërish të shtatëdhjetë të vdekurit. Kur u kthyen sërish te populli i tyre, ata u treguan gjithë ç’kishin përjetuar.

Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) ndërroi jetë pak kohë para Musait. Ai ishte simboli i besnikërisë dhe i përkushtimit te Zoti.

Profeti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk e arriti triumfin e Jeruzalemit. Por për dyzet vjet që jetoi në shkretëtirë, rriti një brez të ri nga Izraelitët. Kur u afruan te dyert e qytetit me një ushtri të fortë e të vendosur, ai ishte i moshuar. Por ishte i bindur se Jeruzalemi do të fitohej. Gjithë jetën kishte vuajtur e ishte munduar. Kishte jetuar me ëndrrën e atij qyteti të shenjtë. Dhe ja, triumfi ishte pak hapa më tej. Por për Musanë kishte ardhur ora e largimit. Zoti do ia tregonte atij triumfin nga ana tjetër. Kur i erdhën ditët e fundit, Musai hapi duart e u lut: “O Zoti im! Më bëj që të vdes pranë këtij qyteti të shenjtë.”

Dëshira e tij e fundit ishte të varrosej pranë tokës që kishte ëndërruar gjithmonë. Me një qetësi të thellë, priti vdekjen. Mbylli sytë i lumtur se e kishte përmbushur më së miri misionin e tij.



VENDE, POPUJ, NJERËZ E NGJARJE QË PËRMENDEN NË KUR'AN:

MEDINIA

“Banorëve të Medines dhe beduinëve, që janë rreth saj nuk u lejohet të mos ndjekin të Dërguarin e Allahut, as të kursejnë jetën e tyre para jetës së tij. Kjo është kështu sepse atyre, që janë në rrugën e Allahut, sa herë që t’i godasë etja, lodhja e uria dhe sa herë që të shkelin në ndonjë vend ku do t’i zemërojnë mohuesit a t’i gjejë gjë nga ana e armikut, do t’u shkruhet si vepër e mirë. Sigurisht, Allahu nuk do t’ua humbë shpërblimin vepërmirëve.”

Abstrakt

Sipas historisë islame, Profeti Mubamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka qëndruar dhjetë vjet në Medine. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e donte shumë Medinen. Medina është simbol i historisë shpirtërore të botës. Sipas dijetarëve të Kur’anit, në Medine kanë zbritur 30 sure, me mbi 1800 ajete ose me rreth 30% të Shpalljes së Allahut. Një dije e pafund kur’anore, islame. Edhe ezani – njëra nga shenjat e Islamit është thirrur për herë të parë



në Medine. Në Medine është Xhamia e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në Medine u formua bashkësia (ymeti) islame.

Sipas një treguesi të Kur'anit, ajetet e sureve 9:120, 33:9-27, 63:7-8 etj. kanë të bëjnë me Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) e me ngjarjet në Medine. Sipas historisë islame, Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka qëndruar dhjetë vjet në Medine.¹

Medinia ka 95 emra: Taiba, Taba, Kubbat al-Islam, Al-Mu'mina, Al Mubaraka, Al-Mukhtara, Dar Al-Abrar, Dar Al-Sunna, Dar Al-Akhjar, Dar Al-Fateh, Dhat Al-Hirar, Dhat Al-Nakhl, Al Barraha dhe Al-Xhabira etj. Kurse në Suren 9, ajeti 120, qyteti përmendet me emrin Medine: **“Banorëve të Medines dhe beduinëve, që janë rreth saj nuk u lejohet të mos ndjekin të Dërguarin e Allahut, as të kursejnë jetën e tyre para jetës së tij. Kjo është kështu sepse atyre, që janë në rrugën e Allahut, sa herë që t'i godasë etja, lodhja e uria dhe sa herë që të shkelin në ndonjë vend ku do t'i zemërojnë mohuesit a t'i gjejë gjë nga ana e armikut, do t'u shkruhet si vepër e mirë. Sigurisht, Allahu nuk do t'ua humbë shpërblimin vepërmirëve.”**

Përpara shpërnguljes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) Medinia quhej Jethrib. Në Kur'an thuhet: **“Dhe një grup prej tyre tha: ‘O banorët e Jethribit, s'ka qëndrim këtu për ju, prandaj kthehuni!’ Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: ‘Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura’. Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin.”**

Siç dihet, qyteti i lindjes (Meka) e përndoqi dhe e braktisi

1 Medinia shtrihet në pjesën veriperëndimore të Mbretërisë së Arabisë Saudite, 250 km në lindje të Detit të Kuq, në një rrafshnaltë, 620 m mbi nivelin e detit. Rrethohet nga disa male.



Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Por ai bëri qytet të vetin Jethribin. Ai u bë Qyteti i Profetit (*Medinah al Nabi*) dhe që atëherë është quajtur Medine². Sigurisht, Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) e donte shumë Medinen; por ai kishte në zemër edhe mallin e dashurinë për qytetin e lindjes, Mekën. Si Meka, Medina është simbol i historisë shpirtërore të botës.

Sipas dijetarëve të Kur'anit, në Medine kanë zbritur 30 sure, me mbi 1800 ajete ose me rreth 30% të Shpalljes së Allahut. Një dije e pafund kur'anore, islame. Edhe ezani – njëra nga shenjat e Islamit është thirrur për herë të parë në Medine. Në vitin XI të profetësisë së Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) nga fisi Hazrexh në Jethrib e pranuan Islamin edhe gjashtë burra të tjerë. Në Jethrib u bë thirrje për në Islam.³

Medinia është qyteti i ensarëve, i atyre që, përkundër dyfytirakëve, mbajtën muhaxhirët e që bashkërisht hynë në Mekë tetë vjet pas Hixhrit. Në Medine u bë vëllazërimi ndërmjet muhaxhirëve (ardhësve) dhe ensarëve (vendësve). Në suren 59, ajeti 9 thuhet: **“Ata që kanë shtëpinë (Medinen) dhe imanin, i duan ata (muhaxhirët) që emigruan ...”**.

Pas Besëlidhjes së dytë të Akabesë, të gjithë myslimanët nisën të shpërnguleshin për në Medine. Disa nga shokët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) qenë shpërngulur atje përpara Besëlidhjes. Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) i qe shfaqur në ëndërr vendi ku do të shpërnguleshin myslimanët. Për këtë ai u tha: *“Kam parë në ëndërr se u shpërngula nga Meka në një vend ku kishte hurma. Kujtova se ishte Jamami ose Haxheri, por ai ishte Medina, Jethribi.”* Në një kumtim tjetër thuhet: *“Mua më është treguar vendi i shpërnguljes suaj midis dy malesh. Ai vend do të jetë ose Haxheri ose Jethribi”*. Në Medine

2 Medine (në arabisht *Mada'in*) do të thotë qytet.

3 Shih *Lulishta e dritave*, Tiranë, 1999, f. 100.



shkuan edhe ata që patën emigruar në Habeshe (Abisini).⁴

Sipas historisë islame, Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka mbërritur në Medinë në fillim të muajit rabiul euel. Ishte viti XIV i profetësisë. Kur i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) filloi të dallonte Medinen, tha: “*Kjo është Tabeja; ky është mali Uhud, i cili na do ne e edhe ne e duam atë*”. Njerëzit e Medines e dëgjuan se po vinte i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) dhe i dolën përpara burra, gra e fëmijë për ta pritur. E pritën me shumë dashuri e nderim, derisa ai hyri në xhami dhe fali dy rekatë namaz. Pastaj u ul e priti njerëzit për biseda me ta.⁵

Në Suren 33 tregohet se si u përpoqën ta shfarosnin bashkësinë islame në Medinë. Qenë kurejshët paganë, çifutët (Benu Nadir), fisi Ghatfan i arabëve beduinë dhe fisi çifut Benu Kurejsh. Ishte një bashkëlidhje kriminale kundër Islamit. Por Islami doli triumfator. Në ajetin 9 të kësaj Sureje thuhet: **“O ju që keni besuar! Kujtoni mirësinë e Allahut, kur ju erdhi një ushtri idhujtarësh⁶ e Ne dërguam mbi ta erë dhe një ushtri (melekësh), që ju nuk e shihnit. Ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju”**.⁷ Islami triumfoi. “Është Ai (Allahu) që e ka çuar të Dërguarin, - thuhet në ajetin 33 të Sures 9, - **me udhërrëfim** (Kur'anin) **dhe fenë e së Vërtetës, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë.**”

Në Medinë është Xhamia e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Ajo u ndërtua pasi erdhi Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) në Medinë. Gjëja e parë

4 Shih *po aty*, f. 112, 113.

5 Shih *po aty*, f. 267.

6 10-12 mijë veta, sipas historisë islame - për atë kohë, një ushtri e stërmadhe.

7 Është fjala për rrethimin e Medines për të shkatërruar Islamin. Lufta njihet me emrin Beteja e Hendekut. Ishte shkurt. Allahu çoi kundër rrethimtarëve një erë shumë të ftohtë. Tendat e armikut u shqyen. U shuan zjarret e tyre. Rëra dhe shiu rrihnin fytirat e tyre. Por përveç forcave të natyrës, ishte forca morale, disiplina e përkryer e forcave islame dhe udhëheqja e shkëlqyer e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Forcat islame ishin veçse 3 000 veta.



që Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) e deshte përzemërsisht, pasi mbërriti në Medine, qe ndërtimi i një xhamie. Kjo thuhet në jetëshkrimin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Dhe vendi ku u ndërtua ajo, ishte ai ku ndaloi deveja e Profetit e s'levizi për më tej. Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) zbriti nga deveja dhe pyeti e kujt ishte ajo copë tokë. I treguan se ishte e dy jetimëve. Kujdestari i jetimëve i tha Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) se mund ta ndërtonte xhaminë aty dhe se ai do t'ua paguante jetimëve atë tokë. Por Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) urdhëroi që të blihej toka. Pasi u ble toka, Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) urdhëroi të ndëртоhej xhamia. Ai mori pjesë vetë në ndërtimin e saj. Mbarte gurë e qerpiçë dhe thoshte herë pas here: “O Zot! Nuk ka jetë të vërtetë, përveç Abiretit. Derdhi Mëshirën Tënde dhe Bekimin Tënd mbi ensarët dhe muhaxhirët!”⁸

Në Medine u formua bashkësia (ymeti) islame. Në Medine kishte edhe dy bashkësi të tjera – të ndryshme në çështje besimi, feje, ndjenjash, prirjesh etj. nga bashkësia islame. Ato ishin idhujtarët dhe jehudinjtë. Prandaj Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) bëri një besëlidhje midis myslimanëve dhe idhujtarëve dhe një besëlidhje tjetër midis myslimanëve dhe jehudinjeve. Për këtë u shkruan, siç dihet, edhe dy dokumente me dhjetë pika. Kështu, Medina me rrethinat u bë një “shtet”.⁹ Kryetari i tij ishte i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*).

Në Medine u ndërtua nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) e para shoqëri islame në botë. Ajo duhet të studiohet e të vihet në jetë në çdo kohë. Revolucioni francez shpalli: “Liri. Vëllazëri. Barazi”. Këto vlera janë shpallur e zbatuar 11 shekuj para Revolucionit francez në shoqërinë e

⁸ Xhamia është zgjeruar shumë herë. Ajo nxë 255 000 faltarë.

⁹ Shih më gjerë për këto te Lulishte e dritave, Tiranë, 1999, f. 129-131.



parë islame të Medines. Dokumenti ishte nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*): Besimtarët janë një komb. Liria, barazia dhe vëllazëria shihen në çdo fjali të tij. Kjo shoqëri lidhet për nga besimi. Asnjë lidhje tjetër s'ka. Pa dallim race, kombësie, gjuhe, ngjyre. Besimtarët janë vëllezër. Në librin “Nektari i vulosur i Xhenetit” janë disa nga parimet themelore që përcaktoi Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) në atë kohë të turbullt e të ndjeshme, kur po lindte Islami. Ja disa nga ato: *Besimtarët janë një komb. Besimtarët nuk do të lënë në gjirin e tyre të varfër ... Kushdo që kërkon të përhapë armiqësi ..., mbi të do të bjerë dora e çdo myslimani, që e ka frikë Allahun, qoftë ai edhe biri i tij. Besimtari nuk do ta vrasë besimtarin dhe nuk do ta përkrabë jobesimtarin kundër besimtarit. Mbrojtja e Allahut është një dhe shkon deri te besimtari më i përvuajtur. Besimtarët përkrabhin njëri-tjetrin ... Paqja midis besimtarëve është e pandashme ... Kushtet (për paqe) duhet të jenë të drejta dhe të njëjlojta për të gjithë. Është e paligjshme për një besimtar ... që të ndihmojë një keqbërës ose t'i japë strehë atij. Ata, që i japin strehë dhe ndihmë, do të kenë mallkimin dhe zemërimin e Allahut Ditën e Gjykimit. Ja edhe thënia lapidare e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*): “Në dashurinë për njëri-tjetrin, në mëshirën për njëri-tjetrin, në solidaritetin për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup. Nëse dhemb një pjesë e trupit, dhemb i gjithë trupi ...”. Siç shihet, liria, barazia dhe vëllazëria shihen në çdo fjali një me një me drejtësinë, sigurinë dhe paqen. Janë parime që vijnë nga besimi në Allahun. Ato sigurojnë shpirtin, nderin dhe pasurinë. Janë parime që vijnë në Medine e prej Medines.*

Medinia është shembulli i qëndresës për të mbrojtur të Vërtetën e Islamit me rrethimin që iu bë me shpartallimin e atij rrethimi nga grupime armiqsh të egër - me Luftën e Hendekut e fitoren e myslimanëve në atë Luftë, me shpëtimin e Qytetit dhe të Islamit. Nga Medina vjen shembulli i grave islame që dolën nga Qyteti për të mjekuar të plagosurit. Nga Medina vijnë e Vërteta dhe shembujt fisnikë që duhen ndjekur. Shembulli më



i parë është Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Në Kur'an, në ajetin 21 të Sures 33 (që ka të bëjë me Medinen e me luftën për mbrojtjen e saj) thuhet: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të shkëlqyer për atë, që shpreson tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun”**.¹⁰

Sipas historisë islame,¹¹ muhaxhirët filluan të mallzoheshin për vendlindjen. Veç kësaj, në Medine kishte ethe e sëmundje të tjera. Prandaj i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) iu lut Allahut: “O Allahu im! Na e bëj Medinen të dashur si Meka, ose edhe më shumë se Meka dhe bëj që të mos ketë sëmundje në të! ...”. Allahu i Madhëruar ia pranoi lutjen të Dërguarit të Vet dhe myslimanëve iu larguan sëmundjet. Dhe myslimanët e deshën Medinen ashtu si Mekën. Dhe Medina na është e dashur si Meka.

Medinia është qyteti i Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Medina është qyteti ku prehet Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Medina është qyteti i parë që e mbështeti Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Medina është qyteti që e donte fort Profetin. Profeti e donte, gjithashtu fort Medinen. Medina është ajo tokë ku Profeti ndërtoi Xhaminë e Shenjtë e ku prehet ai. Ajo është Xhamia e dytë e Shenjtë në botë.¹² Medina qe selia e shtetit të parë islam.

Kjo është Medina.



10 Shih në Kur'an: 33:9, 10, 22-27; shih edhe 9:128; 18:6; 26:3; 33:46; 66:9; 68:4; 69:40; 77:16; etj. Shih më gjerë tek *Tregues i Kur'anit*, zëri “Muhamedi” (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) / *Tregues i Kur'anit* – pronë letrare e Fondacionit të Kur'anit.

11 Shih *Lulishta e dritave*, Tiranë, 1999, f. 125, 126.

12 Sot, Xhamia është qendra e Medines.

FJALOR KUR'ANOR

Selam (Paqe)

Një ndër emrat e bukur të Allahut është edhe Selam, Paqedhënesi.

Allahu i Madhëruar është Paqe absolute. Nga drita e paqes erdhën edhe Islami, Profeti dhe Kur'ani. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) erdhi për paqen dhe për sigurinë. Në Kur'an lexojmë: **“Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë, me lejen dhe me vullnetin e Vet dhe i çon në Rrugën e Drejtë.”** (“Maide”, 15-16).

Fjala “selam” në Kur'an përmendet në përgjithësi dhe në forma të ndryshme në 140 vende. Në 112 vende përmendet si emër dhe në 28 vende të tjera përmendet si folje. Me kuptimin “paqe” përmendet në 46 vende në Kur'an dhe me kuptimin e përshëndetjes përmendet në 10 vende. Të gjitha këto përmenden në 50 ajete dhe në 28 sure të Kur'anit të Shenjtë. Po ashtu, ka rreth 300 hadithe nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin bi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo tregon për rëndësinë e madhe që i kushton Islami paqes dhe sigurisë. Ku ka paqe dhe siguri, ka qetësi shpirtërore dhe psikike.



Vetë fjala “Islam” vjen nga fjala “selam” (paqe). Paqja është qëllimi i çdo njeriu të urtë e me mend. Ai që hyn në Islam, vërtet ka hyrë në paqe e në siguri.¹

Në Kur'an fjala “selam” vjen me disa kuptime:

- Me kuptimin e emrit të Allahut. Në suren “Hashr” ajeti 23 thuhet: **“...Ai është Sunduesi, i Shenjti** (i pastër nga çdo e metë), **Paqdhënësi...**”

- Me kuptimin e përshëndetjes së njohur “Paqja qoftë mbi ju!” (*es selamu alejkum*). Në ajetin 54 të sures “En’am” thuhet: **“Kur të vijnë tek ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: ‘Paqja qoftë mbi ju!...’”**.

Dhe: **“...Kur të hyni në shtëpi, përshëndeteni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur nga Allahu...”** (Sure “Nur”, ajeti 61).

- Me kuptimin e paqes e të bekimit. Në ajetin 48 të sures “Hud” thuhet: **“O Nuh, zbrit me paqe prej Nesh dhe me bekime për ty dhe pasardhësit e atyre që gjenden me ty...”** Dhe: **“Paqja qoftë me Nuhun ndërmjet gjithë krijesave!”** (Sure “Safat”, ajeti 79). Dhe: **“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”** (Sure “Safat”, ajeti 109). Dhe: **“Atyre do t’u thuhet: ‘Hyni atje me paqe dhe siguri!’”** (Sure “Hixhr”, ajeti 46). Dhe: **“Largohu prej tyre (o Muhamed) dhe thuaju: ‘Paqe!’...”** (Sure Zuhruf”, ajeti 89). Dhe: **“Robtë e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen:**

¹ Gjuhësisht, “selam” ka kuptimin “shëndet, shërim e ruajtje e njeriut nga të këqijat e keqbërja”.



‘Paqe qoftë!’ (Sure “Furkan”, ajeti 63).

- Me kuptimin e Islamit. Në ajetin 208 të sures “Bekare” thuhet: **“O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij!”**²

Vullnet Merja

2 Fjala “selam” përmendet edhe në këto sure: “Nisa”, ajeti 94; “Maide”, ajeti 16; “En’am”, ajeti 54; “En’am”, ajeti 127; “Araf”, ajeti 46; “Junus”, ajeti 10; “Junus”, ajeti 25; “Hud”, ajeti 48; “Hud”, ajeti 69; “Rra’d”, ajeti 24; “Ibrahim”, ajeti 23; “Hixhr”, ajeti 52; “Nahl”, ajeti 32; “Merjem”, ajeti 15; “Merjem”, ajeti 33; “Merjem”, ajeti 47; “Merjem”, ajeti 62; “Taha”, ajeti 47; “Enbija”, ajeti 69; “Furkan”, ajeti 75; “Neml”, ajeti 59; “Kasas”, ajeti 55; “Ahzab”, ajeti 44; “Jasin”, ajeti 58; “Safat”, ajeti 120; “Safat”, ajeti 130; “Safat”, ajeti 181; “Zumer”, ajeti 73; “Zukhruf”, ajeti 89; “Kaf”, ajeti 34; “Dharijat”, ajeti 25; “Uakiah”, ajeti 26; “Uakiah”, ajeti 91; “Hashr”, ajeti 23; “Kadr”, ajeti 5.




TRASHËGIMIA KUR'ANORE TE SHQIPTARËT

PËRKTHIMET E PARA INTEGRALE DHE PËRKTHYESIT E PARË TË KUR'ANIT NË GJUHËN SHQIPE

I

Prishtinë, 1985, 882 faqe. Përktheu Feti Mehdiu. Boton: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë. Është ribotuar në vitin 1999 dhe në vitin 2015.



Dr. Feti L. Mehdiu u lind më 20 janar, 1944 në Zajaz të Kërçovës, Republika e Maqedonisë. Në vitin 1959 shkoi në Prishtinë për të vazhduar shkollimin në medresenë e ulët. Aty vazhdoi edhe medresenë e mesme “Alauddin” dhe mori maturën në vitin 1967. Studimete larta

i ndoqi në Fakultetin e Filologjisë në Beograd, në Degën e Filologjisë Orientale (gjuhë arabe dhe gjuhë turke). U diplomua në vitin 1971 dhe mori titullin akademik *Profesor i filologjisë orientale*. Krahas filologjisë orientale, studioi edhe gjuhën shqipe. Studimet pasuniversitare për gjuhësi i ndoqi në Universitetin e Beogradit. Në qershor, 1977 mbrojti punimin e magjistraturës



Srpskohrvatski prevodi Kur ana (Përkthimet e Kur'anit në gjuhën serbokroate). Është specializuar për gjuhën arabe në Universitetin e Kajros. Doktoratën “Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe 1922-1982” e ka mbrojtur në Prishtinë, në vitin 1990.

Në vitin 1973 filloi punën në Institutin e Historisë, në Prishtinë. Nga marsi i vitit 1974 punoi si asistent i gjuhës arabe, në Fakultetin Filozofik - dega e orientalistikës. Pas mbrojtjes së magjistraturës u zgjodh ligjërues, kurse pas mbrojtjes së doktorates, në vitin 1990, u zgjodh *docent i gjuhës arabe: fonetikë – morfologji*. Nga viti 1997 - 2003 është profesor në degën e orientalistikës për gjuhë arabe.

Në vitin 1964, Feti Mehdiu aktivizohet në LRBSH (**Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve**, në krye të së cilës ishte Adem Demaçi.), në Prishtinë. Në vitin 1965 është kryetar i Shoqatës së nxënësve të medresesë “Alauddin”, themelues dhe udhëheqës i bibliotekës së medresesë. Në vitin 1970, sekretar i Shoqatës së studentëve shqiptarë “Përpjekja” në Beograd dhe anëtar i redaksisë së revistës së studentëve të orientalistikës “**El Emel**”.

Në vitin shkollor 1974/1975 është sekretar i degës së orientalistikës, kurse viti 1981 e gjeti përgjegjës të degës. Në vitin 1990 zgjidhet anëtar i Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë me seli në Sarajevë dhe anëtar i Këshillit të Vakëfit në Prishtinë. Në vitin 1991 udhëhoqi Këshillin për emergjencë në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në vitin 1994 dha gjuhën arabe në Universitetin e Tetovës, kurse në vitin 2002-2004 ka mbajtur leksione nga lënda “Orientalistika dhe orientalistët” në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Ka qenë anëtar i redaksisë: *Dituria islame, Bashkimi paqësor*, Filologji-Prishtinë; anëtar i redaksisë *Përmbledhje e punimeve shkencore*, Fakulteti i shkencave islame në Shkup; anëtar



i redaksisë *Perla* dhe *Drita e Kur'anit* në Tiranë.

Në vitin 2002 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave në Damask.

Literaturë

- Feti Mehdiu, *Maturantët e parë të Medreses "Alauddin"*, (gjenerata 1967), Prishtinë, 2007.
- Dr. Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*, Shkup, "Logos-A", 1996.
- Mehmed Kico, *Islamska književnost izmedju arabizma i arabistike*, Sarajevo, 2015.
- *Ura*, viti III, nr. 1/2010, Tiranë (Numër jubilar me rastin e 25-vjetorit të përkthimit të parë të Kur'anit të plotë në gjuhën shqipe, shih: f. 45: Eveniment i kulturës shqiptare; f. 51: Duke lexuar Kur'anin në gjuhën shqipe; f. 92. Mbi përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe.)
- **Shih revistat:** *Hikmet*, nr. 10, 2015, Prishtinë, f. 75.. ; *Perla*, nr. 1/2015, Tiranë, f. 109 – 116; *Edukata islame*, nr. 109, Prishtinë, f. 241 – 257; *Glasnik VIS-a*, nr. 5, 1985, Sarajevo, f. 471; *Glas Koncila*, nr. 45, (10 studenog), 1985, Zagreb; *Kulture Istoka*, nr. 9/1986, f. 64, Beograd, *Takvim* -1986, Prishtinë, f. 148; *T a k e v i m* – 1987, Prishtinë, f. 133.
- Feti Mehdiu, *Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe*, në *Drita e jetës*, nr. 5-6/2009, Gjilan, f. 97-115.

- ترجمة جديدة للقرآن الكريم الى اللغة الالبانية ملحق الثا 17 دسمبر 1985

- فتى مهدي ترجمات القرآن الى اللغة الالبانية تريلس استنبول 1987



II

Prishtinë, 1988, fq. 612. Përktheu Hasan I.Nahi. Pas vitit 2000 janë bërë disa ribotime në Prizren dhe Tiranë.



Hasan efendi Nahi (1905-1991)

u lind me 12 mars 1905 në Gjakovë. Këtu mori njohuritë e para shkollore, përfshirë edhe bazat islame në Medresenë e Madhe të Gjakovës, që i ka hapur dyert në vitin 1707. Në vitin 1928 merr ixhazetin dhe në vitin 1930 vazhdon studimet në Universitetin e njohur “Al-Az`har”, në Kajro. Aty pati rastin të merrte mësim nga dijetarë të shquar të nivelit botëror dhe të shoqërohej me personalitete të rralla, si poeti me origjinë nga Peja, Mehmet Akif Ersoj – autor i tekstit të himnit kombëtar të Turqisë dhe përkthyes i Kur`anit në gjuhën turke. Gjatë studimeve në Az`har, Hasan ef. Nahi u njoh me Sadik Begën nga Tirana dhe hafiz Bedri Hamitin nga Shkupi. Në prill të vitit 1934 u diplomua (shih “Dituria islame”, shkurt - mars, 1991 dhe pak më herët, intervista) dhe i kthehet punës në vendlindje, në Medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren, medresenë në Ferizaj, e detyra të tjera. Nga viti 1958 deri në vitin 1978 punoi në medresenë “Alauddin” në Prishtinë, si mësues i gjuhës arabe, akaidit, fikhut, tefsirit, hadithit e lëndëve të tjera derisa doli në pension, në vitin 1978. Këmbëngulësia e tij kontribuoi që medreseja e ulët në Prishtinë, që qe hapur në vitin 1951, të ngrihej në medrese të mesme në vitin 1962.

Në vitet 1943 – 1948, ka qenë kryemyfti i Dugagjinit, drejtor i medresesë “Mehmet Pasha” në Prizren. Ishte *sejar vaiç* në Dukagjin, që administrohej nga Këshilli i Naltë i Sheriatit me seli në Tiranë. Në vitin 1988 i dha opinionit shqiptar



përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, i cili është ribotuar pas ndarjes së tij nga jeta, në Prizren dhe në Tiranë. Në ribotimet më të reja i kanë bashkëngjitur edhe një lloj komenti, të cilin nuk e ka pasur në botimin e parë.

Hasan ef. Nahi qe nga dijetarët e rrallë në hapësirën shqiptare.

Ndërroi jetë më 5 shkurt, 1991, në Prishtinë dhe u varros me nderime e me përcjellje dinjitoze nga familjarët, dashamirë, nxënës dhe simpatizues të tij të shumtë, në Gjakovë. Në Prishtinë është themeluar dhe funksionon shkolla e mesme e rangut gjimnaz: “GJIMNAZI HASAN NAHI”. Nxënësit e këtij Gjimnazi janë dalluar në garat botërore në fushën e shkencave të sakta.

Literatura

- *Kultura Islame*, nr. 2-3/1943, Tiranë, fq. 94.
- *Myderriz Hasa ef. Nahi – jeta dhe vepra*, Prishtinë, 2012 (përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor – 5 shkurt, 2011).
- Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*, Shkup, “Logos-A”1996, fq. 72-74.
- Puna, suksesi dhe kuadrot e nxjerra ma zgjasin jetën (intervistë e Hasan ef. Nahit)
- *Dituria islame*, nr. 18/1990, Prishtinë, fq. 12-16.
- **Vdiq Hasan efendi Nahi**, në *Dituria islame*, nr. 22-23/1991, Prishtinë, fq. 14-17.
- Feti Mehdiu, *I tillë ishte Hasan efendija*, në *Dituria islame*, nr. 22-23/1991, Prishtinë.
- Feti Mehdiu, Përkthimi i Kur'ani Kerimit nga Hasan ef. Nahi dhe veçoritë e ribotimit të këtij përkthimi (në 20-vjetorin e vdekjes së Hasan ef. Nahit). *Takvim*, Prishtinë, 2013, fq. 239-270.

Galib Lila



VEPRIMTARI KUR'ANORE

Tiranë, zhvillohet aktiviteti “Shoqëria e hapur, demokracia dhe edukimi - armët kundër ekstremizmit”

Më 14 janar 2016, universiteti “Bedër” në bashkëpunim me “Unionin e gazetarëve të Shqipërisë” organizoi panelin e diskutimit me temë: **“Shoqëria e hapur, demokracia dhe edukimi - armët kundër ekstremizmit”**. Paneli i referuesve të këtij takimi përbëhej nga rektori i universitetit “Bedër”, z. Ferdinand Gjana, z. Blendi Klosi, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Aleksandër Çipa, kryetari i Unionit të gazetarëve të Shqipërisë, z. Besnik Mustafaj, presidenti i Forumit shqiptar për Aleancën e Qytetërimeve, z. Bernard Fitoussi, ambasadori i Republikës së Francës. Paneli i referuesve u drejtua nga z. Gjana.

Konferenca shkencore “Zani i naltë, një shekull në shërbim të dijes”

Më 16 shkurt 2016 në ambientet e universitetit “Bedër” në Tiranë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës organizuan konferencën shkencore **“Zani i naltë, një shekull në shërbim të dijes”**. Në fjalën e tij z. Skënder Bruçaj, kryetar i Komuniteti Mysliman të



Shqipërisë, theksoi se punimet e kësaj reviste mbeten sa edukuese, aq edhe aktuale për kulturën dhe arsimin edhe në ditët e sotme, pavarësisht se sa kohë ka kaluar. Ndërsa ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, vlerësoi rëndësinë e shkrimeve të kësaj reviste si një vlerë e shtuar te shqiptarët. Kjo konferencë u organizua me rastin e botimit të Kolanës “Zani i Naltë”. Fondacioni i Kur’anit u përfaqësua nga z. Vullnet Merja, drejtor i këtij institucioni. Në këtë konferencë ishin të pranishëm akademikë, studiues, intelektualë dhe drejtues të institucioneve të ndryshme fetare dhe kulturore.

Zyra e gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë organizon simpoziumin “Shumë role në një dorë”

Më 4 mars 2016, zyra e gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, në kuadër të Ditës ndërkombëtare të gruas, organizoi simpoziumin me temë: “Shumë role në një dorë”, ku u trajtuan tema të ndryshme mbi rolin dhe detyrimet e gruas në shoqëri. Përgjegjësja e zyrës së gruas, znj. Fatma Karaj, u shpreh se gruaja duhet të jetë në çdo fushë të jetës: në politikë, art, jetë akademike, ekonomi, edukim etj.

Të pranishëm në aktivitet ishin drejtues të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, intelektualë/e, përfaqësuese të biznesit dhe jetës kulturore. Fondacioni i Kur’anit u përfaqësua nga znj. Sabrie Feza, përgjegjëse e zyrës së gruas pranë këtij institucioni.

Medreseja e Tiranës organizon një program artistik kushtuar Kur’anit

Më 18.3.2016, Medreseja e Tiranës organizoi programin artistik kushtuar Kur’anit Famëlartë në ambientet e universitetit



“Bedër”. Në këtë aktivitet të ndërthurur me leximin e ajeteve të Kuranit, ilahi, poezi dhe aktrim, u përçuan mesazhet dhe vlerat universale të Islamit. Kryetari i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bruçaj, vlerësoi nxënësit e Medresesë, për vullnetin dhe dëshirën e tyre në përvetësimin dhe përcjelljen e mesazheve të Kur'anit. Ai u shpreh se sa më shumë ta njohim dhe ta lexojmë Kur'anin, aq më afër harmonisë shpirtërore do të jemi. Drejtori i shkollës, z. Omer Çallësh, bëri të njohur qëllimin e organizimit të këtij programi: *“Me këtë program duam të promovojmë edhe një herë mesazhet e larta të Kur'anit, mesazhet e jetës. Allahu e ka lidhur lumturinë e të dy botëve pas udhëzimeve të Kur'anit”*.

Gjatë këtij programi u transmetua edhe reportazhi i realizuar nga Komuniteti Mysliman: “Mrekullia e Kur'anit”. Në program morën pjesë akademikë, drejtues shoqatash fetare dhe kulturore, mësues, prindër, nxënës etj. Fondacioni i Kur'anit u përfaqësua nga drejtori, z. Vullnet Merja.

Hapet fondacioni “Gnosa” në Tetovë

Më 26 mars 2016, në Tetovë, u zhvillua hapja solemne e **Fondacionit për Kulturë dhe Shkencë “GNOSA”**. Si një zhvillim i mëtejshëm i veprimtarisë së Librarisë “Dielli”, Fondacioni “GNOSA”, përveç promovimit të mendimit intelektual islam nëpërmjet botimeve cilësore, synon të organizojë edhe konferenca, seminare dhe kurse nga lëmenj të ndryshëm të diturisë. Në fjalimin e tij përshëndetës para të pranishmëve, duke folur mbi misionin e kësaj sipërmarrjeje, drejtori i përgjithshëm, Admir Sherifi, tha: *“U ndalëm pikërisht tek emri “GNOSA”, që do të thotë njohje, pra njohje e së Vërtetës, e Krijuesit, e Zotit...”* Ceremonia e hapjes solemne u ndoq nga manifestimi shkencor i mbajtur në hapësirat e Universitetit të Evropës



Juglindore (UEJL) në Tetovë. Në këtë program shkencor, fillimisht u bë promovimi i librit “Hyrje në botëkuptimin islam” (vëll.1) nga Murteza Mutahari, që është botimi i parë i Fondacionit “GNOSA”. Lidhur me jetën dhe veprën e autorit foli teologu Vullnet Merja, drejtor i “Fondacioni të Kur’anit” në Tiranë.

Vjollca Karaj

U SHENUA 30-VJETORI I PËRKTHIMIT TË PARË TË KUR`ANIT NË GJUHËN SHQIPE

Më 26 dhe 27 dhjetor, 2015, në Prishtinë, me organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë, u mbajt simpoziumi me temë: KUR`ANI TE SHQIPTARËT. Simpoziumi u organizua për të shënuar jubileun e tridhjetëvjetorit (1985-2015) të përkthimit dhe të botimit të parë të Kur`anit në gjuhën shqipe. E nderuan me pjesëmarrjen e tyre drejtues të tri bashkësive islame në Ballkan: Mr. Naim ef. Tërnavë, kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, h. Bujar Spahiu dhe h. Sulejman ef. Rexhepi, të cilët inkurajuan këtë aktivitet dhe i uruan punë të mbarë.

Në fjalën e tij, mr. Naim ef. Tërnavë, vuri theksin mbi faktin që: *“...Bashkësia Islame e Kosovës dhe dr.Feti Mehdin, i bënë realitet idenë dhe përpjekjet e kamotshme të shumë brezave dhe të shumë personaliteteve me Kur`anin, të përkthyer dhe të botuar në gjuhën e tyre”.*

Gjatë punës dyditore u paraqitën 36 kumtesa nga studiues të profileve të ndryshme nga Kosova, Shqipëria dhe



Maqedonia (Musa Kraja, Rahim Ombashi, Ramiz Zeka, Lauret Luli, Elez Ismajli, Abdulxhemil Nesimi, Adem Zejnullahu, Hysen Matoshi, Qazim Qazimi, Qemal Morina, Nuridin Ahmeti, Hatixhe Ahmedi, Besa Ismaili, Sadik Mehmeti, Ramdan Shkodra, Imer Topanica, Liridon Kadriu, Musa Vila, Feti Mehdiu, Nehat Krasniqi, Isa Memishi, Jakup Çunaku etj. Në kumtesat e tyre u trajtuan çështje të Librit të Kur'anit, të formateve të tij, kopjimit, përkthimit, komentimit etj., te populli shqiptar. Kumtesat dhe diskutimet do të botohen në një përmbledhje të veçantë.

Kumtesat hapin shtigje të reja për afirmimin e vlerave të Kur'anit si Libër i zbritur për edukimin e drejtë të njerëzve, por edhe si kod universal që rregullon marrëdhëniet e shoqërisë njerëzore në nivele të ndryshme. Këtu hapet rruga për një vlerësim edhe të punës së përkthyesve nga këndvështrime të ndryshme: gjuha, stili, zgjedhja e fjalës, mundësitë e ngritjes së përkthimit në nivel më të lartë, tipizimi i përkthimeve të Kur'anit etj.

Organizatori i simpoziumit i nderoi pjesëmarrësit, duke u dhuruar simbolikisht botimin e tretë të përkthimit të parë të Kur'anit në gjuhën shqipe.

Galib Lila



VEPRIMTARI KUR'ANORE NDËRKOMBËTARE

Kopjet 300-vjeçare të Kur'anit, thesar i çmuar në jug të Tajlandës

Disa kopje të Kur'anit, të cilat janë mbi 300-vjeçare, janë zbuluar në jug të Tajlandës. Ato janë një thesar i çmuar për myslimanët në rajon. Përveç Kur'anit, janë mbledhur 15 kategori librash dhe dorëshkrimesh të dijetarëve Fathoni (të cilët patën ardhur nga krahina e Pattanit): dorëshkrime fetare, shkencore, mjekësore, si edhe dorëshkrime për ndërtimin e anijeve.

Mbi 200.000 veta marrin pjesë në mësimin e Kur'anit përmendsh

Më shumë se 200.000 njerëz në provincën e Teheranit në Iran, morën pjesë në të katër raundet kombëtare të mësimin përmendsh të Kur'anit. Shumica e atyre që marrin pjesë në kurse janë të moshës 7 - 18 vjeç. Ata kanë mësuar përmendsh xhuzin (pjesën) e fundit të Kur'anit të Shenjtë.

Kur'ani - libri më i shitur në panairin e librit në Kasablanka

Panairi i 22-të ndërkombëtar i librit në Kasablanka është mbajtur prej datës 12 shkurt deri më 21 shkurt 2016.



Gjatë panairit janë zhvilluar edhe forume rreth librave, për tema të ndryshme, me pjesëmarrjen e dijetarëve fetarë nga vende të ndryshme.

Turqia do të përkthejë Kur'anin në gjuhë të ndryshme

Departamenti për Çështje Fetare i Turqisë, “Dijaneti” ka nisur një projekt që synon për të përkthyer dhe për ta botuar Kur'anin e Shenjtë në të paktën, dhjetë gjuhë, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe, koreane dhe lituane. Sipas Departamentit për Çështje Fetare, “Dijaneti”, motoja e projektit është: Mos lejoni asnjë gjuhë të mbetet pa mesazhin e Kur'anit!

Teksti origjinal, arabisht do të përkthehet në ukrainisht, kirgizisht, shqip, portugalisht, boshnjakisht, anglisht, bullgarisht, koreanisht, persisht dhe lituanisht.

Ne synojmë, - tha Yıldırım Kaplan, një zyrtar i lartë nga “Dijaneti”, - për ta përkthyer dhe gradualisht për ta botuar Kur'anin e Shenjtë në të gjitha gjuhët që fliten në botë. Ne do t'i publikojmë përkthimet deri në fund të vitit 2016.

Garat kur'anore europiane u mbajtën në Kroaci

Garat kur'anore europiane për hafiz të Kur'anit dhe këndim të Kur'anit u organizuan në Qendrën Islamike të Zagrebit, në Kroaci. 81 hafizë të Kur'anit - meshkuj dhe femra dhe këndues të Kur'anit nga 20 shtete europiane konkuruan në katër kategori: në mësimin përmendsh të tërë Kur'anit, mësimin përmendsh të 15 dhe 5 xhuzeve dhe në këndimin e Kur'anit.



Përkthimi i Kur'anit në anglisht është pranuar mirë në Amerikë

Drejtori i Instituti Kulturor Tarxhuman-i, Vahi tha se përkthimi anglisht i Kur'anit të Shenjtë nga Sejjid Ali Ghuli Gharaji është pranuar mirë edhe nga populli amerikan dhe kanadez.

Përkthimi është botuar për herë të parë në vitin 2001. Ky është edicioni i pestë i Kur'anit, një vepër shumë e vlefshme, që është duke u shpërndarë në Iran dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Konferencë e studimeve kur'anore në Londër

Konferenca e gjashtë ndërkombëtare për studime kur'anore do të mbahet në Londër, Angli, këtë vit.

Konferenca do të organizohet nga Instituti Kur'anor Ndërkombëtar.

Temat që do të mbahen, janë si më poshtë:

- Qeveritë islame dhe udhëzimet e tyre kur'anore.
- Ligji në Kur'an dhe lidhja e tij në ndërveprim me ligjet laike dhe të drejtën ndërkombëtare.
- Bankat islame dhe tregjet financiare.
- Përgjigjet kur'anore për sfidat intelektuale dhe filozofike, me të cilat përballen myslimanët.
- Themeli kur'anor i tendencave shpirtërore dhe mistike brenda dhe jashtë botës myslimane.
- Një eksplorim i letërsisë për ndikimin e Kur'anit mbi botën e dijes, politikës, shoqërisë, psikologjisë etj.
- Një pasqyrë për interpretimet tradicionale dhe të hermeneutikës së Kur'anit të Shenjtë.
- Gjuha arabe e Kur'anit: A është në rënie apo është duke u



mbështetur nga mediat e reja?

- Përkthimi i Kur'anit të Shenjtë.
- Strukturat etike që udhëzohen nga Kur'ani.
- Shërimi mendor dhe pasuria terapeutike e ajeteve kur'anore.
- Ndikimi i Kur'anit dhe i studimeve kur'anore në diskursin e mendimit fetar në të gjithë botën.
- Mënyrat e reja të interpretimit të Kur'anit: pikat pozitive dhe negative/një opinion kritik.

Përkthimet më të hershme të Kur'anit në gjuhë të ndryshme

Një listë e përkthimeve më të vjetra të Kur'anit të Shenjtë në tetë gjuhë është publikuar nga një faqe interneti egjiptiane.

Sipas Al-Yawm el-Sabi, përkthimi i parë i Kur'anit në gjuhën angleze është bërë nga Alexander Ross nga një përkthim nga frëngjishtja. Më vonë, përkthim i parë në anglisht i Kur'anit nga origjinali arabisht u botua nga George Sales, në vitin 1734. Në frëngjisht, përkthimi i parë i Librit të Shenjtë, Kur'anit, është bërë nga Andre Du Ryer, konsulli i përgjithshëm i Francës në Stamboll. Ky përkthim në frëngjisht u botua për herë të parë në Paris në vitin 1647 dhe u ribotua disa herë deri në vitin 1775. Përkthimi i parë i Kur'anit në hebraishte është bërë nga Hermann Reckendorf në vitin 1857.

Sa i përket përkthimit të Kur'anit në gjuhën spanjolle, ai është bërë me urdhër të Mbretit Alfons X (1221 -1284), i cili urdhëroi që surja "El-Isra", të përkthehej në spanjisht. Kjo sure u përkthye nga mjeku Ibrahim al-Doun.

Përkthimi i parë i Kur'anit në gjuhën ruse është bërë në vitin 1776 në Shën Petersburg, ndërsa Ander Arivaben e ka përkthyer për herë të Kur'anin e Shenjtë në italisht në vitin 1547.



Përkthimi i parë në gjermanisht është bërë nga Salomon Schweigger në vitin 1616, në Nuremberg. Në gjuhën holandeze, Kur'ani u përkthye në vitin 1641.

Ishte Hans Fredrik Crustenstolpe, konsulli i përgjithshëm suedez në Marok, i cili e përktheu për herë të parë Kur'anin në gjuhën suedeze në vitin 1842.

Libri “Dorëshkrimet e Kur'anit” u botua në Kuvajt

Një libër i titulluar “Khutut El-Musahaf” (Dorëshkrimet e Kur'anit), u botua nga Qendra e Arteve Islame në Kuvajt. Libri është botuar për ta pasuruar kulturën e studimeve islame. Libri është shkruar nga Adham Muhammed Hanash, ekspert në kaligrafinë arabe. Libri ka 120 faqe, 3 kapituj, që përfshijnë dorëshkrimet kur'anore, dorëshkrimet e përdorura në zyra dhe dorëshkrimet e përdorura nga autorët.

Kur'ani - Burimi që i bashkon myslimanët

Në Konferencën Islame të mbajtur në Nowshera Virkan, Punxhab, Pakistan, u theksua roli i dijetarëve fetarë për bashkimin mes myslimanëve për të trajtuar të gjitha sfidat e kohës. Mian Ihsanullah Azei, dijetar fetar, tha: “Islami mëson dashurinë, vëllazërinë dhe unitetin. Prandaj, pasuesit e të gjitha sekteve duhet të tolerojnë dhe të respektojnë besimin e njëri-tjetrit, për të promovuar harmoninë.”. Ai theksoi nevojën për të vepruar sipas mësimave të Kur'anit dhe sipas Syneetit të Pejgamberit, Muhamedit, që të kemi sukses, sepse Kur'ani dhe Syneti janë burime, të cilat mund t'i mbajnë myslimanët së bashku dhe t'i udhëzojnë drejt zhvillimit dhe përparimit.



Kur' ani do të përkthehet dhe do të botohet në gjuhën suahili në Egjipt

Ministria e Vakfit e Egjiptit planifikon të përkthejë dhe të botojë Kur'anin e Shenjtë në gjuhën suahili.

Suahili, e njohur gjithashtu si Kisëahili, është gjuha e parë e popullit suahili.

Kjo është një gjuhë e rajonit të Afrikës Juglindore, duke përfshirë shtetet si Tanzania, Kenia, Uganda, Ruanda, Burundi, Mozambiku dhe Republika Demokratike e Kongos.

Vullnet Merja



BOTIME

Shoqata “Filladi”, “Duaja e Kumejlit”, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Selim Stafa. Nga vetë titulli i libërthit kuptohet që në të gjendet e plotë “Duaja e Kumejlit”, fjalët e së cilës paraqesin emrat e bukur të Allahut të Madhëruar dhe renditjen e fjalëve e fjalive në mënyrë të bukur e të këndshme për t’iu lutur Allahut të Plotëfuqishëm. **“O Zoti im, kë kam unë përveç Teje?”** Allahu i Madhëruar në Kur’an thotë: **“Ai ka emrat më të bukur”** (Surja “Ta Ha”, ajeti 8) dhe **“Lutmuni që t’ju përgjigjem”** (Surja “Gafir”, ajeti 60).

Shoqata “Filladi”, “Komentimi i përsosur i Kur’anit”, (*xhuzi 5 i Kur’anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Agim Reçaj dhe Vullnet Merja. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “Nisa” nga ajeti 24-148. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur’anit”,** i ofron lexuesit një njohje të detajuar të ajeteve të Kur’anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.

Shoqata “Filladi”, “Komentimi i përsosur i Kur’anit”, (*xhuzi 6 i Kur’anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Agim Reçaj dhe Vullnet Merja. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “En Nisa” nga ajeti 148 e deri në fund, si dhe komentimin e ajeteve 1-82, të sures “El Maide”. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur’anit”,** i ofron lexuesit një njohje të detajuar



të ajeteve të Kur'anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.

Shoqata “Filladi”, “Komentimi i përsosur i Kur'anit”, (*xhuzi 7 i Kur'anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Vullnet Merja. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “El Maide” nga ajeti 22 e deri në fund, si dhe komentimin e ajeteve 1-111 të sures “El En'am”. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur'anit”**, i ofron lexuesit një njohje të detajuar të ajeteve të Kur'anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.

Shoqata “Filladi”, “Komentimi i përsosur i Kur'anit”, (*xhuzi 8 i Kur'anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Vullnet Merja. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “El En'am” nga ajeti 111 e deri në fund, si dhe komentimin e ajeteve 1-88 të sures “El A'raf”. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur'anit”**, i ofron lexuesit një njohje të detajuar të ajeteve të Kur'anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.

Shoqata “Filladi”, “Komentimi i përsosur i Kur'anit”, (*xhuzi 9 i Kur'anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha arabe Vullnet Merja. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “El A'raf” nga ajeti 88 e deri në fund, si dhe komentimin e ajeteve 1-41 të sures “El Enfal”. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur'anit”**, i ofron lexuesit një njohje të detajuar të ajeteve të Kur'anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.



Shoqata “Flladi”, “Komentimi i përsosur i Kur’anit”, (*xhuzji 10 i Kur’anit*), shejh Naser Mekarim Shirazi, Tiranë, 2016. E përktheu nga gjuha perse Valbona Horozova. Në këtë libër do të gjeni komentimin e sures “El Enfal” nga ajeti 41 e deri në fund, si dhe komentimin e ajeteve 1-93 të sures “Et Teube”. Libri **“Komentimi i përsosur i Kur’anit”**, i ofron lexuesit një njohje të detajuar të ajeteve të Kur’anit duke nisur që me shkakun e zbritjes, me komentimin si dhe hulumtimin rreth tyre.

Vjollca Karaj



BIBLIOGRAFI E REVISTËS “DRITA E KUR’ANIT”, 2015

2015, I

HYTBJAELAMTUMIRËS	10
Sejjid Ebul A’la Maududi: PROFETËSIA E MUHAMEDIT REVOLUCIONARI MË I MADH	18
Vullnet Merja: PROFETI I MËSHIRËS	29
Abdu Daim Kahiil: ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR’ANI VII	36
Metush Skeja: TRURI DHE EDUKIMI	49
Qani Banaj: PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ	56
Misbah Jezdi: VEPRIMET E ALLAHUT NUK JANË KOHËSORE	64
Muhsin Keraeti: TANJOHIMMË TEJ KUR’ANIN	69
Naser Mekarim Shirazi: KUR’ANI, MREKULLI E PËRJET- SHME	78
Vullnet Merja: FJALOR KUR’ANOR: Xhindet	89
Osman Nuri Topbash: HISTORI E PROFETËVE - Profeti Shuajb	94

2015, II

Selim Stafa: AGJËRIMI I PROFETIT	9
Vjollca Karaj: RAMAZANI DHE RËNDËSIA E AGJËRIMIT	17



Naser Mekarim Shirazi: AGJËRIMI ËSHTË SHKOLLA E DEVOTSHMËRISË.....	25
DOBITË E AGJËRIMIT GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT.....	37
Bedri Bylyku: AGJËRIMI ËSHTË SHËNDET.....	48
Xhemal Balla: HANIEPINI, PORMOSETEPRONI.....	51
Abdu Daim Kahiil: ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI VIII.....	58
Qani Banaj: PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ.....	70
Muhsin Keraeti: TANJOHIMMË TEJ KUR'ANIN.....	75
Arbër Berisha: DISA CILËSI TË KUR'ANIT.....	83
Ali Muhamed Ali Duhajjil: HISTORI E PROFETËVE - Profeti Lut.....	88
Vullnet Merja: FJALOR KUR'ANOR: Profetët që përmenden në Kur'an.....	95

2015, III

Sabrie Feza: RRUGA PËR NË HAXH.....	9
Hajri Shehu: MEKA -VENDI PËR TË CILIN BETOHET ALLAHU NË KUR'AN.....	18
Naser Mekarim Shirazi: HAXHI NË KUR'AN - KOMENTIMI I AJETIT 196, ISURES "ELBEKARE".....	25
Fatme Chehab: KUR'ANI - KUSHTETUTA E PËRSOSUR E JETËS.....	33
Qani Sulku: LUTMUNI QË T'JUPËRGJIGJEM.....	42
Albana Muja: KUR'ANI PËR PASTËRTINË DHE PASTRIMIN.....	52
Abdu Daim Kahiil: ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI IX.....	59
Qani Banaj: PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ.....	69
Muhsin Keraeti: TANJOHIMMË TEJ KUR'ANIN.....	76



Ali Muhamed Ali Duhajjil: HISTORI E PROFETËVE - Profeti Ismail.....	87
Vullnet Merja: FJALOR KUR'ANOR - Barzakhu (Bota e Ndërmjetme).....	91

2015, IV

Selim Stafa: HAZRETI MUHAMEDI PROFETI I MBARË NJERËZIMIT.....	9
Ahadollah Gholizadeh Barandagh: DISA VIRTYTE TË PROFETIT MUHAMED.....	20
Vullnet Merja: MESIHU - BIRI I MERJEMES NË KUR'AN.....	26
Robin Scott: BIBLA DHE KUR'ANI.....	37
ARGUMENTE PSE NUK ËSHTË KRYQËZUAR HAZRETI ISAI.....	40
Abdu Daim Kahiil: ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI X.....	46
Qani Banaj: PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ.....	55
Vullnet Merja: VENDE, POPUJ, NJERËZ E NGJARJE QË PËRMENDEN NË KUR'AN XHAMIA "EL AKSA".....	59
Nasir Mekarim Shirazi: DHJETË URDHËRESA - KOMENTIMI I AJETEVE 151-153, TË SURES "EN'AM".....	65
Muhsin Keraeti: TANJOHIMË TEJ KUR'ANIN.....	76
Ali Muhamed Ali Duhajjil: HISTORI E PROFETËVE - Historia e profetit Musa dhe Harun.....	84
Vullnet Merja: FJALOR KUR'ANOR: Ringjallja (<i>El Ba'thu</i>).....	104



ABSTRACTS

Vullnet Merja

THE PROPHET OF PEACE AND LOVE

The Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him and his family!) brought the message of peace and security. He has been truthful and loyal. People recognized, recognize and will recognize him until the end of this life as such. Allah the Almighty refers to him: *“Indeed, you stay in the highest extremity of morality.”* He carried the Message of Allah in his heart, in his tongue and in every step of his life and conveyed it to all mankind. When talking about the Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him and his family!), we are talking about Islam and the eternal miracle of God’s Word, the Holy Qur’an, which God revealed to bring the people out of the darkness into the light. The Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him and his family!) was the Qur’an itself for the whole Qur’an was crystallized in his very being. While walking or speaking, he illuminated everything with the Qur’an’s light. He is the inextinguishable light, the consummate educator and the most righteous leader. Therefore, he has been, is and will remain a model for the people of all ages and every country, regardless of the nationality, race, language and color.



WONDERFUL EFFECTS OF BELIEF IN GOD

Abasement before the Lord, all the time, being in trouble and in serenity, and the conviction that the inexhaustible power of God stands above all other common powers, the causes and the factors. It leads and governs everything and gives a tremendous force to the spirit. The best evidence of the sustainable faith in God is the moral and spiritual character of a person's intentions and his motives. In that case, his actions acquire a special value and he comes to participate in supporting the God and His immense goodness. Reliance on God never leads to any kind of weakness and indifference. Moreover, He provides you with self -confidence, strengthens your will, and takes away all traces of suspicion and hesitancy in the human soul.

Nasir Mekarim Shirazi

COMMENTARY OF THE VERSE 164 OF SURAH "AL-BAQARAH"

This blessed verse presents arguments for Allah's existence. It reveals six signs from the galactic system of signs in the universe, and each of these signs indicates the oneness of the Creator. The six signs are: the creation of the heavens and the earth, the alternation of the night and the day, the ships sailing on the seas for mankind's profits, rain, winds, clouds that stand between the sky and the Earth.



LESSONS FROM THE SURAH “AL-BAQARAH”

There are many lessons In the Qur’anic verses. In this article there are some lessons from Surah “Al-Baqarah”, such as: the Islamic religion is a global religion and it provides responses for all human needs, even the childbirth and the ways of setting up the family; If we trust the rules and laws of Allah, then we will realize that all these laws are established in the interest and for the benefit of individuals and the society; In choosing one’s spouse one must attach significance to spiritual values rather than external beauty or material and provisional issues; A happy family is that one which is founded according to the laws of Allah. If spouses prefer to continue the life sinning or performing illegal activities, then divorce is better for them, etc.

Abdu Daem Kaheel

THE SKIN SPEAKS

The Qur’an says that the Day of Resurrection, the skeptics in the Word of Allah will be brought to the fire. Their own skins will be among the witnesses. The skin consists of layers. These layers consist of cells. The cells have the capacity to store the data for a long time. Therefore, the scholars say that the skin has long-term memory. Scholars attest the presence of voice in the skin cells, through which it speaks, but we do not understand what it says. This new discovery was not known at the time of the Qur’an’s revelation, but the Qur’an has told us



that anything exalts Him. Qur'an has taught us as believers how to make our skin cells more active through its response to the word of Allah. Allah Almighty says: **"Allah has sent down the best statement, a Book (this Qur'an), its parts resembling each other in goodness and truth, oft-repeated. The skins of those who fear their Lord shiver from it (when they recite it or hear it). Then their skin and their heart soften to the remembrance of Allah. That is the guidance of Allah. He Guides therewith whom He pleases and whomever Allah sends astray, for him there is no guide."** (Surah" Az-Zumar ", verse 23). So, reading or reciting the Qur'an and listening to It are the best means for protecting skin cells and the body cells in general. It is understandable from this verse that the skin cells are influenced by the vowel sounds, and they respond to them.

Sabrie Feza

THUNDER AND LIGHTNING, SIGNS OF INFINITE POWER OF ALLAH

The amazing natural phenomena are common to man. Indicating His creations and His creations' benefits (the creation), Allah Almighty sheds the light of faith into the hearts of believers. Thunder and lightning are amidst these phenomena. Allah Almighty says: **"It is He who shows you the lightning, as a fear and as a hope."** It is true. Lightning and thunder intimidate the people. But the thunder and lightning cause the rain fall to enliven the earth, irrigate the plants and satisfy people. Between the fear and the hope man passes sensitive moments, as Allah the Exalted says: **"It is He**



who creates heavy clouds (with rain)” to irrigate agricultural lands.

Qani Banaj

THERE IS REMEDY FOR EACH DISEASE

Jabir ibn Abdullah narrated that the Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him!) said: *“For each disease there is remedy. When the medicine affects the disease, one is cured with the permission of Allah.”* (Muslim)

This article presents the healing properties: of bitter root (gentiana lutea), couch grass, common ivy (hedera helix), hernia plant, hipofeas, holly bush/tree, viburnum, hyssop, gladiola, urtica (lamium purpureum), flax (linum usitatissimum), snap dragon, , portulaca, marjoram, cinquefoil,(potentilla reptans), butterbur plants (petasitidis rhizome et folium) etc.

Hans Henrich Reckweg

THE HARM OF PORK (SWINE FLESH)

The pork is dangerous. The population living according to the Islamic law is healthy, while the people living according Western lifestyle suffer from diseases caused by the consumption of the pork. It was known since before World War II that the pork is harmful, and to some extent, it causes poisoning. It is proved that many diseases, such as arthritis and other women’s diseases are due to the consumption of pork.



WE SHOULD PRESERVE OUR TONGUE

It is beyond doubt that the tongue, which is a small fleshy organ, is the cause for people's entrance into the Hell or the Paradise. Though it is small as an organ, the tongue can commit the greatest evil. In the Holy Qur'an it is said: **"Have we not made for him a pair of eyes, and a tongue, and a pair of lips?"** (Surah "Al-Balad/The city", verses 8-9) In this world, the man is frequently oblivious and hasty with the words he says and the actions he performs. He conceals many of his deeds and statements in this world. He reviles and outrages groundlessly. But Allah is All- Knowing and Well-informed for everything. He is righteous. He never treats someone unfairly. In the Qur'an we read: **"And [suppose that] you have not been hiding yourselves, lest your ears and your eyes, and your skins should testify against you, but you thought that Allah knew not much of what you were doing."** (Surah "Fussilat", verse 22). **And: "And for each word he utters, there stands a reminder close to him (to record him)."** (Surah "Qaf", verse 8).

HISTORY OF THE PROPHETS MOSES AND AARON

One of the most outstanding and magnificent stories presented in the Qur'an is the story of the Prophet Moses (Peace be upon him!). The story of the Prophet is presented in seventy three places in the Qur'an. Prophet Moses is honored by God because He addressed him directly, without any mediator. Allah Almighty says: **"And mention in the Book, Moses. Indeed, he was chosen, and he was a messenger**



and a prophet.” (‘Maryam’/ ‘Mary’, 51) Moses (Peace be upon him!) was chosen by the Lord to be in His service, far away from the molestations and temptations of Satan. Regarding his power and physical strength, it is said that he was equal to ten men. Moses (Peace be upon him!) had speech difficulties. This fact is mentioned by Pharaoh who addressed the advisers making fun of Moses: **“Or am I not better than that weak man, who can hardly express himself clearly?”** (‘Az-Zukhruf”, 52). But this handicap did not prevent him to be elected a messenger of Allah and a prophet. Moses himself acknowledges this shortcoming in speaking in this verse: **“My brother Aaron is more fluent than me in tongue.”** (‘Al-Qasas”, 34) The Prophet Moses and his brother, the Prophet Aaron intended to offer guidance to the Children of Israel.

Hajri Shehu

PLACES, PEOPLES, PEOPLE AND EVENTS MENTIONED IN THE QUR’AN: MEDINA

According to Islamic history, the Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him!) resided for ten years in Medina. The Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) loved Medina. Medina is a symbol of the spiritual history of the world. According to scholars of the Qur’an, 30 Surahs were revealed in Medina with more than 1800 verses or about 30% of Allah’s Revelation. An endless Qur’anic and Islamic knowledge! Even the Adhan - one of the greatest signs of Islam is called for the first time in Medina. The Prophet’s Mosque (Peace and blessings of Allah be upon him!) is located in Medina. In Medina was founded the community (Ummah) of Islam.



ملاحظات

الحاج ولنت مريا

نبي السلام و الرحمة

جاء النبي برسالة السلام و الامن. و هو كان الصادق الامين و هكذا كان الناس يعرفونه و هكذا سيعرفونه حتى آخر هذه الحياة. وقد كان رمزاً للاخلاق. يقول الله تعالى: **وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ.**

حمل الرسول (ص) رسالة الله في قلبه و في لسانه في كل حياته و بلغها للناس جميعا. عندما نتحدث عن الرسول نتحدث عن الاسلام و عن المعجزة الخالدة -القرآن الكريم - الذى انزله الله ليخرج الناس من الظلمات الى النور. الرسول كان نفس القرآن لان القرآن كان متجسدا في كيانه. حين كان يمشى كان يضيئ كل شئ بنور القرآن. الرسول هو النور الذى لا ينطفئ و هو افضل مرئي و هو القائد العادل. لذلك هو كان و سيبقى اسوة لكل الناس في كل مكان و زمان.

السيد مجتبى موسوي اللاري

الآثار الجميلة للايمان بالله

إنّ العبودية و الخضوع أمام الله في الضراء و السراء، و الاعتقاد الجازم الراسخ بسيادة القدرة الإلهية المطلقة فوق جميع القدرات و العلل و العوامل، يترك في نفس المؤمن آثارا عجيبة من الطمأنينة بحيث لا يفقد قيمته و ثقله أمام اي حادث، و لا يضطرب و لا يقلق لأي شئ كبير كان او صغيرا.

إنّ الاتكال على الله لن يؤدي الى العجز او الضعف و الوهن، بل هو ثقة و اعتماد يؤثّق قوة الارادة، و يقطع جذور اي وسوسة او تردد من القلوب.



مظاهر عظمة الله في الكون تفسير الآية ١٦٤ من سورة البقرة

هذه الآية الكريمة تشير إلى ستة أقسام من آثار النظم الموجود في عالم الكون، وكل منظومة آية تدل على وحدانية المبدأ الأكبر. وهذه الأقسام الستة هي: خلق السموات والأرض، اختلاف الليل والنهار، والفلك التي تجري في البحر بما ينفع الناس، وتصريف الرياح والسحاب المسخر بين السماء والأرض.

محسن قرائتي

دروس من سورة البقرة

في الآيات القرآنية دروس كثيرة. وفي هذه المقالة بعض من الدروس من سورة البقرة مثل: ان الاسلام هو دين عالمي و يلبي مطالب و حاجات الانسان، بل يوضح كيفية ولادة الطفل و اسلوب تأسيس العائلة. اذا تأملنا قوانين الله تعالى سنفهم ان هذا القوانين وضعت لمنافع الفرد و المجتمع. في انتخاب الزوج او الزوجة لا بد ان نلاحظ الجانب الاخلاقي و القيم الروحية و لا نهتم للجمال الظاهري و للامور المادية المؤقتة. الاسرة السعيدة هي التي بنيت على القوانين الالهية. اذا اراد الزوجان ان تستمر حياتهم على المعاصي و الذنوب إذا الطلاق افضل لهما...

عبد الدائم الكحيل

الجلد يتكلم

يقول القرآن انه عندما يُعرض أولئك المشككون بكلام الله على النار لتشهد عليهم جلودهم بما كانوا يفترون على الله كذباً في الدنيا. الجلد يتألف من طبقات رقيقة تحوي الأنسجة. أن للجلد مهام حساسة في تخزين المعلومات والأحداث. إن العلماء



يؤكدون وجود صوت لخلايا الجلد تنطق به، ولكننا لا نفقه ما تقوله!! وهذا الاكتشاف حديث لم يكن لأحد علم به زمن نزول القرآن ولكن القرآن أخبرنا بأن كل شيء ينطق ويسبح الله. ونحن كمؤمنين علمنا القرآن كيف نجعل خلايا جلدنا أكثر نشاطاً وحيوية من خلال تفاعلها وتأثرها بكلام الله تعالى، يقول تعالى: اللَّهُ تَزَلَّ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَابًا تَفْشَعُ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ [الزمر: ٣٢]. أي أن قراءة القرآن والتأثر بسماعه هو أفضل وسيلة لحماية خلايا الجلد وخلايا الجسد بشكل عام.

صبريه فرا

الرعد و البرق آياتان على قدرة الله اللامتناهية

الظواهر الطبيعية المدهشة هي عادية للانسان. من خلال اظهار خلقه و فوائد خلقه الله سبحانه و تعالى يرمي في القلوب المؤمنين نور الايمان. و من هذه الظواهر البرق الرعد. يقول الله تعالى: هُوَ الَّذِي يُرِيكُمُ الْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا... (سورة الرعد الآية 21). لا شك بان البرق و الرعد يثيران الخوف و الرعب عند الانسان و لكن البرق و الرعد هما سبب لنزول الغيث و احياء الارض و سقى النباتات و سرور الناس. و بين الخوف و الرجاء الانسان يمر بلحظات حساسة كما يقول الله سبحانه و تعالى: هُوَ الَّذِي يُرِيكُمُ الْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا وَيُنْشِئُ السَّحَابَ الثِّقَالَ.

تشاني باناي

لكل داء دواء

وَفِي صَحِيحِ مُسْلِمٍ مِنْ حَدِيثِ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ: «لِكُلِّ

دَاءٍ دَوَاءٌ فَإِذَا أَصَابَ دَوَاءُ الدَّاءِ بَرَأَ بِإِذْنِ اللَّهِ

فى هذا المقال يُستعرض الخصوصية العلاجية لبعض النباتات.



لحم الخنزير

لحم الخنزير خطير جدا. و الذين يعيشون طبقا لقوانين الاسلام هم سالمين و لكن الذين يعيشون طبقا لاسلوب الغرب يُعانون من الامرض التى يسببها تناول لحم الخنزير. لحم الخنزير يسبب التسمم و هذا معروف قبل الحرب العالمية الثانية و ثبت ان كثير من الامراض مثل التهاب المفاصل و غيرها من الامراض عند النساء بسبب تناول لحم الخنزير.

فاطمة شهاب

نحافظ على السنننا

انّ اللسان قطعة صغيرة من اللحم و هو سبب دخول الناس الى الجهنم او الى الجنة. اللسان من أعظم النعم الإلهية على العبد، فإنّه - مع صغر حجمه ودقة صنعه - عظيم الفائدة؛ إذ لا يستبين في الأغلب الكفر والإيمان إلا بشهادة اللسان. يقول القرآن الكريم: أَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ (سورة البلد الآية ٨ و ٩) تجد في هذه الدنيا كثيرا من الناس الذين يستعجلون فى الكلام و الافعال و كثيرا من الناس يخفون افعالهم و اقوالهم و هم يسبون و يهينون الآخرين. و لكن الله سبحانه و تعالى عليم و خبير بكل الشئ و هو لا يظلم احد ابدا. و لذلك الانسان سوف يحاسب على افعاله و اقواله يوم القيامة. يقول الله تعالى فى القرآن الحكيم: وَمَا كُنْتُمْ تَسْتَرْوْنَ أَنْ يَشْهَدَ عَلَيْكُمْ سَمْعُكُمْ وَلَا أَبْصَارُكُمْ وَلَا جُلُودُكُمْ وَلَكِنْ ظَنَنْتُمْ أَنَّ اللَّهَ لَا يَعْلَمُ كَثِيرًا مِمَّا تَعْمَلُونَ (سورة فصلت الآية 22) و يقول ايضا: مَا يَلْفُظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ (سورة ق الآية 18)

على محمد على الدحيل

قصص الانبياء - النبي موسى و النبي هارون (عليهما السلام)

من اشهر القصص التى يقصها القرآن الكريم هى قصة النبي موسى (عليه



السلام). تذكر قصة هذا النبي العظيم في ثلاث و سبعين موضع في القرآن. النبي موسى من المكرمين عند الله لانه تكلم مستقيما مع الله بدون واسطة. يقول الله تعالى: وَنَادَيْنَاهُ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ الْأَيْمَنِ وَقَرَّبْنَاهُ نَجِيًّا (سورة مريم الآية ١٥) و قد اختاره الله تعالى لهداية بني اسرائيل. يقال بان قوته كانت تساوى قوة عشر رجال. كان لدى موسى عليه السلام صعوبة النطق و يذكر ذلك القرآن في سورة زحرف الآية ٢٥ : أَمْ أَنَا خَيْرٌ مِّنْ هَذَا الَّذِي هُوَ مَهِينٌ وَلَا يَكَادُ يُبِينُ و لكن هذا النقص لم يمنعه ان يكون نبي الله. و كان هدف النبي موسى و هارون عليهما السلام هداية بني اسرائيل.

الاستاذ خيرى شيهو

الاماكن و الاقوام و الاحداث المذكورة فى القرآن المدينة

حسب التاريخ الاسلام بقي النبي (ص) عشرة سنوات في المدينة. كان النبي (ص) يحب كثيرا المدينة. المدينة رمز التاريخ الروحي للعالم. طبقا لاقوال علماء القرآن نزل في المدينة ٣٠ سورة و اكثر من ١٨٠٠ آية او ٣٠٪ من الوحي. و ايضا اذن الاذان - و هو احدى علامات الاسلام- لأول مرة في المدينة. و في المدينة مسجد الرسول الله (ص). و قد اسست في المدينة الأمة الاسلامية



نور قرآن

فصلنامه علمی قرآنی

صاحب امتیاز: مؤسسه قرآن کریم آلبانی

مدیر مسئول: شیخ ولنت (عباس) مریا

سردبیر: پروفسور دکتر خیری شهو

معاون سردبیر: صبریه فزا

اعضای هیئت تحریریه:

پروفسور دکتر علی رضا اعرافی (رئیس جامعه المصطفی - ایران)

دکتر احدالله قولی زاده (نماینده کل جامعه المصطفی در بالکان)

پروفسور دکتر فتحی مهدیو (استاد دانشگاه پریشتینا - کوزوو)

افندی سلیمان رجبی (رئیس کمیته اسلامی - مقدونیه)

سلیم اصطفی (مترجم قرآن)

یتیمیر چلا

ویرایش ادبی: لیسدا رامای

مقابله ادبی: ویولسا کارای

صفحه آرایی و طراحی جلد: صبریه فزا

شماره: 1 / 2016 (36)



KUJTESE PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

- Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.
- Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.
- Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave *ë* dhe *ç* me *e* dhe *c*.
- Të mos përdoret shkronja e madhe I aty ku nuk duhet.
- Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.
- Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.
- Poshtëshënimet të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull poshtëshënimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.
- Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail):

f_quran114@yahoo.com

quranfondation114@gmail.com

